



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR

Numër | 05
Shtator | 2014

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 5

BOTUES © Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike
33 Garibaldi, Prishtinë 10 000
Tel: ++381 38 222 055
Fax: ++381 38 243 763

Faqja e internetit www.bqk-kos.org

Adresa elektronike economicanalysis@bqk-kos.org

KRYEREDAKTOR Arben MUSTAFA

REDAKTOR Albulena XHELILI

AUTORË Krenare MALOKU
Zana GJOCAJ
Hana GAFURRI
Taulant SYLA

REDAKTOR TEKNIK Butrint BOJAJ

SHKURTESAT:

AJN	Asetet e Jashtme Neto
ASK	Agjencia e Statististikave të Kosovës
ATM	Bankomatë (<i>anglisht: Automated Teller Machines</i>)
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CAR	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (<i>angl.: Capital Adequacy Ratio</i>)
CIS	Commonwealth of Independent States
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (<i>angl.: European Bank for Reconstruction and Development</i>)
ECB	Banka Qendrore Evropiane (<i>anglisht: European Central Bank</i>)
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MEF	Ministria e Financave
NIM	Margjina Neto e Interesit (<i>angl.: Net Interest Margin</i>)
NPL	Kreditë joperformuese (<i>angl.: Non-Performing Loans</i>)
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
pp	Pikë Përqindje
POS	Pika të Shitjes (<i>anglisht: Point of Sales</i>)
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomu i Kosovës
OECD	Organizata për Bashkpunim Ekonomik dhe Zhvillim (<i>anglisht: Organization for Economic Cooperation and Development</i>)
OJSHEF	Organizatrat Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit (<i>angl.: Rule of Law Index</i>)
ROAA	Kthimi Mesatar në Asete (<i>angl.: Return on Average Assets</i>)
ROAE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
ROE	Kthimi Mesatar në Kapital (<i>angl.: Return on Average Equity</i>)
RWA	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut (<i>angl.: Risk Weighted Assets</i>)
SDR	Të Drejtat Speciale të Tirazhit (<i>angl.: Special Drawing Rights</i>)
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Vërejtje:

Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.
 Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2014),
 Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 5, Prishtinë: BQK.
 Çdo korigjim i nevojshëm bëhet në verzionin elektronik.

PËRMBAJTJA:

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	11
2. Përmbledhje Ekzekutive -----	13
3. Mjedisi i jashtëm ekonomik-----	17
3.1. Evropa Juglindore -----	19
4. Ekonomia e Kosovës -----	24
5. Sistemi Financiar i Kosovës-----	26
5.1. Karakteristikat e Përgjithshme -----	26
5.2. Ekspozimi ndaj jo-rezidentëve -----	28
6. Sektori Bankar i Kosovës-----	30
6.1. Aktiviteti i Sektorit Bankar -----	30
6.4. Analiza Stres-Test-----	58
6.5. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	62
7. Sektori Pensional-----	66
7.1. Aktiviteti i Sektorit Pensional-----	66
7.2. Performanca e Sektorit Pensional-----	67
8. Sektori i Sigurimeve-----	68
8.1. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve -----	69
8.2. Performanca e Sektorit të Sigurimeve-----	70
9. Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Ndhmësve Financiar -----	71
9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar -----	71
9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar -----	73
9.3 Ndhmësit Financiar-----	74
9. Shtojca Statistikore-----	75
10. Referencat-----	95

LISTA E FIGURAVE ----- 17

Figura 1. Inflacioni në vendet e zgjedhura të eurozonës -----	17
Figura 2. Norma e kredive jopërfmuese në vendet e zgjedhura të eurozonës -----	18
Figura 3. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës-----	18
Figura 4. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL-----	19
Figura 5. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL-----	19
Figura 6. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJL-----	20
Figura 7. Trendi i rritjes së kredive -----	21
Figura 8. Trendi i rritjes së depozitave -----	21
Figura 9. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave -----	22
Figura 10. Kthimi i kapitalit (ROE)-----	22
Figura 11. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) -----	22
Figura 12. Trendi i kredive jo performuese-----	23
Figura 13. Rritja reale e PBB-së -----	24
Figura 14. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij -----	24
Figura 15. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar-----	25
Figura 16. Trendi i zhvillimit të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës -----	26
Figura 17. Struktura e aseteve të sistemit financiar-----	26
Figura 18. Norma e ndërmjetësimit sipas sektorëve ndaj PBB-së -----	27
Figura 19. Norma e ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar ndaj PBB-së -----	27
Figura 20. Struktura e kërkesave të jashtme -----	28
Figura 21. Struktura e detyrimeve të jashtme -----	28
Figura 22. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve -----	28
Figura 23. Ekspozimi në kuadër të aseteve dhe detyrimeve -----	29
Figura 24. Struktura e kapitalit të bankave komerciale-----	30
Figura 25. HHI për asete, kredi dhe depozita-----	30
Figura 26. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar sipas vendeve-----	30
Figura 27. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	31
Figura 28. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar-----	31
Figura 29. Struktura e letrave me vlerë -----	32
Figura 30. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve -----	32
Figura 31. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet -----	33
Figura 32. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare -----	34
Figura 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet-----	34
Figura 34. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare-----	34
Figura 35. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike-----	35
Figura 36. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik -----	35
Figura 37. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	36
Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit-----	36

Figura 39. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive -----	37
Figura 40. Kategoritë kryesore të kredive të reja -----	37
Figura 41. Rritja vjetore e kredive të reja -----	37
Figura 42. Kategoritë kryesore të kredive të reja -----	37
Figura 43. Kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyera -----	38
Figura 44. Kreditë e reja dhe gjithsej kreditë aktive të ndërmarrjeve -----	38
Figura 45. Kreditë e reja dhe gjithsej kreditë aktive të ekonomive familjare -----	38
Figura 46. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore -----	39
Figura 47. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve -----	39
Figura 48. Depozitat e jo rezidentëve dhe norma e interesit në depozita -----	40
Figura 49. Struktura e depozitave sipas maturimit -----	40
Figura 50. Struktura e depozitave të afatizuar -----	40
Figura 51. Mesatarja e normave të interesit -----	41
Figura 52. Norma mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve -----	41
Figura 53. Normat mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare -----	42
Figura 54. Normat mesatare të interesit në kredi sipas sektorëve ekonomik -----	42
Figura 55. Normat mesatare të interesit në depozita dhe vlera e asetëve likuide -----	42
Figura 56. Struktura e përgjithshme e të hyrave -----	43
Figura 57. Struktura e të hyrave sipas kategorive -----	43
Figura 58. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive -----	44
Figura 59. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive -----	44
Figura 60. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive -----	44
Figura 61. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive -----	45
Figura 62. Treguesit e profitabilitetit -----	45
Figura 63. Raporti shpenzime/të hyra -----	46
Figura 64. Harta e rreziqeve të sektorit bankar -----	47
Figura 65. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar -----	48
Figura 66. Raporti mjete likuide “gjithpërfshirëse”/detyrime afatshkurtëra -----	48
Figura 67. Rezervat e sistemit bankar -----	48
Figura 68. Hendeku i likuiditetit -----	49
Figura 69. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve -----	50
Figura 70. NPL-të sipas sektorëve -----	50
Figura 71. Struktura e kredive sipas klasifikimit -----	51
Figura 72. Struktura e kredive jo performuese -----	51
Figura 73. NPL-të dhe provizionet -----	51
Figura 74. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	52
Figura 75. Kapitalizimi i sistemit bankar -----	52
Figura 76. Kapitali rregullativ dhe RWA-të -----	53
Figura 77. Struktura e kapitalit rregullativ të sistemit bankar -----	54
Figura 78. Struktura e kapitalit të klasit të parë -----	54

Figura 79. Struktura e kapitalit të klasit të dytë-----	55
Figura 80. Struktura e RWA-ve sipas peshër së rrezikut -----	55
Figura 81. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë -----	55
Figura 82. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj-----	57
Figura 83. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	57
Figura 84. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit-----	57
Figura 85. Struktura e investimeve të fondeve pensionale-----	66
Figura 86. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Kosovar të Pensioneve -----	66
Figura 87. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve-----	67
Figura 88. Struktura e kapitalit të kompanive të sigurimit-----	68
Figura 89. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit -----	69
Figura 90. Detyrimet dhe ekuitetit i kompanive të sigurimeve -----	69
Figura 91. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	70
Figura 92. HHI për asetet dhe kreditë e IMF-ve-----	71
Figura 93. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve -----	71
Figura 94. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve-----	71
Figura 95. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit -----	72
Figura 96. Struktura e lizinguy të IMF-ve sipas sektorëve-----	72
Figura 97. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve -----	72

LISTA E TABELAVE----- 17

Tabela 1. Indikatorë të zgjedhur makroekonomik-----	17
Tabela 2. Numri i institucioneve financiare -----	27
Tabela 3. Asetet dhe detyrimet e jashtme të sektorit financiar -----	29
Tabela 4. Struktura e aseteve të sektorit bankar -----	31
Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar -----	39
Tabela 6. Tregues kyq të efikasitetit të sektorit -----	46
Tabela 7. Treguesit të kapacitetit të sektorit bankar-----	46
Tabela 8. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku kreditor-----	60
Tabela 9. Përmbledhja e rezultateve të stres-testit: Rreziku i likuiditetit -----	61
Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së ----	63
Tabela 11. Rrjeti i sektorit bankar -----	65
Tabela 12. Struktura e sektorit pensional-----	66
Tabela 13. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve -----	68
Tabela 14. Bruto primet gjatë viteve -----	69
Tabela 15. Dëmet e paguara gjatë viteve -----	70
Tabela 16. Tregues shtesë të efikasitetit të sektorit-----	73

LISTA E KUTIVE	17
Kutia 1. Performanca e grupeve të huaja bankare të cilat operojnë në Kosovë	17
Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar	36
Kutia 3. Kreditë e reja	66

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Sektori financiar i Kosovës vazhdon të karakterizohet me nivel të lartë të qëndrueshmërisë, përderisa edhe efikasiteti i sektorit në përgjithësi po përmirësohet, duke ofruar kështu shërbime me kushte më të favorshme financiare për ekonominë. Kontribut të rëndësishëm në mirëmbajtjen e stabilitetit financiar ka dhënë edhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik në vend, që është manifestuar me vazhdim të rritjes ekonomike dhe normë të ulët inflacioni. Rritja ekonomike në vitin 2013 vlerësohet të jetë mbështetur kryesisht në konsumin dhe investimet e sektorit privat, ku dërgesat e emigrantëve dhe kreditë bankare vazhdojnë të përfaqësojnë burime të rëndësishme të financimit. Për vitin 2014, parashikimet makroekonomike sugjerojnë për përshpejtim të rritjes ekonomike, gjë e cila pritet të përmirësojë edhe më tutje klimën afariste në vend, duke ndikuar kështu në zvogëlimin e rreziqeve financiare si dhe duke krijuar kushte për zgjerim më të shpejtë të aktivitetit të sektorit financiar.

Shkalla e lartë e qëndrueshmërisë së sektorit bankar është evidente në të gjitha aspektet, duke u bazuar në pozitën e kënaqshme të likuiditetit, cilësinë e mirë të portofolit kreditor dhe nivelin e lartë të kapitalizimit. Depozitat e mbledhura brenda vendit vazhduan të jenë burim i qëndrueshëm i financimit për bankat që operojnë në Kosovë, duke bërë ekonominë e vendit më pak të varur nga lëvizjet në ofertën dhe koston e fondeve nga jashtë. Megjithatë, kreditimi drejtë ekonomisë vazhdoi të rritet me ritëm më të ngadalshëm krahasuar me periudhat paraprake. Ngadalësimi i ritmit të rritjes së kreditimit në Kosovë paraqet zhvillim të ngjashëm me zhvillimet në tregjet ndërkombëtare financiare, në të cilat shtrëngimi i kreditimit bankar ka paraqitur një shqetësim të vazhdueshëm gjatë viteve të fundit. Megjithatë, bazuar në prospektet makroekonomike, shëndetin e sektorit bankar dhe vetë pritjet e bankave për aktivitetin e tyre kreditor, viti 2014 pritet të karakterizohet me rikuperim të trendit të rritjes së kredive. Aktiviteti ndërmjetësues i sektorit bankar gjatë vitit 2013 u karakterizua me zvogëlim të normave të interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat, duke reflektuar, mes tjerash, edhe masat e ndërmarra nga sektori bankar për rritje të efikasitetit. Performancë e kënaqshme u regjistrua edhe nga komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, ku vlen të theksohet rritja e kthimit nga investimet e fondeve pensionale si dhe zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit të kompanive të sigurimit, përderisa aktiviteti kreditor i institucioneve mikrofinanciare vazhdoi të zvogëlohet.

Gjatë këtij viti, arritje të rëndësishme u shënuan edhe në fushën e sistemit të pagesave, ku duhet theksuar sigurimin e kodit të veçantë shtetëror SWIFT për institucionet financiare që operojnë në Kosovë, gjë që pritet të ndikojë në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë gjatë realizimit të transfereve ndërkombëtare. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mbetet e përkushtuar për të ruajtur stabilitetin financiar dhe për të përkrahur zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij sektori, duke ofruar infrastrukturën e nevojshme financiare si dhe duke siguruar që aktiviteti i sektorit financiar të zhvillohet në përputhje me kornizën rregullative. Vëmendje të veçantë, BQK po i kushton edhe komunikimit me publikun, ku bënë pjesë edhe Raporti i Stabilitetit Financiar, përmes së cilit synojmë të ofrojmë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zhvillimeve në sektorin financiar dhe ekonominë në përgjithësi.

Bedri HAMZA

Guvernator

2. Përmbledhje Ekzekutive

Ekonomia globale edhe gjatë vitit 2013 u karakterizua me normë pozitive të rritjes që kryesisht u arrit si rezultat i rritjes së ekonomive të vendeve të zhvilluara si SHBA-të, Japonia, Mbretëria e Bashkuar si dhe disa vende të eurozonës si Gjermania dhe Franca, përderisa eurozona si tërësi ekonomike vlerësohet të kenë shënuar rënie në vitin 2013. Performanca më e dobët e sektorit real në ekonomitë periferike të Eurozonës është shoqëruar me vazhdim të rritjes së borxhit publik, gjë që ka rritur shqetësimet rreth qëndrueshmërisë së financave publike. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Eurozonë dhe në vendet e zhvilluara në përgjithësi ka bërë që viti 2013 të karakterizohet me rënie të presioneve inflacioniste, gjë që ka ngritur shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni sidomos për vendet e Eurozonës. Përkundër uljes së vazhdueshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Evropiane, aktiviteti kreditor i sektorëve bankar të këtyre vendeve kanë vazhduar të ketë rol të zbehtë në nxitjen e aktivitetit ekonomik, përderisa performanca jo e kënaqshme e ekonomive ka vazhduar të reflektohet në përkeqësimin e cilësisë së kredive në këto vende. Si do që të jetë, viti 2014 pritet të karakterizohet me performancë më të mirë të ekonomisë globale, përfshirë Eurozonën, gjë që pritet të ndihmojë në tejkalimin e sfidave me të cilat po ballafaqohen ekonomitë e zhvilluara.

Për vendet Evropës Juglindore, viti 2013 në përgjithësi vlerësohet të ketë qenë vit i rikuperimit ekonomik si rezultat i normave pozitive të rritjes ekonomike në shumicën e vendeve të këtij rajoni. Rritja e aktivitetit ekonomik në këto vende është reflektuar në një rënie të lehtë të normës së papunësisë gjatë vitit 2013. Përkundër përmirësimit të bilancit buxhetor, borxhi publik i vendeve të EJT-së ka vazhduar të rritet, mirëpo vazhdon të mbetet nën nivelin e Eurozonës. Ngjashëm me vendet e Eurozonës, sektorët bankar në vendet e EJT-së kanë vazhduar shtrëngimin e theksuar të kredidhënies, përderisa edhe depozitat janë karakterizuar me trend më të ngadalshëm të rritjes. Cilësia e portofolit kreditor ka vazhduar të përkeqësohet, ndërsa është shënuar përmirësim i lehtë në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Zhvillimet më të favorshme ekonomike në tërë rajonin gjatë vitit 2013 ishin të pranishme edhe në ekonominë e Kosovës. Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë për vitin 2013 vlerësohet të ketë qenë rreth 3.4 përqind, që vazhdon të mbajë Kosovën ndër vendet me normën më të lartë të rritjes ekonomike në rajon. Krahasuar me vitin paraprak kur norma reale e rritjes ishte 2.5 përqind dhe ishte shënuar ngadalësim i rritjes ekonomike, viti 2013 është karakterizuar me përshpejtim të rritjes ekonomike gjë që shfaqë shenja të një rikuperimi ekonomik që pritet të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm. Si do që të jetë, adresimi i sfidave kryesore për ekonominë e Kosovës, siç është zvogëlimi i mëtejme i normës së papunësisë, kërkon norma edhe më të larta të rritjes ekonomike. Rritja e ekonomisë së Kosovës gjatë kësaj periudhe kryesisht pritet t'i atribuohet rritjes së konsumit, përderisa neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar lehtë negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Në anën tjetër, efekti i investimeve në normën reale të rritjes mund të konsiderohet të ketë qenë neutral.

Ekonomia e Kosovës edhe gjatë kësaj periudhe u karakterizua me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, i cili arriti në 6.4 përqind të PBB-së. Deficiti në llogarinë rrjedhëse kryesisht shkaktohet nga deficiti i lartë tregtar, i cili deri diku neutralizohet nga remitencat e pranuar në Kosovë. Në vitin 2013, importet shënuan rënie për mbi 2 përqind ndërsa eksportet shënuan rritje vjetore prej mbi 6 përqind. Situata më e favorshme për sa i përket të hyrave nga jashtë u reflektua edhe përmes rritjes së remitencave për 2.5 përqind gjatë vitit 2013, si dhe rritjes së investimeve të huaja direkte për 13.3 përqind krahasuar me vitin paraprak. Gjatë vitit 2013, inflacioni kishte një normë të moderuar prej 1.8 përqind e cila ishte më e ulët në krahasim me vitin 2012. Ky nivel i inflacionit është edhe si rezultat i presioneve deflacioniste në vendet eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të aktivitetit tregtar. Ekonomia e

Kosovës vazhdon të ketë pozicion të favorshëm për sa i përket stabilitetit të sektorit fiskal si në kontekst të bilancit buxhetor ashtu edhe në kontekst të nivelit të borxhit publik.

Sistemi financiar i Kosovës ka vazhduar të reflektojë nivel të lartë të qëndrueshmërisë në të gjithë sektorët përbërës të tij. Sidoqoftë, aktiviteti ndërmjetësues financiar, përkundër se ka vazhduar të rritet, ritmi i rritjes ka vazhduar të karakterizohet me tendencë ngadalësimi. Në dhjetor 2013, vlera e gjithsej kredive arriti në 1.81 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.4 përqind, krahasuar me normën e rritjes prej 3.8 përqind në dhjetor 2012. Ngadalësimi i ritmit të kredidhënies është kryesisht pasojë e kombinimit të faktorëve nga ana e ofertës dhe kërkesës për kredi për ndërmarrjet. Standardet e kreditimit për ndërmarrjet rezultojnë të kenë shfaqur tendencë shtrëngimi, përderisa bankat kanë raportuar edhe për rënie të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, sidomos nga ndërmarrjet e mëdha. Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive të ndërmarrjeve vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat në dhjetor 2013 kishin një pjesëmarrje prej 52.6 përqind..

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë depozitat e mbledhura brenda vendit, rritja e vazhdueshme e të cilave i bënë ato një burim të qëndrueshëm financimi. Në dhjetor 2013, gjithsej depozitat arritën vlerën prej 2.4 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 7.5 përqind. Burimi kryesor i depozitave në sektorin bankar të Kosovës vazhdojnë të jenë ekonomitë familjare, depozitat e të cilave konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit. Sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë nivel të ulët të ekspozimit ndaj sektorit të jashtëm si në kuadër të aseteve ashtu edhe të depozitave, duke bërë që ndjeshmëria e sektorit ndaj zhvillimeve në tregjet e jashtme të jetë e ulët.

Aktiviteti ndërmjetësues financiar i bankave në Kosovë u karakterizua me rënie të normave të interesit si në kredi ashtu edhe në depozita. Në dhjetor 2013, norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 11.1 përqind nga 12.9 përqind sa ishte në dhjetor 2012. Për sa i përket depozitave, norma mesatare e interesit ishte 2.4 përqind, krahasuar me 3.7 përqind sa ishte në vitin paraprak. Rrjedhimisht, dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozita u zvogëluar në 8.7 pp nga 9.1 pp sa ishte paraprakisht.

Përkundër ngadalësimit të kredidhënies dhe ngushtimit të margjinës së normave të interesit, sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2013 shënoi rritje të konsiderueshme të fitimit. Neto fitimi i realizuar në vitin 2013 arriti vlerën prej 26 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 40.7 përqind. Rritja e fitimit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhe kryesisht reflekton masat e ndërmarrja nga bankat për të zvogëluar shpenzimet, përderisa të hyrat shënuan vetëm një rritje të lehtë. Në kuadër të gjithsej shpenzimeve, me rënie më të theksuar u karakterizuan shpenzimet për provizione, gjë e cila reflekton faktin se shkalla e përkeqësimit të cilësisë së kredive në vitin 2013 ishte më e ulët se sa në vitin 2012.

Sektori bankar i Kosovës ka vazhduar të karakterizohet me menaxhim të mirë të rreziqeve bankare, gjë që ka rezultuar në një sektor bankar me pozicion të mirë likuiditeti, cilësi të mirë të portofolit kreditor, dhe nivel të lartë të kapitalizimit. Rritja më e shpejtë e depozitave në krahasim me rritjen e kredisë ka bërë që raporti kredi depozita në dhjetor 2013 të jetë 73.7 përqind gjë që flet për gjendje të kënaqshme të likuiditetit në sektorin bankar. Poashtu, raporti ndërmjet mjeteve likuide dhe detyrimeve afatshkurtra, që me rregulloren përkatëse të Bankës Qendrore kërkohet të mbahet në një nivel minimal prej 25 përqind, në dhjetor 2013 qëndroi në 48 përqind. Bankat kanë vazhduar të mbajnë nivel më të lartë të rezervave në Bankën Qendrore se sa që është niveli minimal i kërkuar. Rezultatet e stres-testit për sektorin bankar, të bazuar në skenarë mjaft konzervativ për sa i përket disponueshmërisë së aseteve likuide dhe normës së mundshme të tërheqjes së depozitave, poashtu paraqesin rezultate mjaft të favorshme për sa i

përket aftësisë së sektorit bankar të Kosovës për të shërbyer tërheqje më të theksuara të depozitave.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë cilësi të mirë të portofolit kreditor me një pjesëmarrje të kredive joperformuese në gjithsej kreditë prej 8.7 përqind në dhjetor 2013, që paraqet nivelin më të ulët në kuadër të vendeve të rajonit. Megjithatë, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, vërehet një rritje e pjesëmarrjes së kredive joperformuese në gjithsej kreditë prej 1.2 pp. Rritja e raportit ndërmjet kredive joperformuese dhe gjithsej kredive në radhë parë i atribuohet ngadalësimit të rritjes së gjithsej kredive, përderisa vlera e kredive joperformuese nuk është karakterizuar me përshejtim të ritmit të rritjes. Megjithatë, rritja e kredive joperformuese mund të jetë edhe refleksion i zhvillimeve në aftësinë paguese të kredimarrësve, marrë parasysh se normat e rritjes ekonomike në vitet e fundit, përkundër se pozitive, ishin më të ulëta krahasuar me periudhën para krizës globale financiare. Përkundër rritjes, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizionet për humbje nga kreditë. Në dhjetor 2013, shkalla e mbulueshmërisë me provizione ishte 110.6 përqind, gjë që tregon se bankat kanë ndarë një nivel të kënaqshëm të rezervave për t'u ballafaquar me humbjet e mundshme nga kreditë. Në kuadër të strukturës së kredive të sektorit bankar është evidentuar rritje e vlerës së ekspozimeve të mëdha kreditore, që paraqet rritje të ekspozimit të bankave ndaj rrezikut kreditor. Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin se rritja e vlerës së ekspozimeve është ndikuar pjesërisht nga ndryshimet në rregulloren e BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit, si rezultat i së cilës është ndryshuar mënyra e klasifikimit të kapitalit të klasit të parë.

Niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit në sektorin bankar të Kosovës vazhdoi të jetë i lartë. Në dhjetor 2013, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në 16.7 përqind, që tejkalon nivelin minimal prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore. Përveç nivelit të lartë të kapitalizimit, sektori bankar i Kosovës karakterizohet edhe me cilësi të mirë të kapitalit, ku kapitali i klasit të parë përfaqëson 76.5 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ. Niveli i kënaqshëm i kapitalizimit të sektorit bankar tregohet edhe nga rezultatet e stres-testit të cilat sugjerojnë se niveli aktual i kapitalizimit i mundëson bankat të përballojnë edhe norma më të theksuara të rritjes së kredive joperformuese ose rreziqe të tjera bankare siç është rreziku i tregut. Bankat të cilat operojnë në Kosovë mund të konsiderohen se kanë shkallë të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të tregut si rezultat i faktit që pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave kanë normë fikse të interesit si dhe faktit që pjesa dërmuese e asetëve dhe detyrimeve janë në valutën euro.

Përderisa infrastruktura bankare gjatë kësaj periudhe u karakterizua me zvogëlim të numrit të nëndegëve dhe numrit të punësuarve, rritja e vazhdueshme e rrjetit të bankomatëve dhe pajisjeve POS nga sektori bankar ndikoi në rritjen e efikasitetit të shërbimeve bankare. Sistemi i pagesave gjatë vitit 2013 ka avancuar si në kuadër të bazës ligjore, ashtu edhe në aspektin e rritjes së efikasitetit. Në maj 2013, hyri në fuqi Ligji për Sistemin e Pagesave i cili ka mundësuar përforcimin e kompetencave të BQK-së për mbikëqyrjen, monitorimin dhe kontrollin e sistemit të pagesave dhe infrastrukturës së tregjeve financiare, me qëllim të sigurimit të një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Rritja e sigurisë në sistemin e pagesave ka ndikuar në rritjen e mëtejme të numrit dhe vlerës së transaksioneve të kryera përmes sistemit të vetëm ndërbankar të pagesave në Kosovë (SEKN). Në kuadër të zgjerimit të infrastrukturës së sistemit të pagesave, vlen të theksohet fillimi i përfshirjes së sistemit të tregtimit, depozitimit dhe shlyerjes së letrave me vlerë (angl.CSD: Central Securities Depository) në kuadër të sistemit të pagesave, ku realizohet shlyerja e transaksioneve të letrave me vlerë. Në fund të vitit 2013, Kosova poashtu siguroi kodin e veçantë shtetëror SWIFT me të cilin do të identifikohen institucionet financiare që operojnë në Kosovë gjatë realizimit të transfereve ndërkombëtare. Kjo pritjet të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e kostos së transfereve ndërkombëtare.

Për sa i përket institucioneve tjera financiare, asetet e sistemit pensional vazhduan të rriten, duke arritur vlerën prej 918.9 milionë euro në dhjetor 2013, që paraqet një rritje vjetore prej 23.3 përqind. Pjesa më e madhe e aseteve të sistemit pensional vazhdon të menaxhohet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK), asetet e të cilit shënuan përmirësim të performancës e cila u shpreh si në rritje të çmimit të aksionit ashtu edhe në kthimin pozitiv nga investimet. Me rritje të veprimtarisë u karakterizua edhe sektori i sigurimeve, asetet e të cilit arritën vlerën prej 132 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 përqind. Sektori i sigurimeve vazhdoi të operojë me humbje edhe gjatë vitit 2013, mirëpo për dallim nga viti 2012, humbja u zvogëlua në masë të konsiderueshme. Për dallim nga komponentët tjerë të sistemit financiar të Kosovës, sektori i institucioneve mikrofinanciare shënoi zvogëlim të aktivitetit. Vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2013 ishte 112.9 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 2.5 përqind.

3. Mjedisi i jashtëm ekonomik

Zhvillimet ekonomike në nivel global gjatë vitit 2013 u karakterizuan me trende pozitive, por se normat e rritjes ekonomike ishin lehtë më të ulëta në krahasim me vitin paraprak. Vlerësimet e FMN-së janë se rritja ekonomike globale më vitin 2013 ishte 3.0 përqind, krahasuar me 3.2 përqind në vitin 2012. Aktiviteti ekonomik në nivel global është nxitur nga vendet e zhvilluara, ndërsa vendet në zhvillim, edhe pse u karakterizuan me trende pozitive, kishin norma më të ulëta të rritjes.

Tabela 1. Indikatorë të zgjedhur makroekonomik


Përshkrimi	PBB		Inflacioni		Llogaria rrjedhëse (% e PBB-së)	
	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Ekonomia Globale	3.2	3.0	3.9	3.6		
Eurozona	-0.7	-0.5	2.5	1.3	2.0	2.9
Vendet në zhvillim	5.0	4.7	6.0	5.8	1.4	0.7
Evropa Evropiane në zhvillim	1.4	2.8	5.8	4.1	-4.5	-3.9

Burimi: FMN (Prill 2014)

Në vitin 2013, Eurozona u karakterizua me recesion duke shënuar normë negative të rritjes ekonomike prej 0.5 përqind, që u nxit nga problemet e vazhdueshme në sektorin fiskal dhe financiar në vendet periferike si Spanja, Italia, Greqia, Portugalia dhe Sllovenia, por edhe vendet tjera si Holanda (Tabela 1). Në anën tjetër, vendet si Gjermania dhe Franca edhe pse nuk kishin recesion, kishin rritje mjaft të ulët prej 0.5 përkatësisht 0.2 përqind. Recesioni në Eurozonë gjatë vitit 2013 ishte si rezultat i nivelit relativisht të ulët të

besueshmërisë për përmirësime në sektorin real të ekonomisë, si dhe shqetësimeve rreth borxhit publik. Gjatë vitit 2013, borxhi publik arriti në 95.7 përqind të PBB-së krahasuar me 92.9 përqind në vitin 2012 përkundër se deficiti buxhetor shënoi rënie. Mungesa e rritjes ekonomike e bën sfiduese ruajtjen e qëndrueshmërisë së borxheve në Eurozonë. Në anën tjetër, niveli i përmbajtur i shpenzimeve publike së bashku me dobësimin e kërkesës së sektorit privat kanë ndikuar në rënien e nivelit të inflacionit në eurozonë në 1.5 përqind (objektiva e ECB-së për inflacion është rreth 2 përqind), duke rritur presionet deflacioniste në vend (Figura 1). Gjithashtu, problemet në sistemin financiar, i cili gjatë viteve të fundit ka lëvizur në drejtim të zvogëlimit të aktivitetit ndërbankar, konsiderohen të kenë kontribuar në krijim të mëtejme të pasigurive. Me qëllim të nxitjes së aktivitetit ekonomik dhe ndërbankar, ECB gjatë vitit 2013 ka ulur dy herë normën bazë të rifincimit. Në maj 2013, norma e rifincimit u zvogëluar nga 0.75 në 0.50 përqind, ndërsa në nëntor 2013 u zvogëluar në nivelin 0.25 përqind, që njëherësh paraqet nivelin më të ulët historik.

Figura 1. Inflacioni në vendet e zgjedhura të eurozonës, në përqindje



Burimi: Eurostat (2014)


Norma e rritjes së kreditimit në Eurozonë gjatë vitit 2013 ishte negative me 2.0 përqind krahasuar me rritjen prej 0.4 përqind në vitin 2012. Gjatë vitit 2013, norma e rritjes së kreditimit mbeti negative si ndaj ndërmarrjeve ashtu edhe ndaj ekonomive familjare, por se ishte kategoria e ndërmarrjeve që kishte rënie më substanciale. Kjo edhe si rezultat i përkeqësimit të kualitetit të portfolios kreditore dhe aftësisë paguese të sektorit privat (Figura 2). Për më tepër, aktiviteti financiar ka mbetur i izoluar vetëm brenda ekonomive të secilit anëtar, si rezultat i rritjes së pasigurive mbi aktivitetin ekonomik, që njëherit ka qenë faktor në zvogëlim të kreditimit përtej kufinjëve politik. Kjo është reflektuar edhe më tutje edhe në rritje të kostos së ndërmjetësimit, sidomos për vendet më të prekura nga kriza. Në anën tjetër, në shumicën e vendeve të Eurozonës, bankat raportuan përmirësim në treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (figura 3).

Masat e shumta të ndërmarra në eurozonë për zvogëlimin e rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, ndër të cilat masat e shtuara të mbikëqyrjes së sektorit financiar si dhe harmonizimi i masave për rregullim dhe mbikëqyrje të sektorit financiar dhe krijimi i një mekanizmi të përbashkët për zgjidhje të krizave (angl: Single Supervisory Mechanism – SSM), pritet të kenë efekt pozitiv në rritjen e besueshmërisë në sektor dhe përmirësimin e kreditimit.

Përfundimisht, megjithëse projeksionet për vitin 2014 janë mjaft inkurajuese


pasi që rritja globale pritet të arrijë në 3.7 përqind dhe kjo rritje pritet të jetë e balancuar në mes të vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim (IMF WOE, 2014), dobësitë që karakterizuan ekonominë globale mbesin prezente edhe për vitin 2014. Ndër rreziqet dominuese sugjerohet të jenë mundësia e prezencës së presioneve deflacioniste në vendet e zhvilluara, vazhdimi i kërkesës së dobët në vendet në zhvillim, si dhe rikuperimi i ngadalshëm në Eurozonë. Në aspektin e zhvillimeve në tregjet financiare në nivel global, pasiguritë dhe rreziqet kryesore sugjerohet të vijnë nga planet për uljen e borxhit publik në eurozonë, si dhe pritjet për rritjen e normës së interesit nga Rezerva Federale e SHBA Rritja e normave të interesit në vendet e zhvilluara rritë rrezikun e lëvizjes së kapitalit nga vendet në zhvillim në drejtim të këtyre vendeve për kërkim të normave më të larta të kthimit, dhe një zhvillim i tillë mund të ndikojë gjithashtu në rritjen e presionit për rregullimin e balanceve të gjendjes nga bankat e eurozonës si dhe zvogëlimin e mëtejshëm të kreditimit ndër-kufitar (angl: deleveraging).

Figura 2. Norma e kredive jopërfomuese në vende të zgjedhura të eurozonës



Burimi: FMN (2014)

Figura 3. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit në vende të zgjedhura të eurozonës, në përqindje



Burimi: FMN (2014)


3.1. Evropa Juglindore

Gjatë vitit 2013, edhe vendet e Evropës Juglindore (EJL) u karakterizuan me aktivitetit pozitiv ekonomik, që kishte për karakteristikë rënie të kërkesës së brendshme, por rritje të kërkesës së jashtme. Kroacia vazhdon të ballafaqohet me rënie të aktivitetit ekonomik prej 0.6%, ndërsa nga recesioni i vitit 2012 doli Bosnja e Hercegovina duke shënuar rritje për 0.5 përqind. Edhe Serbia gjatë vitit 2013 ka kaluar në rritje prej 2.0 përqind kundrejt rënies prej 1.7 përqind në vitin paraprak. Maqedonia e Mali i Zi nga rritja negative prej 0.5 përqind kanë kaluar në rritje prej 1.5 përqind në vitin 2013 (figura 4). Stabilizimi i aktivitetit ekonomik në rajon gjatë vitit 2013 në masë të konsiderueshme i adresohet përmirësimeve në eksporte por edhe rritjes së lehtë të investimeve të huaja direkte (IHD-ve).

Përmirësimi i lehtë i aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2013 në vendet e rajonit është reflektuar edhe në normën e papunësisë. Vlerësimet e Komisionit Evropian tregojnë për rënie të normës së papunësisë në Shqipëri, Maqedoni dhe Serbi, ndërsa në Bosnjë e Hercegovinë ka pasur rritje të lehtë të normës së papunësisë.

Norma mesatare e deficitit të llogarisë rrjedhëse për vendet e EJL-së në vitin 2013 ishte 8.8 përqind e PBB-së (0.2pp më e ulët se në vitin 2012). Të gjitha vendet e EJL-së u karakterizuan me ngushtim të deficitit të llogarisë rrjedhëse, me përjashtim të Maqedonisë e cila rriti deficitin nga 3.0 përqind në 4.5 përqind të PBB-së (figura 5). Mali i Zi, Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina vazhdojnë të kenë nivelin më të lartë të deficitit, ndërsa Maqedonia, Kosova dhe Serbia gjatë vitit 2013 raportuan nivelin më të ulët të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Zvogëlimi i nivelit të deficitit në shumicën e vendeve në rajon ishte rezultat i rënies së çmimeve të produkteve kryesore në tregjet ndërkombëtare si nafta, metalet dhe produktet ushqimore, të cilat ngadalësuan rritjen e vlerës së importeve. Gjithashtu, përveç ngadalësimit të rritjes së importeve, gjatë vitit 2013 rritja e eksporteve në të gjitha vendet e rajonit ishte më e lartë se sa vitin paraprak. Mesatarisht, eksportet gjatë vitit 2013 u rritën me mbi 6 përqind nga vendet e rajonit, krahasuar me eksportet në vitin 2012 që zvogëluan me mbi 5 përqind. Sidoqoftë, efekti i përmirësimeve tregtare u zbeh nga rënia e dërgesave të emigrantëve në disa prej vendeve të rajonit, me përjashtim të Kosovës ku dërgesat e emigrantëve vazhduan të rriten. Ndër komponentat më të rëndësishme në bilancin e pagesave në vendet e rajonit mbeten investimet e huaja direkte që u rritën në masë të konsiderueshme gjatë vitit 2013, sidomos kur merret parasysh se viti 2012 u karakterizua me nivel relativisht të ulët të IHD-ve.


Figura 4. Norma e rritjes së PBB-së reale në EJL



Burimi: FMN (2014) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2014

Stabilizimi i aktivitetit ekonomik në rajon gjatë vitit 2013 në masë të konsiderueshme i adresohet përmirësimeve në eksporte por edhe rritjes së lehtë të investimeve të huaja direkte (IHD-ve).

Figura 5. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në EJL, në përqindje të PBB-së



Burimi: Komisioni Evropian (2013) dhe vlerësimet e BQK-së për Kosovën për vitin 2013


Stabilizimi i aktivitetit ekonomik në rajon gjatë vitit 2013 në masë të konsiderueshme i adresohet përmirësimeve në eksporte por edhe rritjes së lehtë të investimeve të huaja direkte (IHD-ve).

Tendenca rënëse e inflacionit në tregjet ndërkombëtare ka ndikuar që edhe në vendet e rajonit të zbuten presionet inflacioniste. Me përjashtim të Serbisë, ku norma e inflacionit arriti në 8.8 përqind, çmimet në vendet tjera rajonale u karakterizuan me inflacion të moderuar prej mesatarisht 2 përqind (figura 6). Sa i përket performancës së sektorit fiskal, shumica prej vendeve të rajonit u karakterizuan me performancë më të dobët si në shpenzime ashtu edhe në të hyrat buxhetore në krahasim me planifikimet fillestare. Sidoqoftë, gjatë vitit 2013, konsiderohet se performanca më e dobët në të hyrat buxhetore ka detyruar vendet rajonale që të shkurtojnë edhe kategori të ndryshme në shpenzime, sidomos shpenzimet kapitale.

Sektori financiar në vendet e rajonit ka përcjellur zhvillime të ngjashme me vendet e Eurozonës, duke u karakterizuar me rënie ose ngadalësim të kreditimit. Aktiviteti kreditor ka pasur norma negative të rritjes në Shqipëri, Serbi, ndërsa me norma mjaft të ngadalësuara të rritjes në vendet tjera si Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë dhe Kosovë. Kjo në shumë raste ka ardhur edhe si rezultat i bankave të huaja, që u janë nënshtruar rregullave të bankave amë për zgjerim të kujdesshëm në nivel të grupeve të tyre për sa i përket kreditimit. Depozitat në pothuajse të gjitha vendet e rajonit kanë shënuar rritje edhe gjatë vitit 2013. Sa i përket kualitetit të portfolios kreditorë, gjatë vitit 2013 kreditë joperformuese si përqindje e gjithsej kredive në të gjitha vendet e rajonit shënuan norma dyshifrore, duke arritur në 23.5 përqind në Shqipëri, 14.9 përqind në Bosnjë e Hercegovinë, 10.9 përqind në Maqedoni dhe në 20.6 përqind në Serbi. Kosova mbetet vendi me kualitetin më të mirë të portfolios kreditorë ku në dhjetor kreditë joperformuese ishin 8.7 përqind. Sa i përket kapitalizimit në disa nga vendet rajonale treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit është rritur lehtë. Niveli i kapitalizimit në Shqipëri u rrit nga 16.2 në 17.9 përqind të gjithsej asetëve, në Kosovë nga 14.2 përqind në 16.7 përqind dhe në Serbi nga 19.9 në 20.5 përqind. Në Bosnjë e Hercegovinë, treguesi i kapitalizimit mbeti në nivel të njëjtë me vitin paraprak prej 17.0 përqind, ndërsa në Maqedoni shënoi rënie të lehtë nga 17.1 në 16.8 përqind.

Disa nga vendet te EJJ-së janë përballur me zvogëlim të financimit të jashtëm për sektorin financiar, dhe pritjet për vitin 2014 janë që kushtet e financimit të jashtëm të përkeqësohen edhe më tutje si rezultat i pritjes për rritje të normës së interesit nga Rezerva Federale, si dhe masave të shtuara të monitorimit të bankave nga Banka Qendrore Evropiane. Këto zhvillime mund të paraqesin pasiguri për mundësitë e financimit të jashtëm të bankave të EJJ-së dhe rrjedhimisht për zhvillimet në sektorin e kreditimit në vendet e EJJ-së të cilat janë më të ekspozuara ndaj këtyre faktorëve (sektori bankar i të cilave ka bilanc të gjendjes më të dobët: nivel të lartë të NPL-ve, profitabilitet të ulët, dhe mbështetje të lartë të financimit nga burimet e jashtme). Gjithësesi, fakti që këto vende kanë filluar përshtatjen e modelve të tyre të financimit, duke zvogëluar mbështetjen në burimet e jashtme të financimit, e zvogëlon ekspozimin ndaj këtij rreziku.

Figura 6. Norma mesatare vjetore e inflacionit në EJJ



Burimi: Komisioni Evropian (2014)

Kutia 1. Performanca e grupeve kryesore bankare që operojnë në Kosovë

ProCredit Holding – PCH (Gjermani)


Treguesit kryesorë financiar të Procredit Holding (PCH) janë karakterizuar me një performancë të kënaqshme gjatë vitit 2013. Vlera e gjithsej asetëve të PCH në fund të vitit 2013 arriti në 5.84 miliardë euro, duke shënuar rritje prej 1.3 përqind në krahasim me fundin e vitit 2012. Megjithatë, duke marr parasysh ambientin ende të vështirë makroekonomik që mbizotëroi gjatë kësaj periudhe sidomos në Evropën Lindore, që njëkohësisht menaxhon rreth 70 përqind të gjithsej asetëve të grupit, asetet e PCH u karakterizuan me rritje më të ngadalshme në vitin 2013, krahasuar me vitin paraprak. Gjithashtu, ngadalësimi i rritjes së vlerës së asetëve të PCH-së mund t'i atribuohet edhe zhvlerësimit të dollarit amerikan ndaj euros, duke pasur parasysh se 60.1 përqind e bilancit të gjendjes së PCH-së janë në dollarin amerikan ose valuta tjera të lidhura ngushtë me dollarin amerikan. Struktura e bilancit të gjendjes së PCH-së mbetet e thjeshtë, me asetet që kryesisht përbëhen nga kreditë biznesore dhe detyrimet nga depozitat e konsumatorëve. Në vitin 2013, aktiviteti i përgjithshëm kreditor i PCH shënoi vlerën prej 4.19 miliardë euro, që tregon për një rënie vjetore prej 0.1 përqind (Figura 7).

Kreditë biznesore, që dominojnë strukturën e gjithsej kredive të PCH-së, u karakterizuan me rënie vjetore prej 2.4 përqind. Rritje të aktivitetit kreditor u shënuar vetëm për sektorin e bujqësisë në vitin 2013. Zvogëlimi i aktivitetit kreditor gjatë vitit 2013 kryesisht rezultoi nga kërkesa më e ulët për shërbime bankare në përgjithësi, veçanërisht për kreditë investive në Evropën Lindore, përderisa rritje të kërkesës për kredi u evidentua kryesisht nga bizneset që kishin për qëllim rritjen e kapitalit punues.

PCH kryesisht siguron ndërmjetësim financiar lokal, duke financuar aktivitetin kreditor përmes depozitave të mbledhura brenda vendit. Në vitin 2013, depozitat në PCH-së arritën vlerën 3.8 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 4.8 përqind (6.1 përqind në 2012) (Figura 8). Rritja më e ngadalshme e gjithsej depozitave dhe zvogëlimi i aktivitetit kreditorës ka rezultuar në zvogëlimin e raportit të kredive ndaj depozitave. Ky raport në vitin 2013 arriti në 110 përqind, nga 115 përqind në 2012.


Indikatori i përgjithshëm i efikasitetit, shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ka shënuar rënie prej rreth 0.7 pikë përqindje duke rënë kështu në 75 përqind në vitin 2013 (Figura 9). Përmirësimi i treguesit të efikasitetit kryesisht i atribuohet rënies më të shpejtë të shpenzimeve operacionale (2.1 përqind në vitin 2013), kundrejt rënies së të hyrave operacionale për 1.1 përqind. Rënia më e shpejtë e shpenzimeve operacionale mund të ketë rezultuar nga zvogëlimi i numrit të punëtorëve për 21.5 përqind në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak. Zvogëlimi i shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të personelit neutralizoi deri në një masë realizimin më të ulët të të hyrave, veçanërisht të hyrave nga interesi. Megjithatë, profiti neto në vitin 2013 rezultoi të jetë për 15.8 përqind më i ulët se profiti i realizuar në vitin paraprak, duke zbritur në 38.9 milionë euro (46.3 milion euro në vitin 2012).

Figura 7. Trendi i rritjes së kredive, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Figura 8. Trendi i rritjes së depozitave, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Norma e kthimit në kapital (ROE) ishte në nivel relativisht të lartë prej 7.7 përqind, megjithëse me një rënie prej 2.6pp krahasuar me vitin paraprak (Figura 10). Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. *Capital Adequacy Ratio: CAR*) qëndroi në 12.2 përqind në vitin 2013 (12.9 përqind në vitin 2012) që paraqet nivel të kënaqshëm të kapitalizimit (Figura 11). Sipas vlerësimit nga agjensioni Fitch, shkalla e rangimit kreditor (angl. credit rating) e PCH-së mbeti e njëjtë me vitin paraprak, gjegjësisht BBB-. Poashtu, rangimi kreditor ndërkombëtar (angl. international rating) në përgjithësi mbeti në nivel të njëjtë, me përjashtim të PCB-së në Serbi që shënoi rënie nga BB- në B+ dhe PCB-së në Ukrainë nga B në B-. Në Kosovë, rangimi kreditor i PCB-së ruajti nivelin e njëjtë me vitin e kaluar, duke qëndruar në B.


Raiffeisen Bank International – RBI (Austri)

Si pasojë e dobësimit të disa valutave (dollarit amerikan, rublës ruse, krunës qeke dhe hryvnies së Ukrainës) kundrejt euros, si dhe aktivitetit më të dobët kreditor si pasojë e zvogëlimit të kërkesës për kredi nga klientët e korporatave në një ambient ende të ndjeshëm makroekonomik, asetet e Raiffeisen Bank International (RBI) u zvogëluan për 4 përqind në vitin 2013 dhe shënuan vlerën prej 130.6 miliard euro. Portofoli kreditor i RBI-së u karakterizua me rënie vjetore prej 3.2 përqind dhe zbriti në 80.6 miliard euro (Figura 7). Ndryshe nga kreditë, depozitat shënuan rritje vjetore prej 0.2 përqind dhe arritën vlerën prej 66.4 miliard euro në vitin 2013. Depozitat mbesin forma kryesore e financimit të aktiviteteve të RBI-së, me një pjesëmarrje prej 50.8 përqind në gjithsej detyrimeve.

Indikatori i përgjithshëm i efikasitetit, i shprehur përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, ka shënuar përmirësim duke u zvogëluar në 58.3 përqind në 2013 nga 61.5 përqind në 2012, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave operacionale. Të hyrat operacionale shënuan rritje vjetore prej 8.2 përqind në 2013. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative shënuan rritje për 2.5 përqind, kryesisht si rezultat i hapjes së degës në Poloni, rritjes së pagave në Rusi, shpenzimeve tjera administrative dhe shpenzimeve të amortizimit. Këto zhvillime ndikuan në zvogëlimin e profitit të RBI-së për 23.6 përqind në vitin 2013, duke zbritur në 557 milion euro.

Kthimi në kapital i RBI-së në 2013 u zvogëluar në 5.7 përqind nga 7 përqind sa ishte në 2012. Vlera e kredive jo-performuese ndaj totalit të kredive u rrit në 10.7 përqind në 2013 nga 9.8 sa ishte në 2012 (Figura 12). Në 2013, mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione qëndroi në 63.1 përqind.


Figura 9. Raporti i shpenzimeve ndaj të ardhurave, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)


Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Figura 10. Kthimi në kapital (ROE), në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Figura 11. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit CAR, në përqindje



Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

Shkalla e rangimit kreditor të RBI-së mbetet e ngjashme me vitin e kaluar. Moody ka vlerësuar RBI-në me notën A2 për periudhë afatgjatë dhe P-1 në periudhë afatshkurtër. Ndërsa, prospektet i ka konsideruar 'negative' krahasuar me 'stabile' në vitin e kaluar. S&P ka vlerësuar me notën A për periudhën afatgjatë dhe A-1 për atë afatshkurtër, me prospekte 'negative' sikurse vitin e kaluar. Fitch ka vlerësuar me notën A për periudhën afatshkurtër dhe F1 për atë afatgjatë me prospekte 'stabile' sikurse vitin e kaluar. RBI është e vetmja nga tri grupet bankare të tri bankave më të mëdha që operojnë në Kosovë që tregton aksionet e saj në bursë. Çmimi për aksion në bursën e Vjenës filloi me 31.46 euro duke arritur në 33.59 euro në mes të janarit. Në korrik, çmimi për aksion zbriti në vlerën më të ulët prej 18.6 euro për aksion dhe më pas u rikuperua duke arritur në 25.62 euro në fund të dhjetorit 2013.

NLB Group (Slloveni)

NLB Group është korporata më e madhe financiare sllovene me gjithsej 8 banka që operojnë në vende të ndryshme, përfshirë Slloveninë, Bosnje e Hercegovinën, Kosovën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë. NLB Group poashtu ka në pronësi 36 kompani që ofrojnë shërbime të ndryshme financiare (kompani të sigurimit, të menaxhimit të aseteve, lizingut etj.).


Vlera e gjithsej aseteve të NLB Group, në fund të vitit 2013, arriti në 12.5 miliard euro, që paraqet një rënie vjetore prej 12.9 përqind. Kjo rënie e vlerës së aseteve të NLB Group mund të jetë pasojë e krizës

nëpër të cilën po kalon sektori bankar në Slloveni. Gjatë kësaj periudhe, NLB group shënoi rënie si të kredive ashtu edhe depozitave. Rënia e kreditimit gjatë vitit 2013 ishte kryesisht pasojë e zvogëlimit të portfolios kreditorë të korporatave për 31 përqind, kurse niveli i kredive për ekonomitë familjare mbeti i ngjashëm me vitin paraprak. Në anën e depozitave, rënie ishte e evidente si te depozitat e ekonomive familjare ashtu edhe te ato të korporatave. Zvogëlimi më i shpejtë i kredive në raport me depozitat bankare ndikoi që raporti kredi/depozita të zvogëlohet në 93.7 përqind në 2013 nga 104.7 përqind në 2012. Pjesa tjetër e financimit të NLB Group u mundësua nga marrja e huave nga Banka Qendrore Evropiane, borxheve tjera dhe kapitali vetanak.

Treguesit e profitabilitetit u karakterizuan me rënie, që i atribuohet deri në një masë rritjes së shpenzimeve të provizioneve si pasojë e rritjes së kredive joperformuese. Si rrjedhojë, humbjet neto të NLB Group në 2013 arritën në 1.4 miliard euro, krahasuar me humbjet prej 274 milion euro në 2012. Kthimi në Kapital (angl. Return on Equity) qëndroi në -135.5 përqind në 2013, krahasuar me -25.0 përqind në 2012. Megjithatë, NLB Group ka përforcuar nivelin e kapitalizimit. Në vitin 2013, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) u përmirësua në 15.2 përqind, krahasuar me 10.6 sa ishte në vitin 2012, përderisa mbulueshmëria e kredive jo performuese me provizione u përmirësua në 17.8 përqind nga 16.7 sa ishte në 2012 (Figura 12). Niveli i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjithashtu shënoi rritje në 72.8 përqind në 2013 krahasuar me 55.3 përqind në 2012.

Duke marrë për bazë zhvillimet në sektorin bankar në Slloveni dhe, veçanërisht, performancën e NLB Group, aftësia kreditorë e saj është ulur nga agjensioni për vlerësim kreditor Moody. Në vitin 2013, Moody ka ulur aftësinë kreditorë të NLB Group nga B2 në Caa2. Në anën tjetër, Fitch ka përmirësuar vlerësimin e rangimit kreditor të NLB group, duke e ngritur atë nga BBB- në BB-.

Figura 12. Trendi i kredive jo performuese, në përqindje



Shënim: Të dhënat për KJP-të e ProCredit Holding nuk janë në dispozicion
Burimi: Raportet vjetore të grupeve bankare përkatëse (2014)

4. Ekonomia e Kosovës


Zhvillimet në treguesit kryesorë makroekonomik tregojnë për aktivitet të përshpejtuar gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Sipas vlerësimeve të ASK-së, ekonomia e Kosovës shënoi një normë relativisht të lartë të rritjes ekonomike prej 3.4 përqind në vitin 2013 (Figura 13). Aktiviteti ekonomik në vend gjatë vitit 2013 u mbështet kryesisht nga rritja e konsumit dhe përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve, përderisa investimet mbeten me efekt po thuaj se neutral. Komponenta kryesore e PBB-së në Kosovë vazhdon të jetë konsumi, me pjesëmarrje prej 104.2 përqind. Konsumi privat gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje reale prej 2.0 përqind, ndërsa konsumi publik ka shënuar rritje prej 3.3 përqind. Rritja e konsumit privat kryesisht i atribuohet rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese gjatë kësaj periudhe, përderisa rritja e shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë i kontribuoj rritjes së konsumit publik.

Investimet vlerësohet të kenë shënuar rënie reale për 0.3 përqind në vitin 2013, megjithëse për dallim nga viti paraprak kur rënia reale është vlerësuar të ketë qenë mbi 10 përqind, pozicioni i tyre gjatë vitit 2013 konsiderohet të jetë stabilizuar. Përgjithësisht, stabilizimi i investimeve vlerësohet të jetë nxitur nga rritja e investimeve private në vitin 2013, më konkretisht nga rritja e investimeve të huaja direkte (IHD) dhe kredive investuese.

Pozicioni i neto eksporteve u karakterizua me përmirësim si në terma real, ashtu edhe në nominal gjatë vitit 2013. Pozicioni i neto eksporteve u përmirësua për 3.6 përqind, duke kontribuar pozitivisht në rritje ekonomike. Rritja reale e eksporteve për 12.8 përqind dhe rënia reale e importeve për 2.9 përqind ndikoi që pozita e bilancit tregtar në mallra të përmirësohet. Sa i përket shërbimeve, eksporti real i tyre shënoi rënie për 2.2 përqind, ndërsa importi i tyre shënoi rritje për 10.1 përqind.


Inflacioni në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (angl: Consumer Price Index: CPI), gjatë vitit 2013 u karakterizua me rënie. Norma mesatare vjetore e inflacionit në vitin 2013 ishte 1.8 përqind, krahasuar me normën prej 2.5 përqind në vitin 2012 (Figura 14). Trendi i rënies së inflacionit ka vazhduar gjatë gjithë vitit 2013 duke arritur në 0.6 përqind në muajin dhjetor. Rënie e shkallës së inflacionit është shkaktuar kryesisht nga çmimet e mallrave të importuara, kryesisht produkteve ushqimore dhe pijeve joalkoolike, gjë që reflekton zhvillimet deflacioniste në vendet e Eurozonës me të cilat Kosova realizon pjesën më të madhe të shkëmbimeve tregtare. Ndërsa, çmimet e prodhimit u karakterizuan me rritje

Figura 13. Rritja Reale e PBB-së, në përqindje



Burimi: ASK (2013), (f) Projektion i BQK-së (2014)

Figura 14. Inflacioni dhe kontribuesit kryesor të tij



Burimi: ASK (2014) me kalkulime të BQK-së

vjetore prej 2.5 përqind, rritje kjo e cila është nxitur nga rritja e çmimeve të nxjerrjes së qymyrgurit, linjitit, mineraleve dhe produkteve të industrive tjera nxjerrëse.


Gjatë vitit 2013, norma reale efektive e këmbimit (NREK) të valutës euro kundrejt valutave të vendeve partnere tregtare të Kosovës u vlerësua për mesatarisht 0.2 përqind. Vlerësimi i NREK në vitin 2013 ishte kryesisht pasojë e nivelit më të lartë të çmimeve të shënuara në Kosovë kundrejt çmimeve të shënuara në vendet partnere tregtare. NREK u vlerësua për 0.3 përqind ndaj vendeve të BE-së, ndërsa u zhvlerësua për 0.5 përqind ndaj vendeve të CEFTA-së, duke nënkuptuar rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve kosovare ndaj vendeve të CEFTA-s dhe njëkohësisht zvogëlimin e konkurrueshmërisë ndaj vendeve të BE-së.

Spektori fiskal gjatë vitit 2013 u karakterizua me rënie të lehtë të të hyrave dhe rritje të shpenzimeve. Të hyrat buxhetore¹ shënuan rënie prej 0.4 përqind, si rezultat i rënies së të hyrave të mbledhura nga tatimet në kufi, dhe arritën vlerën prej rreth 1.3 miliardë euro. Në anën tjetër, vlera e përgjithshme e shpenzimeve buxhetore² arriti në rreth 1.5 miliardë euro, që paraqet rritje vjetore prej 1.9 përqind, të ndikuar nga rritja e shpenzimeve rrjedhëse. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar prej 152.7 milionë euro ose 2.9 përqind të PBB-së (2.4 përqind të PBB-së në vitin 2012). Ndërsa borxhi i përgjithshëm i Qeverisë është rritur për 16.1 përqind dhe ka vlerën prej 475.7 milionë euro që është ekuivalente me 9.1 përqind të PBB-së.

Spektori i jashtëm u karakterizua me përmirësim të pozicionit tregtar (Figura 15). Rritja vjetore e transfereve rrjedhëse, të dominuara nga remitencat që në vitin 2013 u karakterizuan me një rritje vjetore prej 2.5 përqind, ndikoi në tkurrjen vjetore prej 10.7 përqind të deficitit të komponentës së llogarisë rrjedhëse të bilancit të pagesave të Kosovës. Pozicioni i llogarisë kapitale dhe financiare gjithashtu shënoi përmirësim të mëtejshëm, që vazhdon të përcaktohet kryesisht nga lëvizjet në investimet e huaja direkte në vend, të cilat shënuan rritje vjetore prej 13.1 përqind.

Në përgjithësi, indikatorët e mësipërm tregojnë për përmirësim të ambientit ekonomik dhe performancë pozitive të gjithë sektorëve të ekonomisë gjatë vitit 2013. Spektori real u karakterizua me rritje ekonomike dhe stabilitet të çmimeve të cilat ndikojnë në uljen e rreziqeve për sektorin financiar. Përmirësimet në sektorin e jashtëm, si rezultat i përmirësimit relativ të pozicionit tregtar, si dhe rritja e remitencave dhe IHD-ve gjithashtu sugjerohet të kenë ndikim direkt dhe indirekt në zbutjen e rreziqeve për sektorin financiar duke ndikuar në rritjen e kërkesës për kredi dhe potencialin për shlyerjen e detyrimeve kreditore. Borxhi i përgjithshëm i qeverisë, përkundër rritjes, mbetet në nivel mjaft të ulët dhe si i tillë nuk paraqet rrezik për stabilitetin financiar.

Figura 15. Importet, eksportet dhe bilanci tregtar, jo kumulative



Burimi: ASK (2014)

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk janë përfshirë pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve, huazimet e brendshme dhe të jashtme, të hyrat nga privatizimi i distribucionit të KEK-ut, depozitat e ndryshme të cilat mbahen në mirëbesim në emër të palëve të treta deri në përcaktimin e definimit të tyre.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk janë përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, pagesat e borxhit, si dhe kthimi i huazimeve nga ndërmarrjet publike trajtohet si zvogëlim i shpenzimeve buxhetore.

5. Sistemi Financiar i Kosovës

5.1. Karakteristikat e Përgjithshme

Gjatë vitit 2013, sistemi financiar i Kosovës në përgjithësi u karakterizua me rritje të aktivitetit. Gjithsej asetet e sistemit, deri në dhjetor 2013, arritën vlerën prej 4.2 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.5 përqind (Figura 16). Rritja e gjithsej asetëve të sistemit financiar kryesisht i atribuohet rritjes së asetëve të fondeve pensionale dhe asetëve të bankave komerciale, dhe rritjes së lehtë të asetëve të kompanive të sigurimit. Asetet e fondeve pensionale shënuan rritje vjetore prej 23.3 përqind, në fund të vitit 2013, gjë që u reflektua edhe në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në gjithsej sistemin financiar (21.7 përqind).


Sektori bankar mbetet sektori kryesor për nga madhësia e asetëve të cilat deri në dhjetor 2013 përfaqësojnë rreth 72 përqind të gjithsej asetëve të sistemit financiar (Figura 17). Gjatë vitit 2013, asetet e sektorit bankar shënuan rritje prej 8.1 përqind, që paraqet një rikuperim të trendit të rritjes duke pasur parasysh ngadalësimin e trendit të rritjes të ndjekur gjatë dy viteve paraprake .

Zgjerim të aktivitetit regjistroi edhe industria e sigurimeve, por ritmi i rritjes ishte më i ulët se sa në vitin paraprak. Asetet e kompanive të sigurimit gjatë vitit 2013 shënuan rritje vjetore prej 1.4 përqind krahasuar me rritjen prej 16.3 përqind sa ishte në vitin 2012. Rritja më e ngadalsuar ndikoi edhe në uljen e pjesëmarrjes në gjithsej asetet e sistemit financiar në 3.1 përqind në dhjetor 2013, nga 3.4 përqind sa ishte në dhjetor 2012.

Sektori i vetëm që shënoi zvogëlim të aktivitetit, duke ndikuar kështu negativisht në rritjen e gjithsej asetëve të sistemit financiar, është sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe ndihmësve financiar. Në vitin 2013, asetet e institucioneve mikrofinanciare shënuan rënie vjetore prej 2.5 përqind, ndërsa asetet e ndërmjetësuesve financiar shënuan rënie vjetore prej 7.5 përqind. Rrjedhimisht, pjesëmarrja e institucioneve mikrofinanciare në gjithsej asetet e sistemit financiar u zvogëlua në 2.7 përqind, ndërsa pjesëmarrja e ndihmësve financiar mbeti përafërsisht e njëjtë me vitin paraprak në 0.2 përqind (Figura 17).


Madhësia e sektorit financiar, e llogaritur si raport i asetëve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), në fund të vitit 2013 ishte 79.4 përqind, krahasuar me 75.7 përqind sa ishte në fund të vitit 2012. Sektori kryesor për nga madhësia dhe pesha në ndërmjetësimin

Figura 16. Trendi i zhvillimit të sistemit financiar dhe sektorëve përkatës



Burimi: BQK (2014)


Figura 17. Struktura e asetëve të sistemit financiar, në përqindje



financiar vazhdon të jetë sektori bankar, asetet e të cilit përfaqësojnë 57.4 përqind të PBB. Për më tepër pesha e sektorit bankar në normën e ndërmjetësimit financiar në vend, gjatë tri viteve të fundit ka ndjekur trend rritës (Figura 18). Sektori pensional gjithashtu ka ndjekur trend rritës të normës së ndërmjetësimit gjatë tri viteve të fundit, duke mbetur sektori i dytë për nga pesha në ndërmjetësimin financiar. Pesha e sektorit të sigurimeve në ndërmjetësimin financiar qëndroi në nivel pothuajse të njëjtë krahasuar me vitin e kaluar, përderisa sektori mikrofinanciar gjatë periudhës së njëjtë zvogëloi peshën e tij në gjithsej ndërmjetësimin.

Përkundër rritjes, sektori bankar i Kosovës vazhdon të ketë një madhësi relativisht të vogël krahasuar me sektorin bankar të vendeve të rajonit. (Figura 19). Në kuadër të rajonit, Serbia dhe Sllovenia kanë normën më të lartë të ndërmjetësimit financiar në rajon. .

Figura 18. Norma e ndërmjetësimit financiar sipas sektorëve ndaj PBB-së, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


Tabela 2. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Bankat komerciale	8	8	9	9
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13
Fondet pensionale	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	38	39
Institucionet mikrofinanciare	17	20	17	17

Burimi: BQK(2014)

Sa i përket numrit të institucioneve financiare që operojnë në Kosovë, struktura e sistemit financiar mbetet e ngjashme me periudhat e kaluara. Në dhjetor 2013, në Kosovë operuan gjithsej 80 institucione financiare, pjesa më e madhe e të cilave përbëhet nga institucionet mikrofinanciare dhe ndihmësit financiar (Tabela 2). Përkundër faktit se IMF-të dhe ndihmësit financiar përbëjnë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, pjesëmarrja e tyre në gjithsej asetet e sistemit financiar mbetet e ulët.

Figura 19. Norma e ndërmjetësimit financiar të sektorit bankar ndaj PBB-së, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

5.2 Ekspozimi ndaj jo-rezidentëve

Asetet e sistemit financiar të Kosovës që janë të investuara jashtë vendit, në vitin 2013 shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind, duke arritur vlerën 3 miliard euro. Struktura e aseteve të jashtme dominohet nga depozitat me pjesëmarrje prej 37.9 përqind, pasuar nga letrat me vlerë me 27.2 përqind dhe asetet tjera me 21.6 përqind, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë ari monetar, paraja e gatshme, kreditë, etj. (Figura 20). Në kuadër të gjithsej aseteve të jashtme, rritjen më të madhe shënuan investimet në letrat me vlerë (68.4 përqind) dhe kreditë (37.8 përqind). Ndërsa, me rënie u karakterizuan paraja e mbajtur në bankat e huaja në formë të depozitave (-9.3 përqind), ari monetar dhe DST-të (-5.9 përqind), kuota me FMN-në (-4.2 përqind).


Figura 20. Struktura e kërkesave të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Vlera e gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, deri në dhjetor 2013, arriti në 455.6 milion euro duke shënuar rritje prej 4.4 përqind, e cila është dukshëm më e ulët se sa rritja prej 15.4 përqind e shënuar në vitin paraprak. Struktura e detyrimeve dominohet nga kreditë me pjesëmarrje prej 31.9 përqind, pasuar nga kuota me FMN-në me 34.2 përqind dhe depozitat me 19.9 përqind (Figura 21). Në kuadër të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, rritjen më të theksuar e shënuan kreditë prej 28.1 përqind, si dhe depozitat që shënuan rritje prej 3.1 përqind.


Figura 21. Struktura e detyrimeve të jashtme, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Deri në dhjetor 2013, vlera e aseteve të jashtme neto (AJN)³ arriti në 2.56 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 9.5 përqind. AJN-të gjatë viteve të fundit kanë ndjekur trend pozitiv të rritjes, por rritja e shënuar gjatë vitit 2013 ishte me e ngadalshme në krahasim me vitin paraprak. Pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej AJN-të vazhdon ta ketë BQK-ja me pjesëmarrje prej 54.4 përqind, sektori bankar përfshinë 22.4 përqind dhe pjesa

Figura 22. Asetet e jashtme neto sipas institucioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

³ Në këtë kontekst, sistemi financiar përfshinë Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë.

e mbetur përfaqësohet nga sektori mikrofinanciar dhe pensional. Segmenti i vetëm që shënoi bilanc negativ të AJN-ve ishte ai i institucioneve mikrofinanciare, kryesisht si rezultat i mbështetjes së lartë në financim të jashtëm në formë të linjave kreditore (Figura 22).

Ekspozimi i sistemit financiar ndaj jo rezidentëve, në përgjithësi mbetet më i theksuar në kuadër të aseteve, krahas ekspozimit të kufizuar në kuadër të detyrimeve. Përjashtuar BQK-në, e cila përbën pjesën më të madhe si kuadër të aseteve ashtu edhe detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm, niveli i ekspozimit të sistemit financiar ndaj sektorit të jashtëm rezulton të jetë më i ulët (Tabela 3). Më konkretisht, përjashtuar asetet e BQK-së, ekspozimi ndaj jo rezidentëve në kuadër të aseteve në dhjetor 2013 ishte 33.2 përqind, ndërsa ekspozimi në kuadër të detyrimeve ishte 5.6 përqind (Figura 23)

Tabela 3. Asetet dhe detyrimet e jashtme të sektorit financiar⁴


Përshkrimi	Përfshirë BQK-në		Përjashtuar BQK-në	
	Vlera në miliard euro	Rritja vjetore	Vlera në miliard euro	Rritja vjetore
Asetet e Jashtme	3.0	8.7%	1.4	7.6%
Detyrimet e Jashtme	0.5	4.4%	0.2	15.4%
Asetet e Jashtme Neto	2.5	9.5%	1.2	6.2%

Burimi: BQK(2014)

Sa i përket ekspozimit sektorial, sektori bankar në përgjithësi ka ekspozim të ulët ndaj sektorit të jashtëm. Sektori bankar është pothuajse i pavarur nga burimet e jashtme të financimit duke marrë parasysh që struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat e jorezidentëve. Ekspozimi në kuadër të aseteve të jashtme është më i lartë në krahasim me detyrimet, por në raport me gjithsej asetet, megjithatë mund të konsiderohet se niveli i ekspozimit vazhdon të jetë i ulët. Në kuadër të sektorit, bankat e mëdha janë më shumë të ekspozuara ndaj sektorit të jashtëm krahasuar me bankat e vogla, si në kuadër të aseteve ashtu edhe të detyrimeve. Kjo para se gjithash reflekton faktin se bankat më të mëdha janë banka të huaja, të cilat kanë një shkallë më të lartë të ndërveprimit me sektorin e jashtëm dhe veçanërisht me bankat e tyre amë.

Sektori i fondeve pensionale është i ekspozuar vetëm në kuadër të aseteve. Asetet e jashtme në raport me totalin e aseteve që janë nën menaxhimin e fondeve pensionale në dhjetor 2013, arritën në 71.2 përqind. Për dallim nga sektorët tjerë, sektori mikrofinanciar është i ekspozuar vetëm në kuadër të detyrimeve, dhe deri në fund të dhejtorit vitit 2013, niveli i ekspozimit ishte 55.6 përqind. Niveli i theksuar i ekspozimit është kryesisht rezultat i linjave kreditore të jashtme në të cilat këto institucione e bazojnë aktivitetin kreditues, meqenëse nuk kanë të drejtë ligjore të financohen përmes depozitave të klientëve.

Figura 23. Ekspozimi në kuadër të aseteve dhe detyrimeve, dhjetor 2013



Burimi: BQK (2014)

⁴ Pjesën më të madhe të aseteve të BQK-së të investuara jashtë vendit e përbëjnë investimet në depozita dhe letra me vlerë. Kurse pjesa më e madhe e detyrimeve të BQK-së ndaj sektorit të jashtëm përbëhet nga huazimet e Qeverisë së Kosovës nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

6. Sektori Bankar i Kosovës

Struktura e sektorit bankar vazhdon të dominohet nga bankat me pronësi të huaj, ku nga gjithsej nëntë banka që operojnë në treg shtatë janë me pronësi të huaj dhe menaxhojnë 89.9 përqind të gjithsej aseteve të sektorit. Gjermania dhe Austria vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të kapitalit bankar (58.3 përqind së bashku). Sllovenia vazhdon të përfaqësohet me një bankë, e cila mbetet banka e tretë në treg me pjesëmarrje prej 16.5 përqind. Nga Turqia, operojnë dy banka, të cilat gjatë dy viteve të fundit zgjeruan pjesëmarrjen në 12.2 përqind. Dy bankat vendore, gjatë vitit 2013, poashtu zgjeruan lehtësisht përfaqësimin duke ndalur kështu trendin e tkurrjes të ndjekur gjatë dy viteve paraprake. Shqipëria dhe Serbia vijojnë të përfaqësohen me një bankë, të cilat kanë përfaqësimin më të ulët në treg, me gjithë se u zgjeruan në krahasim me vitin paraprak (Figura 24).

Shkalla e koncentrimit të sektorit bankar vazhdoi të shënojë trend rënës edhe gjatë vitit 2013. Në dhjetor 2013, pjesëmarrja e aseteve të tri bankave më të mëdha në vend ka zbritur në 67.4 përqind krahasuar me 69.3 përqind në 2012. Rënia shprehet edhe përmes Indeksit Herfindahl-Hirschman (IHH), trendi i të cilit tregon për një rënie të vazhdueshme të koncentrimit të aseteve, kredive dhe depozitave (Figura 25). Rënia e shkallës së koncentrimit, ndër tjerash, reflekton rritjen më të shpejtë e aseteve të bankave të vogla krahasuar me bankat më të mëdha.

6.1. Aktiviteti i Sektorit Bankar

6.1.1. Asetet

Vlera e aseteve të sektorit bankar të Kosovës deri në dhjetor 2013 arriti në 3.06 miliardë euro që paraqet rritje vjetore prej 8.1 përqind (Figura 26). Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar kryesisht u financua nga rritja e e depozitave të mbledhura brenda vendit. Megjithatë, në kuadër të gjithsej aseteve, rritjen më të theksuar e shënuan investimet në letra me vlerë, bilanci me bankat komerciale dhe bilanci me BQK-në,

Figura 24. Struktura e kapitalit të bankave komerciale




Figura 25. HHI për asete, kredi dhe depozita





Figura 26. Rritja vjetore e aseteve të sektorit bankar sipas vendeve, në përqindje



përderisa kreditë vazhduan të rriten me ritëm më të ngadalshëm, duke bërë që edhe financimi bankar i aktivitetit ekonomik në vend të jetë më i kufizuar.

Në krahasim me vendet e rajonit, sektori bankar i Kosovës gjatë vitit 2013 është karakterizuar me rritjen më të madhe vjetore të aseteve. Sektorët bankar të Sllovenisë dhe Malit të Zi u karakterizuan me rënien më të theksuar të aseteve gjatë vitit 2013. Ndërsa, në Serbi, sektori bankar shënoi rënie të lehtë të aktivitetit për dallim nga viti paraprak kur asetet e sektorit bankar të këtij vendi shënuan normën më të lartë të rritjes në rajon.

Tabela 4. Struktura e aseteve të sektorit bankar


Përshkrimi	Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	12.5%	331.5	12.5%	425.7	15.0%	463.3	15.1%
Bilanci me bankat komerciale	439.1	17.9%	329.5	12.4%	287.9	10.2%	339.9	11.1%
Letrat me vlerë	173.4	7.1%	202.0	7.6%	256.6	9.1%	354.5	11.6%
Kreditë bruto	1,458.7	59.4%	1,698.1	64.1%	1,763.4	62.3%	1,805.8	59.0%
Asetet Fikse	44.0	1.8%	47.4	1.8%	57.7	2.0%	55.5	1.8%
Asetet Tjera	32.9	1.3%	41.3	1.6%	38.1	1.4%	40.3	1.4%
Gjithsej	2,455.1	100%	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%

Burimi: BQK (2014)

Në kuadër të strukturës së gjithsej aseteve të sektorit bankar të Kosovës, kategoria e bilancit me bankat komerciale, që kryesisht paraqet depozitat e mbajtura në bankat jashtë vendit, arriti vlerën 339.9 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 18.1 përqind (Figura 27). Kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK-në shënoi rritje vjetore prej 8.8 përqind në dhjetor 2013, duke arritur vlerën prej 463.3. milion euro. Në kuadër të kësaj kategorie, rritje më të theksuar (10.5 përqind) shënoi kategoria e rezervave të bankave në BQK, gjë cila reflekton vazhdimin e ngadalësimit të aktivitetit kredidhënës të sektorit bankar.


Ngadalësimi i aktivitetit kredidhënës në Kosovë krijoi kushtet për një zgjerim më të theksuar të investimeve të bankave në letra me vlerë. Vlera e gjithsej investimeve në letra me vlerë, në dhjetor 2013, arriti në 354.5 milion euro që paraqet rritje vjetore prej 38.2 përqind (Tabela 4). Rrjedhimisht, pjesëmarrja e letrave me vlerë në gjithsej asetet e sektorit bankar arriti në 11.6 përqind nga 9.1 përqind sa ishte në vitin paraprak. Në kuadër të gjithsej investimeve në letra me vlerë, investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës arritën në 100.1 milion euro (rritje vjetore prej 67.4 përqind). Rrjedhimisht,

Figura 27. Struktura e aseteve të sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 28. Struktura e letrave me vlerë, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës në vitin 2013 përfaqësuan 28.2 përqind të gjithë investimeve të bankave në letra me vlerë krahasuar me 23.3 përqind në vitin 2012 (Figura 28).

Rritja e investimeve në këtë instrument ishte nxitur edhe nga norma e kthimit e cila ishte më e lartë se sa ajo në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, portfolio e letrave me vlerë vazhdon të dominohet nga investimet në letra me vlerë në tregjet e jashtme, vlera e të cilave arriti në 254.4 milion euro (rritje vjetore prej 29.3 përqind). Pjesa më e madhe e investimeve në tregjet e jashtme përbëhet nga fletë-obligacionet e qeverive të huaja. Investimet në letrat me vlerë të korporatave tjera financiare dhe jo-financiare, të cilat zakonisht konsiderohen si instrumente me shkallë më të lartë të rrezikut, vazhdojnë të kenë nivel të ulët, gjë që tregon se bankat kanë i janë shmangur investimeve me nivel më të lartë të rrezikut.


Kreditë

Aktiviteti kreditues vazhdon të dominojë strukturën e gjithë asetëve të sektorit bankar me pjesëmarrje prej 59 përqind, por e cila është më e ulët krahasuar me pjesëmarrjen prej 62.3 përqind që e kishin në dhjetor 2012 (Tabela 4). Zvogëlimi i pjesëmarrjes ishte kryesisht rezultat i rritjes më të ngadalshme të aktivitetit kreditues në krahasim me rritjen e përsheptuar të kategorive tjera të asetëve të sektorit bankar.

Ngadalësimi i zgjerimit të kredidhënies ka filluar në vitin 2011 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Në dhjetor 2013, vlera e gjithë kredive arriti në 1.81 miliard euro, që paraqet rritje vjetore prej 2.4 përqind (Figura 29). Kontributin më të theksuar në ngadalësimin e gjithë kreditimit e kanë pasur kreditë për ndërmarrjet (Figura 30), duke marrë parasysh që vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithë kredive me një pjesëmarrje prej 67.3 përqind. Një zhvillim i tillë konfirmohet edhe përmes rezultateve të anketës së kreditimit bankar (Kutia 2), rezultatet e së cilës sugjerojnë për ngadalësim të rritjes së kreditimit kryesisht si pasojë e kombinimit të faktorëve nga ana e ofertës dhe kërkesës për kredi për ndërmarrje. Standardet e kreditimit për ndërmarrjet rezultojnë të kenë shfaqur tendencë shtrëngimi, kryesisht si rezultat i perceptimeve për zhvillimet e përgjithshme ekonomike më pak të favorshme. Për sa i përket kërkesës, bankat kanë raportuar për një rënie të lehtë të kërkesës për kredi, sidomos nga ndërmarrjet e mëdha. Në vitin 2013, kreditë për ndërmarrjet shënuan rritje vjetore prej 2 përqind (3.9 përqind në dhjetor 2012). Ngadalësimi i kreditimit të ndërmarrjeve është kryesisht rezultat i ngadalësimit të kreditimit për korporatat jo


financiare, kreditë për të cilat shënuan shënuan rritje vjetore prej 2.1 përqind në dhjetor 2013 krahasuar me 3.9 përqind në dhjetor 2012. Kreditimi bankar u ngadalësua edhe për korporatat

Figura 29. Rritja vjetore e asetëve të sektorit bankar, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 30. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve, në pikë përqindje



Burimi: BQK (2014)

tjera financiare duke shënuar rritje vjetore prej 3 përqind në vitin 2013, e cila është dukshëm më e ulët se norma e rritjes prej 14.4 përqind në vitin 2012. Ndërsa, kreditë për ekonomitë familjare, të cilat përbëjnë 31.2 përqind të gjithsej kredive, shënuan rritje vjetore prej 3.9 përqind, e cila poashtu është më e ulët se sa rritja prej 6.2 përqind që ishte shënuar në vitin 2012.

Pjesa e mbetur e kredive përfaqësohet nga kreditë ndaj jo rezidentëve, organizatave jo-qeveritare dhe kreditë në valutën jo euro, të cilat kanë pjesëmarrje mjaft të ulët në gjithsej kreditë. Kreditë ndaj jo rezidentëve, deri në dhjetor 2013, arritën vlerën 19.9 milion euro, duke shënuar rënie vjetore prej 11.7 përqind. Ato kryesisht përbëhen nga kreditë për ndërmarrje, të cilat përfaqësojnë 97.6 përqind të kredive ndaj jo rezidentëve. Ndërsa, kreditë në valutën e huaj, deri në dhjetor 2013, arritën vlerën prej 6.1 milion euro, duke shënuar rënie vjetore prej 11.6 përqind. Nga gjithsej kreditë në valutën jo-euro, 2.2 milion ishin të destinuara për ndërmarrje, ndërsa 3.8 milion për ekonomi familjare.

Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar

Rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2013, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të këtij viti, si dhe pritjet mbi zhvillimet në gjashtëmujorin e parë të vitit 2014. Pyetësi mbulon ndryshimet në standardet kreditore si dhe rregullat dhe kushtet për kreditë (gjegjësisht ofertën e bankave) si dhe kërkesën për kredi⁵, të ndarë sipas qëllimit të përdorimit në kreditë për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare.


Standardet dhe kushtet kreditore

Bazuar në rezultatet e anketës, trendi i ngadalësuar i rritjes së kreditimit që karakterizoi gjysmën e dytë të vitit 2013 mund t'i atribuohet ofertës më të shtrënguar kredituese të bankave për ndërmarrjet, por edhe kërkesës më të ulët për kredi nga ndërmarrjet. Rezultatet tregojnë se, në përgjithësi gjatë vitit 2013, bankat kanë shtrënguar lehtësisht standardet kreditore për ndërmarrjet, me theks të veçantë për ndërmarrjet e mëdha. Gjithashtu, sipas bankave, gjatë vitit 2013 kërkesa për kredi nga ndërmarrjet, sidomos nga ndërmarrjet e mëdha, ka qenë më e ulët në krahasim me vitin paraprak. Andaj, pesha e lartë e

ndërmarrjeve në gjithsej portfolion kreditor të sektorit bankar (67.3 përqind të gjithsej kredive në dhjetor 2013) ka ndikuar në masë të madhe përcaktimin e trendit të rritjes së kreditimit në vitin 2013.

Rezultatet në përgjithësi sugjerojnë lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore të aplikuara për ndërmarrjet në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2013 krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2013. Lehtësimi kryesisht i atribuohet lehtësimit të standardeve të kredidhënies për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), për kreditë afatgjata dhe kreditë afatshkurtra. Megjithatë, anketa e fundit rikonfirmon qasjen më konservatore të bankave ndaj kreditimit të ndërmarrjeve të mëdha. Shtrëngimi i standardeve kreditore për ndërmarrjet e mëdha është qasje e ndjekur nga bankat që nga viti 2012 (Figura 31). Standardet për ekonomitë familjare u lehtësuan gjithashtu për të dy kategoritë, kreditë për blerje të shtëpive dhe kreditë konsumuese. Nëse analizojmë standardet e kredidhënies sipas qëllimit të përdorimit,

Figura 31. Standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK (2013)

⁵ A) Standardet Kreditore: Standardet kreditore paraqesin kriteret e brendshme të bankave, të cilat e reflektojnë politikën kreditore të bankës. Këto kriteret mund të jenë të shkruara ose të pashkruara dhe definojnë llojet e kredive të cilat konsiderohen nga bankat si të dëshirueshme ose jo të dëshirueshme për tu kredituar.

B) Rregullat dhe kushtet: Rregullat dhe kushtet i referohen obligimeve specifike për të cilat kanë arritur pajtim kredidhëniesi dhe kredimarrësi. Në këtë anketë, rregullat dhe kushtet kanë të bëjnë me normat e interesit, madhësinë e kredisë, ngarkesat tjera përveç normave të interesit, afati i maturimit të kredisë, kërkesat për kolateral, etj.

bankat vazhdojnë të deklarojnë standarde më të lehtësuara kredituese për kreditë konsumuese krahasuar me kreditë për blerje të shtëpive (Figura 32).

Politika më e lehtësuar e bankave për kreditimin e ndërmarrjeve në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2013 krahasuar me gjashtëmuorin e parë është realizuar përmes uljes së normave të interesit dhe zgjatjes së afatit të maturimit. Faktorët kryesorë që shpjegojnë politikën më të lehtësuara bankare të kreditimit për ndërmarrjet ishin pozita e kënaqshme e likuiditetit të bankave komerciale dhe konkurrenca në sistemin financiar si nga bankat tjera ashtu edhe nga institucionet mikrofinanciare. Ndërsa, politika shtrënguese për ndërmarrjet e mëdha është realizuar përmes rritjes së normave të interesit për kreditë me rrezikshmëri më të lartë, zvogëlimit të shumës së kredisë, kërkesës më të lartë për kolateral dhe afatit më të shkurtër të maturimit.


Sa i përket kredive për ekonomitë familjare, bankat aplikuan politikën më të lehtësuara të kreditimit kryesisht përmes zvogëlimit të normave të interesit, zbritjes së normave të interesit për kreditë me rrezikshmëri më të lartë dhe zvogëlimit të ngarkesave tjera përveç normës së interesit. Politikën kredituese për ekonomitë familjare u ndikuan pozitivisht nga konkurrenca në tregun kreditor në vend, zvogëlimi i rrezikut nga mosrealizimi i kolateralit si dhe faktor të tjerë sikurse performanca e mirë e portfolios së kredive për ekonomitë familjare.

Kërkesa për kredi

Rezultatet tregojnë se, në përgjithësi, kërkesa për kredi nga ndërmarrjet është zvogëluar si nga NVM-të ashtu edhe nga ndërmarrjet e mëdha (Figura 33). Kërkesë më të ulët bankat kanë raportuar edhe për kreditë afatgjata, përderisa vetëm kërkesa për kredi afatshkurtra raportohet të jetë rritur deri në një masë. Rënia e kërkesës për kreditë nga ndërmarrjet është vlerësuar nga bankat të jetë ndikuar negativisht nga financimi i investimeve fikse të ndërmarrjeve, financimi i kapitalit punues dhe konkurrencës sa i përket kredive nga bankat e tjera.


Sa i përket kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, vërehet një rritje e kërkesës për kredi për blerje të shtëpive, për kreditë konsumuese dhe kreditë tjera (Figura 34). Kërkesa më e lartë për kredi për blerje të shtëpive kryesisht i atribuohet rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve, rritjes së burimeve tjera të financimit, si dhe zhvillimeve sezonale. Ndërkaq, sa i përket kërkesës për kredi konsumuese dhe kredive tjera, në gjysmën e dytë të vitit 2013 ishin

Figura 32. Standardet kreditore të aplikuara në ekonomitë familjare




Burimi: BQK (2013)

Figura 33. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet



Burimi: BQK (2013)

Figura 34. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2013)

rritja e shpenzimeve për mallra me qëndrueshmëri më të gjatë, burimet tjera të financimit dhe rritja e besueshmërisë së konsumatorëve që ndikuan pozitivisht në kërkesën për këtë kategori të kredive.

Pritjet për gjashtëmuajorin e ardhshëm


Lidhur me pritjet për gjashtëmuajorin e ardhshëm, oferta e bankave në kontekst të standardeve të aplikuara për kreditim pritet të lehtësohet deri në një masë (për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare), me një theks të veçantë për kreditë për NVM-të dhe kreditë afatgjata. Standardet kreditore që do të aplikohen për ndërmarrjet e mëdha priten të mbesin të shtrënguara deri në një masë në këtë periudhë. Gjithashtu, pritet një rritje e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, veçanërisht nga NVM-të. Sa i përket ekonomive familjeve, bankat presin lehtësim të standardeve kreditore si për kredi për blerje të shtëpive, ashtu edhe për kredi konsumuese, ndërkohë që edhe kërkesa për kredi nga të dy këto kategori pritet të rritet.

Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas aktivitetit ekonomik mbetet e ngjashme me periudhat paraprake. Pjesa më e madhe e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë për sektorin e tregtisë, të cilat në dhjetor 2013 kishin një pjesëmarrje prej 52.6 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet. Kreditë për sektorin e industrisë (minierat, prodhimtarinë, energjetikën dhe ndërtimtarinë) kishin pjesëmarrje prej 23.9 përqind, ndërsa pjesëmarrjen më të ulët vazhdon ta ketë sektori i bujqësisë me pjesëmarrje prej 3.8 përqind në gjithsej kreditë për ndërmarrjet (Figura 35).

Kreditimi i pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë shënoi ngadalësim të rritjes gjatë vitit 2013 (Figura 36). Përjashtim ka bërë kreditimi i energjetikës dhe i minierave që shënoi rritje dukshëm të përshpejtuar prej 30.6 përqind përkatësisht 24.7 përqind në dhjetor 2013 (9.9 përqind përkatësisht -6.2 përqind në dhjetor 2012). Ndër sektorët të cilët u karakterizuan me rritje më të lartë të kreditimit në krahasim me rritjen e vitit paraprak ishte edhe sektori i shërbimeve tjera (hoteliere dhe restorante, patundshmëri dhe qera, etj.), kreditë për të cilin shënuan rritje prej 6.6 përqind (3.1 përqind në dhjetor 2012). Kreditimi i sektorit të bujqësisë gjithashtu shënoi rritje vjetore prej 5 përqind, mirëpo kjo ishte rritje më e ulët në krahasim me vitin paraprak (7.7 përqind në vitin 2012).


Kreditimi i prodhimtarisë dhe ndërtimtarisë vazhdoi të shënojë rënie edhe në vitin 2013 ngjashëm me vitin 2012. Në dhjetor 2013, vlera e kredive për sektorin e ndërtimtarisë ishte për 5.2 përqind më e ulët krahasuar me vitin paraprak, ndërsa kreditë për sektorin e prodhimtarisë shënuan rënie vjetore prej 1 përqind. Ngadalësimi i trendit të rritjes së kredive për ndërmarrjet vërehet edhe tek sektori i tregtisë, që përfaqëson numrin më të madh të bizneseve në Kosovë, dhe njëkohësisht dominon portfolion e kreditimit bankar. Kreditimi i tregtisë gjatë vitit 2013 shënoi rritje vjetore prej 0.8 përqind që është dukshëm më e ulët krahasuar me rritjen prej 4.8 përqind

Figura 35. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 36. Trendi i rritjes së kredive sipas sektorëve ekonomik, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

gjatë vitit 2012. Ngadalësimi i kreditimit për këtë sektor, mes tjerash, reflekton edhe zvogëlimin e aktivitetit tregtar të Kosovës me vendet tjera gjatë kësaj periudhe, që tregohet nga zvogëlimi i vlerës së importit (Figura 36).

Sa i përket strukturës së kredive sipas afatit të maturimit, vërehet që kreditë me afat më të gjatë maturimi vazhdojnë të dominojnë strukturën e gjithsej kredive. Kreditë me afat maturimi 'mbi 2 vite' në dhjetor 2013 përfaqësuan 67.2 përqind të gjithsej kredive (71.4 përqind në dhjetor 2012). Kreditë me afat maturimi 'deri 1 vit' përfaqësuan 25 përqind të gjithsej kredive (21.1 përqind në dhjetor 2012). Pjesa e mbetur e kredive u përfaqësua nga kreditë me afat maturimi 'nga 1 deri në 2 vite'.


Vrojtimi i trendit të strukturës së kredive sipas afatit të maturimit tregon se në vitin 2013 është ngushtuar pjesëmarrjes e kredive me afat maturimi 'mbi 2 vite', përderisa është zgjeruar pjesëmarrja e kredive me afat maturimi 'deri 1 vit' (Figura 37). Ky zhvillim vërehet edhe nga trendi i rritjes së kategorive të veçanta të kredive, shikuar sipas afatit të maturimit (Figura 38). Në dhjetor 2013, kreditë me maturitet 'deri në 1 vit' shënuan rritje vjetore prej 21.3 përqind, ato 'nga 1 deri në 2 vite' shënuan rritje vjetore prej 6.8 përqind, ndërsa ato 'mbi 2 vite' shënuan rënie vjetore prej 3.6 përqind. Zhvendosja e lehtë drejt kredive me afat më të shkurtër maturimi është shprehur si te kreditë për ndërmarrje ashtu edhe te kreditë për ekonomi familjare. Në kuadër të kredive për ndërmarrje, trendi rritës i kreditimit afatshkurtër është më i theksuar për sektorët e tregtisë, shërbimeve financiare (qera, patundshmëri etj.) si dhe shërbimeve tjera. Orientimi drejt kreditimit afatshkurtër, ndër tjerash, mund të jetë edhe rezultat i zvogëlimit më të përshpejtuar të normave të interesit për kreditë afatshkurtra, krahasuar me ato afatgjata gjatë kësaj periudhe (2010-2013). Faktorë tjetër që mund të kenë ndikuar këtë zhvillim janë edhe perceptimet e bankave rreth prospekteve të përgjithshme makroekonomike në vend, si dhe planet investive të ndërmarrjeve të cilat mund të kenë ndikuar kërkesën për kredi afatgjata.

Figura 37. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 38. Trendi i rritjes së kredive sipas maturitetit, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Kutia 3. Kreditë e reja


Deri në fund të vitit 2013, sektori bankar lëshoi kredi të reja në vlerën prej 761.9 milion euro, duke shënuar një rritje prej 2.4 përqind krahasuar me vitin paraprak (Figura 39).

Figura 39. Rritja vjetore e kredive të reja dhe gjithsej kredive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


Figura 40. Kategoritë kryesore të kredive të reja, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Sa i përket destinimit, edhe në vitin 2013 dominuan kreditë e lëshuara për ndërmarrjet të cilat përfaqësuan 61.4 përqind të gjithsej kredive të reja (62.9 përqind në 2012). Ndërsa, kreditë e destinuar për ekonomitë familjare përfaqësuan 38.6 përqind (36.2 përqind në 2012) të gjithsej kredive të reja (Figura 40).

Figura 41. Rritja vjetore e kredive të reja, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 42. Kategoritë kryesore të kredive të reja, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Kreditë e reja të destinuar për ndërmarrje shënuan rënie vjetore prej 0.1 përqind, ndërsa ato për ekonomitë familjare shënuan rritje vjetore prej 6.6 përqind. Rrjedhimisht, rritja e gjithsej kredive të reja të lëshuara nga sektori bankar është mbështetur kryesisht në rritjen e kreditimit ndaj ekonomive familjare (Figura 41).


Në strukturën e kredive të reja ndaj ndërmarrjeve, kreditë investuese vazhdojnë të dominojnë me pjesëmarrje prej 35.5 përqind (33.1 përqind në fund të vitit 2012). Ato pasohen nga kreditë jo-investuese dhe ato me kushte favorizuese të cilat gjatë vitit 2013 kanë zvogëluar pjesëmarrjen në 20.2 përqind përkatësisht 5.7 përqind (22.1 përqind dhe 7.7 përqind në vitin 2012) (Figura 42).

Në kuadër të kredive për ekonomitë familjare dominojnë kreditë konsumuese me pjesëmarrje prej 24.8 përqind, të cilat u karakterizuan me një rritje të lehtë të pjesëmarrjes nga viti paraprak (23.8 përqind në vitin 2012). Ngjashëm me kreditë konsumuese, rritje shënuan edhe kreditë hipotekare për ekonomitë familjare, të cilat rritën pjesëmarrjen në 5.4 përqind të gjithsej kredive të ekonomive familjare nga 4.8 përqind në vitin 2012. Ndërsa, kreditë me kushte favorizuese ishin e vetmja kategori që ngushtuan pjesëmarrjen në strukturën e kredive të ekonomive familjare në 6.0 nga 6.7 përqind sa ishin në vitin paraprak (Figura 42).

Që të identifikohet efekti i kredive të reja, atyre të paguara si dhe kredive të pakthyera (humbura) në rritjen e gjithsej kredive aktive, në figurën 43 janë analizuar trendet e zhvillimit të këtyre tri kategorive. Këto tri kategori kanë ndikim në ndryshimin e vlerës së gjithsej kredive aktive, ku kreditë e reja ndikojnë


në rritjen e kësaj vlere, ndërsa kthimi i kredive si dhe kreditë e humbura kanë efekt zvogëlues në vlerën e gjithsej kredive aktive. Andaj diferenca në mes të vlerës së kredive të reja gjatë një periudhe si dhe vlerës së kredive të paguara dhe atyre të humbura paraqet neto efektin në gjithsej kreditë aktive.

Figura 43. Kreditë e reja, kreditë e paguara dhe kreditë e pakthyer, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

Figura 44. Kreditë e reja dhe gjithsej kreditë aktive të ndërmarrjeve, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Në figurën 39 vërehet trend i lehtë rritës i kredive të reja, ku në vitin 2013 norma vjetore e rritjes ishte 2.4 përqind. Kreditë e paguara paraqesin trend më të theksuar të rritjes, që kryesisht sugjeron që më shumë kredi aktive arrijnë fazën e maturimit, e që është efekt i pritshëm i rritjes së kreditimit më të theksuar në vitet paraprake. Në vitin 2013, norma e rritjes së kredive të paguara ishte 5.3 përqind. Tek kreditë e pakthyer gjithashtu mund të vërehet trend rritës, ku në vitin 2013 rritja vjetore e kredive të pakthyer arriti në 28.7 përqind. Andaj, rritja më e theksuar e kredive të paguara si dhe kredive të pakthyer në raport me kreditë e reja ka ndikuar në ngadalësimin e normës së rritjes së gjithsej kredive aktive. Në vitin 2013, raporti i shumës së kredive të paguara si dhe atyre të pakthyer ndaj kredive të reja ishte 94.4 përqind, krahasuar me 91.2 përqind në vitin 2012. Të dhënat gjithashtu sugjerojnë se efekti i kredive të pakthyer (humbura) në 'mënjanimin' e rritjes së gjithsej kredive nga rritja e kredive të reja është në rritje, ku kreditë e pakthyer përbënin 3.4 përqind të kredive të reja në vitin 2013 në krahasim me 2.7 përqind në vitin 2012.

Në një situatë të tillë ku raporti i kredive të kthyer dhe atyre të humbura ndaj kredive të reja ka shfaqur tendencë rritëse, rritja më e lartë e kredive të reja është e nevojshme për të mbajtur normën e rritjes së gjithsej kredive aktive në nivelin ekzistues, apo edhe për të ngritur atë në nivel më të lartë marrë parasysh që në vitin 2013 ka shënuar nivelin më ultë historik.

Figura 45. Kreditë e reja dhe gjithsej kreditë aktive të ekonomive familjare, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

'Mënjanimi' i rritjes së gjithsej kredive aktive nga rritja e kredive të reja, si rezultat i efektit të kredive të kthyer dhe atyre të humbura, ka pasur tendencë rritëse për të dy sektorët e ekonomisë: atë të ndërmarrjeve si dhe atë ekonomive familjare (Figura 44 dhe figura 45). Sidoqoftë, ky efekt është më i theksuar në sektorin e ndërmarrjeve, duke rezultuar kështu në normë më të ulët të rritjes vjetore të gjithsej kredive aktive të ndërmarrjeve në krahasim me atë të ekonomive familjare.

6.1.2. Detyrimet

Struktura e detyrimeve në sektorin bankar të Kosovës vazhdoi të dominohet nga depozitat, që paraqesin burimin kryesor të financimit për bankat komerciale. Mbështetja e lartë në depozitat vendore si burim financimi ka bërë që bankat të përfitojnë nga një burim më i qëndrueshëm i financimit dhe të evitojnë ekspozimin ndaj ekonomisë së jashtme në kohë të vështirësive

financiare që po kalojnë ekonomitë e vendeve të zhvilluara. Në dhjetor 2013, depozitat përfaqësonin 80.1 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar (Tabela 5).

Tabela 5. Struktura e detyrimeve të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010		Dhjetor 2011		Dhjetor 2012		Dhjetor 2013	
	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)	Milionë euro	Pjesëmarrja (%)
Bilanci nga bankat tjera	70.7	2.9%	40.0	1.5%	6.0	0.2%	16.5	0.5%
Depozitat	1,936.8	78.9%	2,104.0	79.4%	2,279.1	80.6%	2,449.0	80.1%
Huatë tjera	23.4	1.0%	30.4	1.1%	18.9	0.7%	13.4	0.4%
Detyrimet tjera	160.3	6.5%	191.5	7.2%	223.6	7.9%	246.2	8.0%
Borxhi i ndërvarur	33.5	1.4%	31.0	1.2%	31.0	1.1%	56.3	1.8%
Mjetet vetanake	230.4	9.4%	252.8	9.5%	270.7	9.6%	277.8	9.1%
Gjithsej detyrimet	2,455.1	100%	2,649.7	100%	2,829.3	100%	3,059.3	100%

Burimi: BQK(2014)

Burim tjetër i rëndësishëm i financimit për bankat komerciale në vend janë edhe mjetet vetanake, të cilat gjatë vitit 2013 shënuan rritje vjetore prej 2.6 përqind. Rritje më të theksuar gjatë kësaj periudhe shënoi bilanci nga bankat tjera dhe borxhi i ndërvarur (angl. subordinated debt) që u karakterizuan me rritje vjetore prej 174 dhe 79.1 përqind, respektivisht. Rritja e borxhit të ndërvarur gjatë kësaj periudhe kryesisht i ka shërbyer bankave për të plotësuar kërkesat e kapitalit rregullativ, të cilat shënuan rritje pas hyrjes në fuqi të rregullores së re të BQK-së për mjaftueshmërinë e kapitalit. Kategoria e vetme e detyrimeve që shënoi rënie gjatë kësaj periudhe ishte kategoria e huave tjera, e cila u zvogëlua për 30 përqind krahasuar me vitin paraprak.


Depozitat

Vlera e gjithsej depozitave në sektorin bankar të Kosovës, në vitin 2013, arriti në 2.45 miliard euro, që tregon për një rritje vjetore prej 7.5 përqind (Figura 46). Depozitat e ekonomive familjare, të cilat konsiderohen të jenë më stabile në raport me burimet tjera të financimit, vazhdojnë ta dominojnë strukturën e depozitave të sektorit bankar duke përfaqësuar 72.5 përqind të gjithsej depozitave. Deri në dhjetor 2013, depozitat e ekonomive familjare arritën shumën prej 1.77 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.2 përqind.

Depozitat e ndërmarrjeve përbëjnë 22.7 përqind të gjithsej depozitave, me një vlerë të përgjithshme prej 556.2 milionë euro (rritje vjetore prej 5.4 përqind).


Në kuadër të gjithsej depozitave të ndërmarrjeve, pjesa më e madhe përfaqësohet nga depozitat e korporatave jo-financiare (ndërmarrjet private), të cilat përbëjnë 71.5 përqind të gjithsej

Figura 46. Struktura e depozitave dhe rritja vjetore, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 47. Struktura e depozitave të ndërmarrjeve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)


depozitave të ndërmarrjeve (Figura 47). Krahasuar me vitin paraprak, vlera e depozitave të ndërmarrjeve private shënoi rritje vjetore prej 18.5 përqind. Ndërsa, vlera e depozitave të korporatave tjera financiare dhe të ndërmarrjeve publike shënoi rënie vjetore prej 25.9 përqind përkatësisht 4.7 përqind. Zvogëlimi i depozitave të korporatave tjera financiare në këtë periudhë mund të jetë kryesisht rezultat i tërheqjes së një pjese të depozitave të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës nga sektori bankar.

Në pjesën e mbetur të gjithsej depozitave përfshihen depozitat e jorezidentëve me pjesëmarrje prej 3.6 përqind në gjithsej depozitat dhe depozitat tjera (qeveria dhe organizatat tjera jo-qeveritare) me pjesëmarrje prej 1.2 përqind. Depozitat e jorezidentëve, gjatë vitit 2013, shënuan rritje vjetore prej 2.5 përqind, që paraqet një rritje dukshëm më të ngadalësuar krahasuar me rritjen e vitit paraprak (35.4 përqind). Ky ngadalësim i rritjes mund t'i atribuohet kryesisht rënies së normës së interesit në depozita. Kjo për faktin se trendi i depozitave të jo-rezidentëve gjatë viteve të kaluara është shfaqur të ketë pasur korrelacion mjaft të lartë me normën e interesit në depozita (Figura 48). Ndërsa, depozitat tjera u karakterizuan me rritje vjetore prej 19.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të Qeverisë në bankat komerciale.

Sipas afatit të maturimit, struktura e depozitave vazhdoi të dominohet nga depozitat e afatizuara (46.7 përqind të gjithsej depozitave), pasuar nga depozitat e transferueshme (36.8 përqind) dhe depozitat në formë të kursimeve (16.5 përqind). Krahasuar me vitin paraprak, depozitat e afatizuara kanë shënuar rënie të pjesëmarrjes në gjithsej depozitat, ndërsa depozitat e transferueshme dhe ato të kursimit janë karakterizuar me rritje (Figura 49).


Gjatë vitit 2013, depozitat e afatizuara shënuan rënie vjetore prej 2.4 përqind, gjë që pjesërisht mund të jetë pasojë e zvogëlimit të normës së interesit në depozita në pjesën e dytë të vitit 2013. Në kuadër të depozitave të afatizuara, vazhdojnë të dominojnë depozitat me afat më të shkurtër maturimi ku deri në dhjetor 2013, depozitat me afat maturimi 'deri në 1 vit' përfaqësuan 62.1 përqind të gjithsej depozitave të afatizuara. Në pjesën e mbetur

Figura 48. Depozitat e jo-rezidentëve dhe norma e interesit në depozita




Burimi: BQK (2014)

Figura 49. Struktura e depozitave sipas maturimit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 50. Struktura e depozitave të afatizuara, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

përfshihen depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ (19.1 përqind) dhe depozitat me afat maturimi ‘nga 1 deri në 2 vite’ (18.8 përqind) (Figura 50). Gjatë viteve të fundit, depozitat ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 2 vite’ vazhdimisht zgjeruan pjesëmarrjen e tyre në strukturën e gjithsej depozitave e afatizuara, ndërsa depozitat ‘nga 1 vit deri në 2 vite’ u karakterizuan me zvogëlim të pjesëmarrjes. Zhvillimet e mësipërme ndër tjerash mund të reflektojnë rrafshizimin e një pjese të depozitave ‘nga 1 deri në 2 vite’ në depozita me afat maturimi ‘deri në 1 vit’. Dominimi i strukturës së gjithsej depozitave të sektorit bankar nga depozitat me afat maturimi më të shkurtër mund të paraqes kufizim për aktivitetin e bankave, kur kemi parasysh që pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kredive e kanë kreditë me maturitet afatgjatë. Kjo strukturë e depozitave mund të jetë pengesë për zgjerimin e kreditimit afatgjatë nga ana e bankave, i cili do të mund të përdorej për financimin e projekteve investive afatgjata.


Depozitat e tansferueshme, gjatë vitit 2013, kanë shënuar rritje vjetore prej 19.8 përqind (7.6 përqind në dhjetor 2012). Në kuadër të tyre, derisa depozitat e ekonomive familjare kanë pasur rritjen më të lartë vjetore prej 24.4 përqind (12.8 përqind në dhjetor 2012), depozitat e jo-rezidentëve janë karakterizuar me rënie prej 1.2 përqind. Ndërsa, depozitat në formë të kursimeve shënuan rritje të theksuar prej 13.8 përqind. Në kuadër të tyre, depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 20 përqind (0.7 përqind në vitin 2012), përderisa ato të ndërmarrjeve shënuan rënie prej 43.9 përqind në vitin 2013.

6.1.2. Normat e Interesit

Normat e interesit në kredi dhe depozita, u karakterizuan me trende rënëse gjatë vitit 2013. Norma e interesit në kredi u zvogëlua në 11.1 përqind në dhjetor 2013 (12.9 përqind në dhjetor të vitit 2012), ndërkaq ajo në depozita u zvogëlua në 2.4 përqind (3.7 përqind në dhjetor 2012). Rënia më e theksuar e normës së interesit në kredi ndikoi që dallimi në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita në dhjetor 2013 të ngushtohet në 8.7 pp, krahasuar me 9.1 pp sa ishte në dhjetor 2012 (Figura 51).


Në kuadër të normave të interesit për kredi, trendi rënës vërehet si te kreditë për ndërmarrje ashtu dhe te kreditë për ekonomitë familjare. Norma mesatare e interesit për kreditë e ndërmarrjeve zbriti në 11.1 përqind në dhjetor 2013 nga 12.7 përqind sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë investuese u karakterizuan me norma më të ulëta të interesit, ku norma mesatare e interesit për muajin dhjetor 2013 ishte 10.9 përqind (12.5 përqind në dhjetor 2012), përderisa kreditë tjera të biznesit kishin normë mesatare të interesit prej 12.3 përqind (14.5 përqind në dhjetor 2012) (Figura 52). Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë për ekonomitë familjare shënoi rënie të lehtë në 11.4 në dhjetor 2013 nga

Figura 51. Mesatarja e normave të interesit, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 52. Normat mesatare të interesit për kreditë e ndërmarrjeve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

11.5 përqind sa ishin në dhjetor 2012. Sa i përket kredive për ndërmarrje, sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në dhjetor 2013 u regjistrua te kreditë tjera të biznesit me maturim ‘mbi 1 deri në 5 vite’ (12.9 përqind), ndërsa më e ulëta u vërejt te kreditë investuese me maturim ‘mbi 5 vite’ (9.5 përqind).


Në kuadër të kredive të ekonomive familjare, norma e interesit për kreditë konsumuese ishte 11.7 përqind në dhjetor 2013 (13.1 përqind në dhjetor 2012), ndërsa norma mesatare e kredive hipotekare qëndroi në 9.7 përqind (10.3 përqind në dhjetor 2012) (Figura 53). Tek kreditë hipotekare, kishte ulje të normës së kredive me maturitet ‘mbi 5 deri në 10 vite’ (10.4 përqind në dhjetor 2013 nga 10.8 përqind në dhjetor 2012) dhe ato me maturitet ‘mbi 10 vite’ (9.0 përqind në dhjetor 2013 nga 9.8 përqind në dhjetor 2012).

Sa i përket sektorëve ekonomik, sektori i bujqësisë vijon të karakterizohet me normën më të lartë të interesit në kredi, ku norma mesatare në dhjetor 2013 qëndroi në 15.5 përqind (19.3 përqind në dhjetor 2012). Norma mesatare e interesit në kredi për sektorin e industrisë në dhjetor 2013 ishte 10.9 përqind (13.2 përqind në dhjetor 2012), ndërsa për sektorin e shërbimeve ishte 11.0 përqind (11.6 në dhjetor 2012) (Figura 54). Në përgjithësi, norma më e lartë e interesit në dhjetor 2013 u has tek kreditë bujqësore me afat maturimi ‘deri në një vit’ (16.1 përqind), ndërsa norma më e ulët ishte tek kreditë për shërbime me afat maturimi ‘mbi pesë vite’ (9.7 përqind).

Normat mesatare të interesit në depozita gjithashtu shënuan rënie gjatë vitit 2013. Normat mesatare të interesit në depozitat e ndërmarrjeve u zvogëluan në 1.6 përqind në dhjetor 2013 (2.9 përqind në dhjetor 2012), ndërsa për depozitat e ekonomive familjare u zvogëluan në 2.2 përqind në dhjetor 2013 (3.0 përqind në dhjetor 2012).


Tek depozitat e ndërmarrjeve sipas maturitetit, me rënie u karakterizuan të gjitha kategoritë. Norma më e lartë e interesit (3.4 përqind), në dhjetor 2013, u has tek depozitat e ndërmarrjeve me afat maturimi ‘mbi 2 vite’ për shumat më të mëdha se 250 mijë euro. Ndërsa, norma më e ulët e interesit në depozita e ndërmarrjeve ishte (0.5 përqind) për

Figura 53. Normat mesatare të interesit në kreditë për ekonomitë familjare, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 54. Normat mesatare të interesit në kredi sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 55. Normat mesatare të interesit në depozita dhe vlera e aseteve likuide (kuptimi i gjerë)



Burimi: BQK (2014)

shumat nën 250 mijë euro me maturim ‘mbi 6 muaj deri në 1 vit’. Tek depozitat e ekonomive familjare sipas maturitetit, norma më e lartë e interesit në dhjetor 2013 (4.0 përqind) u regjistrua tek depozitat me afat maturimi ‘mbi 2 vite’, ndërsa më e ulëta (1.7 përqind) u has tek depozitat me afat maturimi ‘deri në 1 muaj’.

Vlen të theksohet se normat e interesit në depozitat e kursimeve si për ekonomitë familjare ashtu edhe për ndërmarrjet në dhjetor 2013 kanë shënuar rënie kundrejt rritjes së vazhdueshme të depozitave të kursimit. Norma e interesit në depozitat e kursimit të klientëve në bankat komerciale, në dhjetor 2013, ishte 1.7 përqind (2.1 përqind në dhjetor 2012) përderisa vlera depozitave të kursimit gjatë së njëjtës periudhë shënoi rritje vjetore prej 13.8 përqind.

Gjatë tri viteve të fundit niveli i likuiditetit në sektorin bankar është rritur vazhdimisht gjë që mund të ketë ndikuar në trendin rënës të normës mesatare të interesit në të gjitha kategoritë e depozitave (Figura 55).


6.2. Performanca e Sektorit Bankar

Performanca e sektorit bankar shënoi përmirësim gjatë vitit 2013, ku fitimi neto i sektorit shënoi rritje vjetore prej 40.7 përqind, duke arritur vlerën prej 26 milionë euro. Rritja e fitimit të sektorit bankar gjatë kësaj periudhë kryesisht reflekton masat e ndërmarrja nga bankat për të zvogëluar shpenzimet, përderisa të hyrat shënuan vetëm një rritje të lehtë. Më konkretisht, shpenzimet e sektorit bankar në vitin 2013 shënuan rënie vjetore prej 2.2 përqind, përderisa të hyrat shënuan rritje prej 0.3 përqind.

Struktura e të hyrave të sektorit bankar mbetet e ngjashme me vitet paraprake (Figura 56). Të hyrat nga interesi, që përfshijnë të hyrat nga interesi në kredi, letrat me vlerë, dhe plasmanet me bankat tjera, vazhdojnë të jenë kategoria dominuese e të hyrave me pjesëmarrje prej rreth 80 përqind (Figura 57). Pjesa e mbetur përbëhet nga të hyrat nga jo-interesi që, gjatë vitin 2013, shënuan rritje vjetore prej 6.4 përqind, dhe rrjedhimisht nxitën rritjen e gjithsej të hyrave.


Në dhjetor 2013, të hyrat nga interesi shënuan rënie vjetore prej 1.1 përqind. Kontributin kryesor në rënien e të hyrave nga interesi e patën të hyrat nga interesi në kredi, gjë e cila reflekton peshën e madhe që kanë kreditë në strukturën e përgjithshme të aseteve, por me rënie u karakterizuan edhe të hyrat nga investimet në letra me vlerë dhe plasmanët në bankat tjera. Në dhjetor 2013, të hyrat nga interesi në kredi shënuan rënie vjetore prej 1.2 përqind, e cila përkon me ngadalësimin e zgjerimit të aktivitetit kreditor gjatë vitit si dhe me zvogëlimin e normës së interesit në kredi.

Figura 56. Struktura e përgjithshme e të hyrave, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 57. Struktura e të hyrave sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Të hyrat nga interesi në letra me vlerë, gjatë vitit 2013, shënuan rënie vjetore prej 24.5 përqind përkundër rritjes prej 38.2 përqind të vlerës të investimeve në këtë kategori (Figura 58). Kthimi më i ulët nga investimet në letra me vlerë reflekton rënien e normave të kthimit si nga bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës ashtu edhe nga investimet në letra me vlerë në tregjet e jashtme. Norma e kthimit nga bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës shënoi rënie të theksuar, ku mesatarja e thjeshtë e normës vjetore të kthimit, në dhjetor 2013, zbriti në 1 përqind krahasuar me 2.5 përqind në vitin paraprak. Në zvogëlimin e normës së kthimit nga bonot e thesarit ndikim mund të ketë pasur edhe ndryshimi i strukturës së bonove të thesarit, ku është vërejtur rritje e pjesëmarrjes së bonove me afat më të gjatë maturimi e të cilat kanë normë më të ulët të kthimit. Të hyrat nga letrat me vlerë të qeverive të huaja, të cilat vazhdojnë të dominojnë portfolion e investimeve me pjesëmarrje prej 72 përqind, u zvogëluan kryesisht si rezultat i zvogëlimit të normës së kthimit në këto instrumente. Tregjet evropiane dhe globale, gjatë vitit 2013, u karakterizuan me norma të ulëta kthimi si pasojë e politikave lehtësuese monetare të Bankës Qendrore Evropiane dhe Rezervës Federale si dhe pritjeve më optimiste për zhvillimet në sektorin real.


Ndryshe nga të hyrat prej interesit, të hyrat nga jo-interesi në vitin 2013 shënuan rritje. Në kuadër të të hyrave nga jo-interesi, lëvizjen më të theksuar e shënuan të hyrat nga tarifatat dhe komisionet të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.3 përqind. Rritja e këtyre të hyrave mund të ketë rezultuar nga rritja e çmimeve për shërbime të caktuara bankare, si dhe zgjerimi i përdorimit të shërbimeve bankare. Strategjia e rritjes së të hyrave nga tarifatat dhe komisionet mund të reflektojë synimet e bankave për të kompenzuar deri në një masë rënien e të hyrave nga ngushtimi i marxhinës së interesit dhe norma më e ulët e kthimit nga investimet në letra me vlerë.

Figura 58. Normat vjetore të rritjes së të hyrave sipas kategorive, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 59. Struktura e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 60. Rritja e shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Shpenzimet e sektorit bankar shënuan rënie vjetore prej 2.15 përqind gjatë vitit 2013. Struktura e shpenzimeve vazhdon të dominohet nga shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, të pasuara nga shpenzimet e interesit dhe ato të jo-interesit (Figura 59). Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative në vitin 2013 shënuan rënie vjetore prej 1.9 përqind (Figura 60). Në kuadër të tyre, 'shpenzimet tjera nga jo interesit' u karakterizuan me rënie prej 8.2 përqind, 'shpenzimet e përgjithshme' shënuan rritje prej 0.3 përqind, kurse 'shpenzimet e personelit' mbetën në nivel të ngjashëm me vitin paraprak.


Kategoria e shpenzimeve të jo-interesit u karakterizua me rënie më të theksuar vjetore prej 6.1 përqind dhe, rrjedhimisht, ishte kategoria kryesore që shkaktoi rënien e gjithsej shpenzimeve. Zvogëlimi i këtyre shpenzimeve i atribuohet rënies vjetore prej 8.4 përqind të shpenzimeve për provizione, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve të jo-interesit (Figura 61). Shuma më e ulët e provizioneve të ndara gjatë kësaj periudhe reflekton faktin se shkalla e përkeqësimit të portfolios së kredive në vitin 2013 ishte më e ulët se sa në vitin 2012. Përkundër zvogëlimit të shpenzimeve për provizione, shkalla e mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione vazhdon të jetë e kënaqshme duke qëndruar në 110.5 përqind në dhjetor 2013.

Shpenzimet e interesit ishin e vetmja kategori e gjithsej shpenzimeve që shënoi rritje gjatë vitit 2013 (rritje vjetore prej 1.1 përqind), mirëpo norma e rritjes ishte dukshëm më e ulët në krahasim me vitin paraprak (7.9 përqind në vitin 2012). Ngadalësimi i rritjes së shpenzimeve të interesit i atribuohet kryesisht komponentit kryesor të kësaj kategorie, që përbëhet nga shpenzimet e interesit në depozita, të cilat kanë pjesëmarrje prej 91 përqind në gjithsej shpenzimet e interesit. Shpenzimet e interesit në depozita shënuan rritje vjetore prej 0.7 përqind, e cila është më e ulët në krahasim me rritjen prej 12.3 përqind në vitin paraprak. Zvogëlimi i shpenzimet për pagimin e interesit në depozita është kryesisht rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozita gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013.

Profitabiliteti dhe efikasiteti


Për dallim nga viti 2012 kur treguesit e profitabilitet kishin shënuar përkeqësim të theksuar, viti 2013 u karakterizua me përmirësim të këtyre treguesve. Në vitin 2013, Kthimi në Mesataren e Aseteve (angl. Return on Average Assets: ROAA) arriti në 0.9 përqind nga 0.7 përqind sa ishte në vitin 2012. Kthimi në Mesataren e Kapitalit (angl. Return on Average Equity: ROAE) gjithashtu shënoi përmirësim duke arritur në 9.4 përqind nga 7.1 përqind sa ishte në vitin 2012 (Figura 62). Zhvillimet pozitive ishin kryesisht reflektim i rritjes së përsheptuar të fitimit në krahasim me rritjen e gjithsej asetëve dhe kapitalit.

Figura 61. Normat vjetore të rritjes së shpenzimeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 62. Treguesit e profitabilitetit



Burimi: BQK (2014)

Sa i përket efikasitetit të sektorit bankar, indikatorët e mëposhtëm sugjerojnë për përmirësim të përgjithshëm krahasuar me vitin paraprak. Rënia e shpenzimeve krahas rritjes së të hyrave të sektorit ka ndikuar në përmirësimin e indikatorit të përgjithshëm të efikasitetit që shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave të përgjithshme (Figura 63). Në dhjetor 2013, ky indikator u zvogëluar për 2.2 pikë përqindje, duke zbritur në 88.7 përqind.


Tabela 6. Tregues kyq të efikasitetit të sektorit

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Gjithsej Shpenzimet/ Gjithsej të hyrat	82.4%	82.8%	90.9%	88.7%
Shpenzimet operacionale/ Gjithsej të hyrat	40.5%	40.5%	41.5%	40.6%
Shpenzimet operacionale/ Gjithsej Asetet	3.6%	3.7%	3.6%	3.3%
Margjina neto e interesit	6.3%	6.3%	6.0%	5.7%

Burimi: BQK (2014)

Raporti i shpenzimeve operacionale, që përfshijnë shpenzimet administrative dhe të përgjithshme, ndaj gjithsej të hyrave gjithashtu është zvogëluar për 0.9 pikë përqindje (Tabela 6). Megjithatë, margjina neto e interesit sugjeron për rënie të efikasitetit të gjenerimit të të hyrave neto të interesit nga asetet. Ky tregues, që paraqet shkallën e mbulimit të shpenzimeve të financimit nga të hyrat e interesit në raport me asetet që gjenerojnë interes, gjatë vitit 2013 ka shënuar rënie. Të hyrat neto nga interesi janë zvogëluar përkundër rritjes së aseteve që gjenerojnë interes, përderisa shpenzimet e interesit kanë shënuar rritje. Rrjedhimisht, në dhjetor 2013 margjina neto e interesit zbriti në 5.7 përqind nga 6.0 përqind sa ishte në dhjetor 2012.

Figura 63. Raporti shpenzime/të hyra, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 7. Tregues të kapacitetit të sektorit bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Asetet/nr i punëtorve (në mijëra euro)	680.09	710.76	759.14	861.96
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	9.1	9.65	4.95	7.32
Numri i kredive/nr i punëtorve	79	103	120	121
Shpenzime e personelit/nr i punëtorëve	10.5	10.9	11.4	11.9

Burimi: BQK (2014)

Në Tabelën 7 janë paraqitur disa tregues të kapacitetit të sektorit bankar, zhvillimi i të cilëve gjatë viteve të fundit sugjeron një përdorim më efikas të burimeve. Në rastin e 'aseteve për punëtor', trendi rritës i raportit është produkt i rënies së numrit të punësuarve dhe i rritjes së vlerës së aseteve, çka do të thotë se vlera mesatare e aseteve të menaxhuar nga një punëtor është rritur. Në dhjetor 2013, numri i të punësuarve në sektorin bankar zbriti në 3,549 punëtor nga 3,727 në dhjetor 2012, përderisa numri i kredive aktive për punëtor shënoi rritje. Raporti i profitit të gjeneruar për punëtor gjithashtu shënoi rritje si rezultat i rritjes së theksuar të profitit


dhe zvogëlimi të numrit të punëtorëve. Në anën tjetër, zvogëlimi i numrit të personelit shkaktoi rritje të raportit të shpenzimeve të personelit ndaj numrit të punëtorëve, duke sugjeruar se është rritur kostoja mesatare për një punëtor.

6.3. Rreziqet e Sektorit Bankar

Harta e rreziqeve të sektorit bankar

Sektori bankar i Kosovës, gjatë vitit 2013, në përgjithësi u karakterizua me rënie të lehtë të rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet veprimtaria e tij, si dhe me përmirësim të performancës në krahasim me vitin paraprak. Në figurën 64, e cila paraqet indikatorët kryesor të rreziqeve bankare dhe performancës së sektorit, mund të vërehet se ambienti makroekonomik i brendshëm dhe i jashtëm, i vlerësuar në bazë të normës së rritjes vjetore të PBB-së në Kosovë përkatësisht në eurozonë, ka shënuar përmirësim të lehtë.⁶ Përkundër kësaj, kërkesa dhe oferta e sektorit bankar për kreditimin e ekonomisë u ndikua nga zhvillimet më pak të favorshme të vitit

Figura 64. Harta e rreziqeve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2014)

paraprak, gjë që ndikoi në ngadalësimin e rritjes së kreditimit gjatë vitit 2013. Përderisa rritja më e ngadalshme e kreditimit ndikoi në ngushtimin e mundësisë së sektorit për rritje të hyrave të interesit, rënia e normave të interesit në kredi dhe në letra me vlerë ndikuan që sektori bankar të arkëtojë më pak të hyra neto nga interesi, përkundër që vlera e aseteve që gjenerojnë interes shënoi rritje. Rrjedhimisht, margjina neto e interesit të sektorit bankar, që është indikacion i aftësisë së gjenerimit të të hyrave neto nga interesi dhe efikasitetit të përdorimit të aseteve që gjenerojnë interes, shënoi rënie. Efikasiteti i përgjithshëm i sektorit, megjithatë, shënoi përmirësim, ku të hyrat e përgjithshme shënuan rritje, ndërsa shpenzimet e përgjithshme u zvogëluan, duke rezultuar në fitim dhe normë më të lartë të kthimit në ekuitet (ROAE).

Rritja e profitabilitetit mundësoi rritjen e kapitalit të sektorit, që rezultoi në rritje të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR). Pozita e përforcuar e kapitalit sugjeron rritje të mëtutjeshme të qëndrueshmërisë së sektorit dhe aftësi të kënaqshme të përbalimit të humbjeve potenciale nga rreziku i shtuar kreditor, i cili është pasqyruar me normë më të lartë të kredive joperformuese krahasuar me vitin 2012. Niveli i likuiditetit të sistemit bankar ka shënuar rritje dhe vazhdon të jetë mjaft më i lartë se kërkesat minimale rregullative. Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra është rritur, përderisa shkalla e rezervave të bankave komerciale të mbajtura në BQK vazhdon të mbetet mjaft më e lartë se ajo e kërkuar, që sugjeron për ekspozim të ulët ndaj rrezikut të mundshëm të likuiditetit.

6.3.1. Rreziku i likuiditetit

Pozita e likuiditetit të sektorit bankar, gjatë vitit 2013, vazhdoi të jetë e kënaqshme. Të gjithë indikatorët shënuan përforcim dhe tejkalim të kërkesave rregullative, duke u reflektuar në ulje të mëtutjeshme të ekspozimit të sektorit ndaj rrezikut të likuiditetit. Megjithëse me ritëm më të ngadalshëm, depozitat vazhduan rritjen dhe mbesin burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar. Ky model tradicional i sektorit bankar të Kosovës me burim kryesor të financimit depozitat vendore, që karakterizohen me kosto të ulët dhe qëndrueshmëri, bënë që sektori të ketë ekspozim të ulët ndaj lëvizjes së kostos së financimit dhe ndryshimeve në ofertën e fondeve me të cilat karakterizohen tregjet e jashtme të financimit afatshkurtër. Gjithashtu, pjesëmarrja e ulët e financimit me shumicë (angl. wholesale funding) dhe ekspozimi i ulët ndaj bankave amë bënë


⁶ Norma e rritjes vjetore të PBB-së së Kosovës për vitin 2013 është vlerësuar në BQK-së.

që sektori të jetë relativisht i mbrojtur nga rreziku i mundshëm i tkurrjes së huazimit nga bankat amë.

Raporti i kredive ndaj depozitave, në dhjetor 2013, zbriti në 73.7 përqind nga 77.4 përqind në dhjetor 2012 (Figura 65). Duhet theksuar që ka efekt sezonaliteti në zhvillimet në aktivitetin bankar sepse raporti kredi/depozita arrinë nivelin maksimal në mes të vitit dhe ka tendencë rënëse në pjesën e dytë të vitit. Sidoqoftë, norma më e lartë e rritjes së depozitave në krahasim me kreditë në dy vitet e fundit ka ndikuar që raporti kredi/depozita të zbresë në nivelin pothuajse më të ulët në pesë vitet e fundit. Kjo tregon për nivel të lartë të likuiditetit, që njëherit paraqet hapësirë për rritje të kreditimit pa e kërcënuar pozicionin e likuiditetit të sektorit bankar.


Pozita e favorshme e likuiditetit, që tregon aftësinë e sektorit bankar për shlyerjen e detyrimeve afatshkurtra dëshmohej edhe nga niveli i lartë i treguesve kyç të likuiditetit. Raporti i mjeteve likuide gjithëpërfshirëse ndaj detyrimeve afatshkurtra shënoi ngritje gjatë vitit 2013, duke arritur në 48.0 përqind nga 39.3 përqind në vitin paraprak (Figura 66).⁷ Të gjitha bankat përforcuan pozitën e tyre të likuiditetit, duke mbajtur raportin e mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra mbi nivelin 30 përqind. Rritja e raportit, në nivel të sektorit, i atribuohet rritjes më të madhe të mjeteve likuide krahasuar me detyrimet afatshkurtra. Mjetet likuide shënuan rritje vjetore prej 31.7 përqind, ndërsa detyrimet afatshkurtra u karakterizuan me rritje vjetore prej 7.9 përqind, në dhjetor 2013. Në kuadër të mjeteve likuide, kontributin më të madh në rritje e kishin letrat me vlerë të tregtueshme të qeverive dhe bankave qendrore, të pasuara nga llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet financiare, si dhe llogaria me BQK-në. Rritja e këtyre zërave të aseteve të bankave, ndër tjera, reflekton shtrëngimin e kreditimit ndaj ekonomisë. Sa i përket detyrimeve afatshkurtra, kontributin

Figura 65. Kreditë dhe depozitat e sistemit bankar, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Figura 66. Raporti mjete likuide 'gjithëpërfshirëse'/ detyrime afatshkurtra



Burimi: BQK (2014)

Figura 67. Rezervat e sistemit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

⁷ Me rregullore të BQK-së kërkohet që niveli minimal i raportit të mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra të jetë 25 përqind.

kryesor në rritje e kishin depozitat e transferueshme, të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 19.3 përqind, gjë që u reflektua edhe me rritje të pjesëmarrjes së tyre në strukturën e detyrimeve afatshkurtëra në 30 përqind nga 27 përqind në vitin paraprak.


Rezervat e detyrueshme të sektorit vazhdojnë të qëndrojnë në nivel mjaft më të lartë se kërkesat rregullative. Në vitin 2013, ato tejkaluan për 86 përqind (93 përqind në 2012) minimumin e rezervës së kërkuar. (Figura 67). Mbatja e rezervave në nivel të lartë mund të konsiderohet si pozitive ngase zvogëlon ekspozimin e sektorit ndaj zhvillimeve me rrezik potencial për likuiditetin e sektorit. Megjithatë, mbajtja e rezervave mbi nivelin e obliguar paraqet kosto oportune për bankat të cilat nuk arkëtojnë interes për këto mjete, gjë që mund të ndikojë në rritjen e kostos së shërbimeve bankare. Andaj, menaxhimi i mirë i mjeteve likuide është mjaft i rëndësishëm ngase mundëson minimizimin e kostos oportune dhe vendosjen e parasë në funksion të aktiviteteve me potencial zhvillimor ekonomik, mirëpo pa rrezikuar pozitën e likuiditetit të sektorit.

Rreziku strukturor i likuiditetit që ngërthen në vete aktiviteti i sektorit bankar, i cili bënë transformimin e maturitetit të mjeteve duke shfrytëzuar fondet me maturitet të shkurtër për përmbushjen e kërkesave afatgjata të klientëve, ka shënuar rënie të lehtë. Kjo vërehet në analizën e hendekut të likuiditetit, ku paraqitet mospërputhja në mes së afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve të intervalit të njëjtë të maturitetit (Figura 68).⁸ Megjithëse hendeku për kategoritë e ndara me maturitet të shkurtër (1-7 ditë, 8-30 ditë, 31-90 ditë) është zgjeruar, hendeku kumulativ i likuiditetit për periudhën e maturimit deri në 90 ditë ka shënuar rënie në -271.0 milionë euro nga -325.0 në dhjetor 2012. Për më tepër, hendeku kumulativ për periudhën deri në 1 vit është ngushtuar dukshëm në -291.6 milionë euro nga -414.8 në dhjetor 2012.

Në vitin 2013, ka pasur tendencë të lehtë të zhvendosjes së aseteve drejt kategorive me maturitet më të ulët. Kategoria e aseteve me maturitet ‘më shumë se 1 vit’ ka shënuar rënie për 42.9 milionë euro (kreditë dhe letrat me vlerë kryesisht) dhe ka zvogëluar pjesëmarrjen në gjithsej asetet në 31.7 përqind nga 35.8 përqind një vit më parë, ndërsa të gjitha kategoritë tjera me maturitet më të shkurtër shënuan rritje. Rritjen më të theksuar e shënuan asetet me maturitetit ‘1-7 ditë’ dhe ‘8-30 ditë’, të cilat u rritën për nga 88.07 milionë euro secila dhe rritën pjesëmarrjen në 29.9 përqind (29.0 përqind në dhjetor 2012) dhe 7.9 përqind (5.1 përqind në dhjetor 2012). Në anën e detyrimeve, sektori bankar në vitin 2013 ka rritur detyrimet me afat maturiteti ‘mbi 1 vit’ për 80.3 milionë euro (21.5 përqind pjesëmarrje në gjithsej detyrimet krahasuar me 20.1 përqind në dhjetor 2012). Rritjen më të theksuar, sidoqoftë e kanë shënuar detyrimet me maturitet ‘1-7’ ditë, të cilat u rritën për 157.9 milionë euro dhe ngritën pjesëmarrjen në gjithsej detyrimet në 45.1 përqind nga 42.7 përqind në vitin paraprak.

Rritja më e theksuar e detyrimeve me afat maturimi ‘1-7 ditë’, kryesisht si pasojë e rritjes së depozitave pa interes të pasuar nga ato me interes, ka ndikuar që hendeku i likuiditetit për këtë kategori të rritet në -431.8 milionë euro nga -362 në dhjetor 2012. Hendeku për intervalin ‘8-30

Figura 68. Hendeku i likuiditetit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


⁸ Hendeku negativ nënkupton që asetet për intervalin e caktuar të maturitetit tejkalojnë detyrimet dhe anasjelltas.

ditë' ka ndryshuar kahje duke kaluar në hendek pozitiv, ku asetet tejkalojnë detyrimet, dhe ka arritur vlerën 84.8 milionë euro në krahasim me -15.7 milionë euro në dhjetor 2012. Ky ndryshim është ndikuar në masë të madhe nga zhvendosja e depozitave me interes nga ky interval maturiteti në atë me maturitet '1-7 ditë'. Rritja e depozitave me interes si dhe borxhit të ndërruar, në njërin anë, si dhe rënia e vlerës së kredive dhe letrave me vlerë me maturitet më të gjatë, në anën tjetër, kanë ndikuar në ngushtimin e hendekut të likuiditetit për intervalin e maturimit në 'mbi 1 vit'. Në dhjetor 2013, hendeku për këtë kategori u ngushtua në 291.6 milionë euro nga 414.8 milionë në dhjetor 2012. Megjithatë ngushtimi i hendekut për këtë periudhë reflekton rënie të ekspozimit ndaj rrezikut strukturor të likuiditetit, është e rëndësishme të theksohet që përpjekjet për ngushtim të mëtejshëm të hendekut të mos rezultojnë me rënie të mëtejshme të kredive me afat më të gjatë maturimi, por që këto përpjekje të jenë më të orientuara drejt zgjatjes së maturitetit të depozitave të sektorit. Kjo njëherit do të ngushtonte hendekun negativ në intervalet me maturitet të shkurtër dhe do të mundësonte rritje të kreditimit me afat më të gjatë të maturimit, gjë që është e dëshirueshme për përmirësimin e kushteve të financimit të investimeve.

6.3.2. Rreziku kreditor


Rreziku kreditor është ndër rreziqet më të rëndësishme ndaj të cilit ekspozohet sektori bankar i Kosovës. Gjatë vitit 2013, ekspozimi ndaj këtij rreziku është rritur, ku raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive në dhjetor 2013 arriti në 8.7 përqind krahasuar me 7.5 përqind në vitin paraprak. Rritja e normës së kredive joperformuese, krahas reflektimit të dobësimit të aftësisë paguese të kredimarrësve që mund të ketë ndodhur si pasojë e aktivitetit më të ngadalshëm ekonomik në vitet pas krizës globale financiare, konsiderohet që kryesisht të jetë pasojë e shtrëngimit të aktivitetit kreditor ngase vlera e NPL-ve nuk është karakterizuar me ndonjë shkallë përshpejtuese të rritjes (Figura 69). Duhet të theksohet që rritja më e theksuar e normës së NPL-ve u shënuar në tremujorin e tretë, ndërsa tremujori i katërt u karakterizua me stabilizim të kësaj norme. Në nivel të bankave individuale, pesë prej tyre shënuan rritje të normës së NPL-ve, ndërsa të tjerat shënuan përmirësim të portfolios së kredive dhe rënie të normës së NPL-ve. Gjithësesi, duhet pasur parasysh faktin se gjatë gjysmës së parë të vitit 2014, norma e NPL-ve ka ndjekur trend rënës, gjë që flet për zvogëlim të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor gjatë kësaj periudhe.

Figura 69. Norma vjetore e rritjes së gjithsej kredive dhe NPL-ve



Burimi: BQK (2014)

Figura 70. NPL-të sipas sektorëve




Burimi: BQK (2014)

Gjatë vitit 2013, sektori më i ekspozuar ndaj rrezikut kreditor vazhdoi të jetë sektori i ndërmarrjeve, në kuadër të të cilit tregtia dhe prodhimitaria shënuan përqendrimin më të theksuar të portofolit kreditor duke dhënë kështu kontributin më të madh në rritjen e vlerës së gjithsej NPL-ve. Në dhjetor 2013, sektori i prodhimitarisë kishte cilësinë më të dobët të portofolit kreditor, ku nga gjithsej kreditë e lëshuara për këtë sektor 15.2 përqind ishin kredi joperformuese krahasuar me 11.2 përqind në vitin paraprak (Figura 70). Sektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e kredive për ndërmarrje, shënoi normë të NPL-ve prej 12.2 përqind krahasuar me 10.5 përqind një vit më parë. Përqendrimin më të konsiderueshëm të portofolit kreditor shënoi sektori i agrikulturës, norma e NPL-ve e të cilit u dyfishua duke arritur në 8 përqind nga 3.4 përqind në dhjetor 2012. Sektori i ekonomive familjare mbetet me ekspozimin të ulët ndaj rrezikut kreditor, norma e NPL-ve e të cilit shënoi rritje të lehtë në 2.6 përqind krahasuar me 2.3 përqind në dhjetor 2012.


Rritja e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor është shfaqur edhe përmes migrimit të kredive nga kategoritë me cilësi më të mirë ndaj atyre me cilësi më të dobët (Figura 71). Kreditë 'standard' zvogëluan pjesëmarrjen për 2.4pp, ndërsa në anën tjetër kreditë 'nënstandard' rritën pjesëmarrjen për 1.1pp. Kreditë e 'dyshimta' rritën pjesëmarrjen për 0.3pp, ndërsa kreditë me klasifikimin më të ulët siç janë kreditë e 'humbura' rritën pjesëmarrjen për 0.9pp. Rritja më e theksuar e kredive të 'humbura' në krahasim me ato të 'dyshimta' ka ndikuar gjithashtu që pjesëmarrja e kredive të humbura në kategorinë e kredive joperformuese të rritet (Figura 72).⁹

Figura 71. Struktura e kredive sipas klasifikimit




Burimi: BQK (2014)

Figura 72. Struktura e kredive joperformuese, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 73. NPL-të dhe provizionet



Burimi: BQK (2014)

⁹ Sipas rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut kreditor, klasifikimet kreditore të mësipërme grupohen në tri kategori të ekspozimit të rrezikut kreditor: Kreditë me vonesa, të cilat përfshijnë kategoritë vrojtuese, nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura; Kreditë e klasifikuara që përfshijnë kategoritë nën standarde, të dyshimta dhe të humbura, dhe Kreditë joperformuese që përfshijnë kreditë e dyshimta dhe të humbura.

Sidoqoftë, kreditë joperformuese mbesin mirë të mbuluara me provizione, gjë që e e zbutë ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut kreditor. Në dhjetor 2013, mbulueshmëria e NPL-ve me provizione ishte 110.6 përqind krahasuar me 112.6 përqind në vitin paraprak (Figura 73).


Duhet theksuar se vazhdimi i shtrëngimit të rritjes së kreditimit mund të ketë ndikim negativ në kapacitetin për zgjerim të ndërmarrjeve dhe aftësinë e tyre për ristrukturimin dhe shlyerjen e kredive ekzistuese, dhe rrjedhimisht mund të rezultojë në rritjen e normës së NPL-ve. Megjithatë, përmirësimi i ambientit të përgjithshëm ekonomik si dhe standardet më të shtrënguara të kreditimit që bankat kanë raportuar të kenë përdorur në dy vitet e fundit pritet të kenë efekt pozitiv në kualitetin e portofolit kreditor dhe rrjedhimisht mund të neutralizojnë efektin e lartpërmendur negativ nga ngadalësimi i kreditimit të ekonomisë.

Gjithashtu, përmirësimi i profitabilitetit të sektorit në vitin 2013 krahasuar me një vit më parë është indikacion për aftësinë e bankave që të vazhdojnë të ndajnë provizione për të mbajtur nivel të lartë të mbulueshmërisë së NPL-ve me provizione, sidomos kur kemi parasysh faktin që NPL-të zvogëluan trendin e tyre rritës në tremujorin e fundit të vitit 2013, dhe pritet janë që trendi rritës të zbutet edhe më tutje krahas prospekteve pozitive për zhvillimet ekonomike në vitin 2014.

Rritja e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor të sektorit bankar të Kosovës mund të vërehet edhe në trendin në rritje të koncentrimin të rrezikut kreditor, të matur përmes ekspozimeve të mëdha kreditore në raport me kapitalin e klasit të parë (Figura 74). Në dhjetor 2013, vlera e gjithsej ekspozimeve të mëdha¹⁰ të sektorit arriti në 129.7 përqind të vlerës së kapitalit të klasit të parë¹¹, për dallim prej 93.4 përqind sa ishte në vitin 2012. Kjo rritje u ndikua kryesisht nga rritja më e lartë e ekspozimeve të mëdha në krahasim me kapitalin e klasit të parë, ku vlera e ekspozimeve të mëdha arriti në 318.9 milionë euro nga 212 milionë euro në dhjetor 2012 (rritje vjetore prej 50.4 përqind), ndërsa kapitali bazë rregullativ – kapitali i klasit të parë – shënoi rritje vjetore prej vetëm 8.3 përqind, duke arritur në 246.7 milionë nga 227 milionë euro në dhjetor 2012.

Rritja e vlerës së ekspozimeve është ndikuar pjesërisht nga ndryshimet në rregulloren e BQK-së për Mjaftueshmërinë e Kapitalit, si rezultat i së cilës është ndryshuar mënyra e klasifikimit të kapitalit të klasit të parë duke u bërë më konzervative.¹² Rrjedhimisht, përlllogaritja më konzervative e kapitalit të klasit të parë në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012 ku për bazë për klasifikimin e ekspozimeve të mëdha është marrë niveli i kapitalit të klasit të parë para ndryshimeve rregullatore, ka ndikuar në zvogëlimin e pragut ku një ekspozim fillon të klasifikohet si ekspozim i madh dhe kjo ka ndikuar që në disa banka të shtohet numri i ekspozimeve të mëdha që ka kontribuar në rritjen e gjithsej shumës së vlerës së ekspozimeve.

Figura 74. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2014)


¹⁰ Ekspozim i madh konsiderohet shuma e të gjitha ekspozimeve direkte dhe indirekte ndaj një huamarrësi të vetëm apo grupi të huamarrësve të ndërlidhur vlera e të cilave kalon 10% të vlerës së kapitalit të klasit të parë të bankës përkatëse.

¹¹ Sipas rregullores për ekspozime të mëdha, shuma e të gjitha ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj personit apo grupeve të personave, kur secili nga ata e tejkalon dhjetë përqind (10%) të kapitalit të klasit të I të bankës, kufizohet në 300% të kapitalit të klasit të parë.

¹² Në dhjetor 2012, bankat kanë bërë klasifikimin e ekspozimeve të mëdha duke marrë për bazë nivelin e kapitalit të klasit të parë para aplikimit të ndryshimeve rregullatore, që në nivel të sistemit ishte 260.7 milionë euro.

Sidoqoftë, vërehet tendencë në rritje e ekspozimeve me vlerë më të lartë nga disa banka, që njëherit janë kontribuesi kryesor në rritjen e gjithsej vlerës së ekspozimeve të sektorit. Kjo mbështetet nga fakti që shuma e tri ekspozimeve më të mëdha të secilës bankë në dhjetor 2013 ishte 178.7 milionë euro krahasuar me 96.1 milionë euro në dhjetor 2012. Gjithashtu, në nivel të sektorit, numri total i ekspozimeve të mëdha është zvogëluar krahasuar me vitin paraprak. Nga 73 një vit më parë, numri i ekspozimeve të mëdha zbriti në 68 në dhjetor 2013, e që bënë që vlera mesatare e një ekspozimi të madh të jetë rritur nga 2.9 në 4.7 milionë euro. Rritja e vlerës së ekspozimeve është ndikuar në masë të madhe nga bankat më të mëdha, përderisa bankat më të vogla kanë ulur ekspozimin. Megjithatë, raporti i shumës së ekspozimeve të mëdha ndaj kapitalit të klasit të parë mbetet më i lartë tek bankat më të vogla përshkak të bazës më të ulët të kapitalit të klasit të parë, por që sidoqoftë është nën nivelin maksimal prej 300% të përcaktuar me rregullore.

Figura 75. Kapitalizimi i sistemit bankar




Burimi: BQK (2014)

6.3.3. Rreziku i solvencës

Treguesit e kapitalizimit

Sektori bankar është karakterizuar në vazhdimësi me nivel të lartë të kapitalizimit i cili ka kaluar kërkesat minimale rregullative.¹³ Gjatë vitit 2013, kapitalizimi i sektorit shënoi përforsim, ku Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR), që paraqet raportin e gjithsej kapitalit rregullativ ndaj mjeteve të peshuara ndaj rrezikut, arriti në 16.7 përqind krahasuar me 14.2 përqind një vit më parë (Figura 75). Raporti i kapitalit të klasit të parë ndaj mjeteve të peshuara ndaj rrezikut arriti në 12.8

Figura 76. Kapitali rregullativ dhe RWA-të



Burimi: BQK (2014)

përqind nga 11.6 përqind në dhjetor 2012. Ngritja e këtyre treguesve të kapitalizimit erdhi kryesisht si rezultat i rritjes vjetore të kapitalit rregullativ prej 15.9 përqind (-7.7 përqind rënie në dhjetor 2012¹⁴). Në anën tjetër, Mjetet e Peshuara ndaj Rrezikut (angl. Risk Weighted Assets: RWA) shënuan rënie të lehtë prej 1.6 përqind (14.1 përqind rritje në dhjetor 2012¹⁵) (Figura 76).

¹³ Sipas rregullores së BQK-së për Adekuatshmërinë e Kapitalit, bankat janë të obliguara të kenë një normë prej së paku 12 përqind të gjithsej kapitalit rregullativ në raport me RWA dhe normë prej së paku 8 përqind të kapitalit të klasit të parë në raport me RWA.

¹⁴ Rënia e kapitalit rregullativ në dhjetor 2012 ishte kryesisht rezultat i ndryshimeve rregullatorë në klasifikimin e kapitalit rregullativ.

¹⁵ Ndryshimet në kapitalin rregullativ dhe RWA në dhjetor 2012 ishin kryesisht pasojë e ndryshimeve në rregulloren e Adekuatshmërisë së Kapitalit të Bankave që u reflekton në ndryshimin e klasifikimit të kapitalit rregullativ duke zbritur kategori të caktuara, si dhe në ndryshime në strukturën e RWA-vë kryesisht duke shtuar pozicionin e 'Rrezikut operacional'. Norma e CAR prej 14.2 përqind përfshinë këto ndryshime, përkundër që rregullorja përkatëse e BQK-së e rishikuar në prill të vitit 2013 iu lejoi bankave afat deri më korrik të vitit 2013 për të përfshirë pozicionin e 'Rrezikut operacional' në kalkulimin e RWA-ve. Përfshirja është bërë për arsye të konsistencës me vlerat dhe normat e raportuara në Raportin Vjetor 2012, i cili është draftuar para rishikimit të rregullores.


Një indikator tjetër për vlerësimin e nivelit të kapitalizimit është raporti i levës, i cili paraqet nivelin e ekuitetit në raport me gjithsej mjetet pavarësisht rrezikut që ato bartin. Në dhjetor 2013, ky indikator zbriti në 9.7 përqind nga 10.0 përqind në vitin paraprak kryesisht si pasojë e rritjes më të shpejtë të mjeteve. Sidoqoftë, edhe ky indikator tejkalon kërkesën rregullative për raport minimal të levës prej 7 përqind.¹⁶

Kapitali rregullativ

Kapitali rregullativ i sektorit bankar, në dhjetor 2013, arriti vlerën 321.2 milionë euro, duke tejkaluar kërkesën minimale për kapital rregullativ për 90.9 milionë euro. Për më tepër, cilësia e kapitalit është e lartë, ku 76.5 përqind e tij përfshinë kapitalin e klasit të parë (Figura 77). Sidoqoftë, siç shihet edhe në figurë, kapitali i klasit të dytë ka shënuar rritje graduale të pjesëmarrjes, dhe shtimi i tij në vitin 2013 ka dhënë kontributin kryesor në rritjen vjetore të gjithsej kapitalit rregullativ.


Kapitali i klasit të parë, në dhjetor 2013, arriti vlerën 245.8 milionë euro, që paraqet rritje vjetore prej 8.3 përqind. Rritja kryesisht i atribuohet shtimit të kapitalit aksionar nga disa banka gjatë vitit 2013, si dhe hyrjes në treg të një banke të re në fund të vitit 2012.¹⁷ Përmirësimi i profitit të sektorit në vitin 2013 krahasuar me vitet paraprake reflektoi pozitivisht në nivelin e kapitalit të klasit të parë, ndërsa shpërndarja e dividendës pati efekt të kundërt përmes zvogëlimit të profitit të pashpërndarë. Konsolidimi konform ndyrshimeve rregullative të fuqizuara në dhjetor të vitit 2012, që u manifestua me zvogëlimin gradual të ekspozimeve të sektorit ndaj personave të ndërlidhur me bankën, gjithashtu ndikoi në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë.¹⁸ Struktura e kapitalit të klasit të parë mbetet e ngjashme me periudhat paraprake (Figura 78). Kapitali aksionar mbetet kategoria dominuese me pjesëmarrje prej rreth 90 përqind (88 përqind dhjetor 2012). Fitimi i pashpërndarë, së bashku me fitimin për vitin aktual dhe fondet rezervë, mbetet kategoria e dytë për nga madhësia me pjesëmarrje prej 23 përqind (28 përqind në dhjetor 2012).

Figura 77. Struktura e kapitalit rregullativ të sistemit bankar



Burimi: BQK (2014)

Figura 78. Struktura e kapitalit të klasit të parë, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


¹⁶ Rregullorja për Mjafueshmërinë e Kapitalit.

¹⁷ Përfshirja në statistika të sektorit të kësaj banke filloi nga muaji janar 2013.

¹⁸ Huazimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën zbriten në përllogaritjen e kapitalit të klasit të parë, andaj zvogëlimi i këtyre ekspozimeve ka ndikuar në rritjen e nivelit të kapitalit të klasit të parë.

Siç u cek më lartë, përkundër që profiti i vitit aktual ka shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak, shpërndarja e dividendës ka ndikuar në zvogëlimin e profitit të pashpërndarë duke ndikuar në zvogëlimin e pjesëmarrjes së kësaj kategorie. Pjesëmarrja e mjeteve jo materiale (angl. intangible assets) dhe vlerës së emrit të mirë (angl. goodwill) mbetet e ngjashme, në 1.9 përqind, ndërsa kategoritë e reja të përfshira në përlllogaritjen e kapitalit të klasit të parë - investimet në ekuitetin e bankave tjera apo institucione kreditore, pasuritë e tatimit të shtyrë si dhe huazimet e personave të ndërlidhur me bankën zbriten pjesëmarrjen në 11.2 përqind nga 14.1 përqind në dhjetor 2012 kur edhe filluan aplikimin.¹⁹

Figura 79. Struktura e kapitalit të klasit të dytë, në milionë euro




Burimi: BQK (2014)

Kapitali i klasit të dytë arriti vlerën 75.3 milionë euro në dhjetor 2013, duke shënuar rritje vjetore prej 50.3 përqind. Burim i rritjes së kapitalit të klasit të dytë ishte borxhi i ndërvarur, vlera e të cilit pothuajse u dyfishua në raport me vitet paraprake. Në dhjetor 2013, vlera e tij arriti në 56.3 milionë euro, dhe përfaqësoi 74.8 përqind të kapitalit plotësues (Figura 79). Ndërsa pjesa tjetër prej 19 milionë euro përbëhet nga provizionet e përgjithshme për kreditë.²⁰ Për dallim nga vitet e mëhershme ku bankat, megjithëse në përqindje shumë të vogël, shfrytëzonin instrumentet e borxhit detyrimisht të konvertueshëm në aksione për plotësim të kapitalit, në dy vitet e fundit këto instrumente nuk gjetën aplikim.

Mjetet e peshuara ndaj rrezikut

Vlera e mjeteve të peshuara ndaj rrezikut (RWA), në dhjetor 2013, zbriti në 1.92 miliardë euro, krahasuar një vit më parë, që paraqet rënie vjetore prej 1.6 përqind. Kontributin më të lartë në rënieën e RWA-ve e kishin mjetet e peshuara me rrezik 50%, të cilat përfshijnë kërkesat me maturim prej 'një viti apo më pak' ose kërkesat e pakushtëzuara të garantuara nga bankat si subjekt i aprovimit paraprak nga BQK-ja. Pjesëmarrja e kësaj kategorie zbriti në 0.4 përqind të gjithsej RWA-ve krahasuar me 2.6 përqind në dhjetor 2012 (Figura 80). Rënie të pjesëmarrjes shënuan edhe mjetet me peshë të rrezikut prej 150% të cilat përfshijnë kërkesat direkte me maturitet prej 'një viti apo më pak' dhe të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga BQK por që kanë klasifikim kreditor me rrezik të lartë mospagese (nën B- sipas vlerësimeve të Fitch). Nga 1.6 përqind në dhjetor 2012, kjo kategori zbriti pjesëmarrjen në 0.1 përqind të RWA-ve në dhjetor 2013.

Figura 80. Struktura e RWA-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2014)

¹⁹ Në kuadër të pozicioneve të reja të cilat zbriten nga përlllogaritja e kapitalit të klasit të parë, peshën më të madhe e kanë huazimet ndaj personave të ndërlidhur me bankën, vlera e të cilave paraqet 10.8 përqind të kapitalit të klasit të parë në dhjetor 2013.

²⁰ Vlera e provizioneve të ndara nga bankat për kreditë me klasifikim standard dhe vrojtuese llogaritet si pjesë e kapitalit të klasit të dytë, limituar deri në 1.25% të mjeteve të peshuara ndaj rrezikut.

Kategoritë tjera të RWA-ve shënuan rritje të vlerës dhe pjesëmarrjes, mirëpo struktura e përgjithshme e RWA-ve nuk pësoi ndryshim të theksuar. Vlen të veçohet që asetet me peshë rreziku 100%, të cilat përfshijnë kreditë si dhe zërat jashtëbilancorë, arritën vlerën 1.4 miliardë euro dhe rritën pjesëmarrjen e tyre në 72.4 përqind të gjithsej RWA-ve nga 70.4 përqind në vitin paraprak. Pozicioni i shtuar rishtazi i rrezikut operacional ka pjesëmarrje në gjithsej RWA-të prej 9.2 përqind. Ndërsa, nga gjithsej mjetet e sektorit, vlera e mjeteve të cilat nuk bartin rrezik, me peshë rreziku 0%, shënoi ngritje në 50.3 përqind të vlerës së RWA-ve në dhjetor 2013 nga 30.4 përqind në dhjetor 2012, që njëherit sugjeron për prirje për rrezik më të ulët nga bankat.


6.3.4. Rreziku i tregut

Ekspozimi i sektorit bankar ndaj rrezikut të tregut, që nënkupton rrezikun nga lëvizjet e kursit të këmbimit valutor si dhe ndryshimet në normat e interesit, ka shënuar rënie. Pozicionet e hapura neto në valuta të huaja ndaj kapitalit të klasit të parë janë ngushtuar dhe mbesin në nivel të ulët, që bënë sektorin të jetë pak i ndjeshëm ndaj ndryshimeve në kurset e këmbimit. Kreditë në valutë të huaj, të cilat edhe kështu kanë pjesëmarrje mjaft të ulët në gjithsej portofolin kreditor (0.34 përqind në dhjetor 2013), kanë shënuar rënie, dhe në këtë mënyrë nuk paraqesin rrezik indirekt kreditor, që mund të manifestohej prej ndryshimeve në kurse valutore në rast të kreditimit në valutë të huaj kur huamarrësi pranon të ardhurat në valutë tjetër nga ajo e kthimit të kredisë. Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit mbetet i ulët gjithashtu, për faktin që zërat kryesor të bilancit të gjendjes së sektorit, kreditë dhe depozitat, kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit në afat të shkurtër. Diferenca mes asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit në raport me gjithsej asetet e sektorit mbeti e ulët, gjë që sugjeron që ndryshimet në norma të interesit mund të kenë ndikim marginal në performancën e sektorit.

Rreziku nga normat e këmbimit valutor

Në dhjetor 2013, asetet në valutë të huaj arritën në 145.34 milionë euro (vlerë ekuivalente) nga 135.02 milionë në vitin 2012. Mirëpo, detyrimet në valutë të huaj u rritën gjithashtu në 145.37 milionë nga 133.11 milionë në dhjetor 2012, duke bërë që pozicioni i hapur neto në valutë të huaj të ngushtohet. Në dhjetor 2013, pozicioni i agreguar neto i hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë ishte -0.01 përqind krahasuar me 0.78 përqind në dhjetor 2012 (Figura 81). Në aspektin e disagreguar valutor, pozicionin më të lartë neto të hapur ndaj kapitalit të klasit të parë e kishte franga zvicerane prej 0.5%, por që mbetet në nivel mjaft më të ulët se maksimumi prej 15 përqind i lejuar nga BQK. Sa i përket bankave individuale, pozicionet neto të hapura të grumbulluara²¹ në të gjitha valutat ndaj kapitalit të klasit të parë qëndruan në nivel të përafërt mesatar prej 4.2 përqind (4.1 përqind në dhjetor 2012), që gjithashtu është në nivel mjaft më të

Figura 81. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj Kapitalit të Klasit të Parë



Burimi: BQK (2014)

²¹ Pozicioni neto i agreguar nënkupton shumën e pozicioneve të gjata dhe të shkurtra në të gjitha valutat. Më konkretisht, një pozicion neto i shkurtër (-) në dollar prej 1 milionë vlerë ekuivalente të euros dhe një pozicion neto i gjatë (+) në franga zvicerane prej një milionë vlerë ekuivalente të euros rezulton në neto pozicion të grumbulluar prej 2 milionë euro.

ulët se maksimumi prej 30 përqind i lejuar në rregullore të BQK-së. Bazuar në këto të dhëna, mund të sugjerohet që sektori bankar vazhdon të mbetet mjaft mirë i mbrojtur nga lëvizjet në kurset e këmbimit.


Për më tepër, sektori bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët ndaj rrezikut indirekt kreditor që mund të paraqitet si pasojë e kreditimit në valutë të huaj për ekonomi familjare dhe ndërmarrje që nuk janë të mbrojtura (angl: hedged) nga lëvizjet e kurseve të këmbimit. Kjo për arsye se pjesëmarrja e kredive të lëshuara në valutë të huaj ndaj gjithsej portofolit kreditor është në nivel të ulët, ku në dhjetor 2013 vetëm 0.34 përqind e portofolit kreditor ishin të shprehura në valutë të huaj (Figura 82).

Rreziku nga ndryshimet në normat e interesit

Sektorit bankar i Kosovës është i mbrojtur relativisht mirë ndaj ndryshimeve në normat e interesit, për faktin që kreditë dhe depozitat, si zërat kryesorë në bilancin e gjendjes së sektorit, kanë kryesisht normë fikse të interesit dhe të hyrat dhe shpenzimet e interesit nga këto zëra nuk ndikohen nga lëvizjet në norma të interesit deri në maturim. Në dhjetor 2013, 91 përqind e gjithsej kredive kishin normë fikse të interesit krahasuar me 93.7 përqind në dhjetor 2012. Ndërsa, të gjitha depozitat e sektorit bankar vazhdojnë të kenë normë fikse të interesit (Figura 83).


Megjithatë, ndryshimi i normave të interesit mund të ketë ndikim në kuptimin e rrezikut të refinancimit dhe riinvestimit të mjeteve varësisht nga kompozicioni i afatit të maturimit të aseteve dhe depozitave të ndjeshme ndaj normave të interesit (Figura 84), si dhe kahut të lëvizjes së normës së interesit. Dallimi mes aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj interesit është pothuajse më i larti për kategorinë e maturimit deri në 30 ditë, ku detyrimet e ndjeshme ndaj normës së interesit tejkaluan asetet për 384.8 milionë euro (307.4 milionë euro në dhjetor 2012). Marrë parasysh që kjo diferencë është negative (vëllimi i detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit është më i lartë se i aseteve), ndryshimet e mundshme në norma të interesit në afat të shkurtër reflektohen

Figura 82. Kreditë dhe detyrimet në valutë të huaj




Burimi: BQK (2014)

Figura 83. Kreditë dhe depozitat e ndjeshme ndaj normave të interesit, sipas llojit të normës së interesit



Burimi: BQK (2014)

Figura 84. Hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

më shumë në shpenzime krahasuar me të hyrat e sektorit. Pjesa dominuese e detyrimeve të ndjeshme ndaj nomës së interesit janë depozita, andaj sektori bankar është i ekspozuar ndaj rritjes së mundshme të normave të interesit në afat të shkurtër për shkak të rritjes më të shpejtë të shpenzimeve se sa të hyrave.

6.4. Analiza Stres-Test

Krahas analizimit të gjendjes aktuale të ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të solvencës, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut, analiza stres-test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve të mundshme si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide. Rezultatet e shtjelluara më poshtë kanë për bazë të dhënat e sektorit bankar për muajin dhjetor 2013. Gjatë kësaj analize është testuar qëndrueshmëria e sektorit bankar të Kosovës ndaj rrezikut kreditor, të kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe rrezikun nga norma e këmbimit (rreziku i tregut), si dhe është testuar aftësia e sektorit bankar që të ruaj gjendjen e likuiditetit nën supozime hipotetike mbi tërheqje të konsiderueshme të depozitave. Rezultatet e analizës stress-test sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit për të përballuar 'situatat ekstreme' të ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve.

6.4.1. Rreziku kreditor

Metodologjia

Skenari bazë: Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se gjendja ekonomike në eurozonë dhe në rajon do të përkeqësohet, dhe kjo do të reflektohet në ekonominë e Kosovës kryesisht përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend. Si rezultat, rritja ekonomike në vend supozohet të përkeqësohet duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor. Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.3 përqind në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.7 përqind për vitin 2013, gjë që do bënë që hendeku i prodhimit të jetë 6.0 përqind. Ndikimi në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL), është vlerësuar duke konsideruar një koeficient të elasticitetit të NPL ndaj hendekut të prodhimit prej 0.8, ku pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të rritej për 4.8pp. Rreziku kreditor është kombinuar me rrezikun nga norma e interesit dhe nga norma e këmbimit, duke supozuar rënie të normave të interesit për 2.0pp si dhe zhvlerësim të valutës euro ndaj valutave të tjera për 20 përqind.

Efektet e supozimeve të mësipërme në sektorin bankar reflektohen si në vijim: rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë ndikon në rritjen e provizioneve; zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes/fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet/fitimet e të hyrave neto nga interesi duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave.

Krahas këtyre supozimeve, është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti gjithashtu do të ndikohet nga tronditjet e lartpërmendura, kryesisht përmes rënies së aftësisë së gjenerimit të hyrave nga interesi si rezultat i dështimit të kredive (rritjes së NPL-ve). Andaj profiti i pritshëm i bankave është llogaritur duke marrë për bazë profitin neto pas tatimit të vitit 2013, prej të cilit janë zbritur të hyrat që do të realizoheshin po qe se NPL nuk do të rritej.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejtë kategorive joperformuese (të

dyschimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyschimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtë-bilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj pothuajse nuk ekziston, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor.

Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp (si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes). Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në marginën neto të interesit (angl. Net Interest Margin: NIM), kryesisht duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave ngase pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës kanë normë fikse të interesit dhe ndryshimet në norma të interesit nuk reflektohen deri në maturim. Sidoqoftë, ekspozimi ndaj rrezikut të rënies së normave të interesit është i ulët ngase hendeku i mjeteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit nuk është i lartë, si dhe efekti i mundshëm negativ nga rënia e normave të interesit për kategoritë me hendek pozitiv (siç janë kategoritë me maturitet më të gjatë se një muaj) neutralizohet, apo në shumë raste edhe tejkalohet, nga efekti pozitiv që rënia ka rënia e normës së interesit për kategorinë me hendek negativ siç është ajo me maturitet deri në një muaj ku detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit tejkalojnë mjetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit.

Skenarë shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i kredimarrësve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i NPL-ve për secilën bankë para se të shfaqen problemet me kapitalizim.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është vlerësuar në kuptim të ndikimit të skenarëve hipotetik në nivelin e kapitalit rregullativ të sektorit bankar, aseteve të peshuara me rrezik dhe, rrjedhimisht, treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit (angl. Capital Adequacy Ratio: CAR).

Rezultatet

Gjendja e sektorit bankar të Kosovës për sa i përket kapitalizimit të bankave në dhjetor 2013 ishte mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 16.7 përqind (Tabela 8). Sektori bankar vazhdoi të qëndroj mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive jo-performuese në raport me gjithsej kreditë, të cilat qëndruan në 8.7 përqind në dhjetor 2013, si dhe mbulueshmërisë së tyre me anë të provizioneve me 110.6 përqind. Andaj, falë kësaj gjendje së mirë si dhe performancës dhe profitabilitetit të mirë, sektori bankar i Kosovës ka treguar nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarëve hipotetikë të përshkruar më lartë.

Nën supozimet e skenarit bazë, ku pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion kreditor do të rritej për 4.8pp, euro do të zhvlerësohej ndaj valutave tjera për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëloheshin për 2.0pp, si dhe nën supozimin e profitit të pritur si absorbues i humbjeve, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) i sektorit bankar do të mbetet në normën prej 15.0 përqind, që është mbi minimumin prej 12 përqind të kërkuar nga Banka Qendrore.

Tabela 8. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku kreditor

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}			CAR %			NPL %			Rikapitalizimi	
	CAR <0	CAR 0-8%	CAR 8-12%	N. më i ulët	N. më i lartë	N. i sektorit	N. më i ulët	N. më i lartë	N. i sekt.	Në milion euro	Si përqindje e PBB-së
Nivelet para goditjeve	0	1	0	7.5	19.4	16.7	5.8	13.5	8.7		
Rezultatet e makroskenarëve											
<i>Skenari bazë</i>	0	1	3	1.8	20.6	15.0	4.9	18.3	13.5	21.4	0.42
<i>Dështimi i tre kredimarrësve</i>	2	0	3	-51.6	22.8	11.5	3.6	64.8	18.7	125.3	2.66
<i>Dështimi i pesë kredimarrësve</i>	2	2	3	-67.6	22.8	9.2	5.8	73.0	21.4	180.6	3.51

Shënim: 1/ Nga nëntë bankat e konsideruara në analizën stress-test, numri i bankave të cilat bien nën nivelin e nevojshëm rregullativ, i ndarë sipas kategorive.

Burimi: BQK (2014)

Megjithatë, në nivel të bankave individuale, CAR për katër nga bankat do të zbriste nën nivelin 12 përqind dhe, rrjedhimisht, do të duhej një injektim kapitali prej 21.4 milionë euro (ekuivalent me vetëm 0.42 përqind të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2013) për të rikthyer në kapitalizimin në nivelin e kërkuar. Në këto rrethana, pjesëmarrja e NPL në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 13.5 përqind, ndërsa në nivel të bankave individuale, niveli më i lartë i normës së NPL-ve do të ishte 18.3 përqind. Duke u bazuar në supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, gjithsej humbja e sektorit bankar do të arrinte vlerën prej 58.7 milionë euro (1.14 përqind të PBB-së). Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale me që duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar.

Rezultatet e skenarit shtesë në të cilin supozohet dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat sugjerojnë që CAR i sektorit do të zbriste në nivelin 11.5 përqind. Në nivel të bankave individuale, CAR i katër prej bankave do të zbriste nën nivelin minimal të kërkuar prej 12 përqind dhe mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin 125.3 milionë euro (vlerë ekuivalente me 2.7 përqind të PBB-së së supozuar për vitin 2013). Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i sektorit do të zbriste në nivelin 9.2 përqind, ndërsa numri i bankave të nën-kapitalizuara do të arrinte në gjashtë. Vlera e nevojshme për rikapitalizimin e sektorit bankar do të arrinte në 180.6 milionë euro, apo vlerë ekuivalente me 3.5 përqind të PBB-së së supozuar për 2013.

Nivelet përballuese të NPL-ve të secilës bankë para se të shfaqen probleme me kapitalizim (para se Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit –CAR të zbriste nën nivelin 12 përqind) duken të jenë mjaft të larta për shumicën prej bankave. Në një prej bankave, NPL do të mund të rritej deri në 24.5 përqind të gjithsej portofolit të kredive të asaj banke para se të paraqitet nevoja për kapital shtesë. Në disa banka, nivelet përballuese të normës së NPL-ve duken të jenë më të ulëta, ku niveli më i ulët i NPL-it i përballueshëm në njërin nga bankat është 9.3 përqind (3.5pp më shumë se niveli i NPL para tronditjes). Njëra nga bankat mund të përballojë rritje të raportit të NPL për vetëm 1.6pp para se të paraqiten nevojat shtesë për kapitalizim. Sidoqoftë, sektori bankar është në gjendje të përballojë një raport të NPL-ve deri në 16.5 përqind pa u paraqitur nevoja për injektim kapitali për mbajtjen e CAR në nivelin rregullativ prej 12 përqind.

6.4.2. Rreziku i likuiditetit

Metodologjia²²

Skenari bazë: Analiza e rrezikut të likuiditetit mbështetet në skenarin bazë të tërheqjes së një vlere të theksuar të depozitave nga sektori bankar, duke vlerësuar kështu aftësinë e sektorit që të përballojë një tronditje të tillë. Më specifikisht, është konsideruar tërheqja e 8% të depozitave në baza ditore, përgjatë një periudhe pesë ditore, duke ndarë 5% të depozitave të mbetura pas çdo dite për qëllime operacionale të bankës. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e konvertimit të mjeteve likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, përderisa mundësia e konvertimit të mjeteve jolikuide në para të gatshme do të ishte vetëm një përqind e këtyre mjeteve brenda ditës. Gjithashtu është supozuar se bankat kanë qasje të plotë në rezervat e tyre, ndërsa nuk është marrë parasysh mundësia e financimit të bankave përmes burimeve të jashtme të financimit.

Skenarë shtesë: Krahas skenarit të lartpërmendur, si skenarë shtesë në analizën mbi rrezikun kreditor janë konsideruar edhe dështimi i depozitorëve më të mëdhenj në secilën prej bankave, si dhe niveli përballues i tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen problemet me likuiditetin.

Përfundimisht, qëndrueshmëria e sektorit bankar në këtë analizë është testuar në kuptim të vlerësimit të mjaftueshmërisë së aseteve likuide të bankave për të përballuar tërheqje mjaft konzervative të nivelit të depozitave, si dhe mjaftueshmëria e aseteve likuide për të përballuar rrezikun e mundshëm nga koncentrimi i depozitave.

Rezultatet

Sektori bankar i Kosovës u karakterizua me likuiditet të lartë në fund të vitit 2013, ku indikatorit kyç i likuiditetit - raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra- qëndroi në 48 përqind. Andaj, sektorit bankar i Kosovës, falë pozitës së lartë të likuiditetit, tregoi aftësi të kënaqshme të përballimit të skenarëve të supozuar mjaft konzervativ të tërheqjes së depozitave.

Tabela 9. Përmbledhje e rezultateve të stress-testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave ^{1/}	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në milion Euro)
Pas ditës së parë	0	0
Pas ditës së dytë	0	0
Pas ditës së tretë	0	0
Pas ditës së katërt	0	0
Pas ditës së pestë	2	11

Shënim:1/ Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Burimi: BQK (2014)

Rrezultat e skenarit bazë të tërheqjes së 8% të depozitave në ditë për pesë ditë në vazhdimësi, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës fillon të ketë probleme me likuiditetin vetëm në ditën e pestë, dhe atë vetëm në vetëm dy prej bankave (Tabela 9). Niveli i tërheqjes së depozitave nga secila bankë është konsideruar të jetë 8 përqind e gjithsej depozitave të tyre. Niveli total i tërheqjes së depozitave do të arrinte në 34 përqind, dhe shuma e mjeteve likuide shtesë të nevojshme për tejkalimin e problemeve me likuiditetin do të arrinte në 11.0 milionë euro (0.21 përqind e PBB-së së supozuar për vitin 2013).

²² Metodologjia e llogaritjes së mjeteve likuide ka ndryshuar për të qenë konform Rregullores së BQK-së për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Paraprakisht mjetet likuide për qëllim të analizës stres-test janë llogaritur sipas metodologjisë së Treguesëve të Shëndetit Financiar të FMN-së.

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat shihet si i paefektshëm, meqë problemet me likuiditetin në këtë rast pothuajse janë inekzistente. Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit (depozitat si përbërësit kryesorë të detyrimeve) andaj tërheqja e menjëhershme e depozitave nga individë apo kompani me vlerën e depozitave më të mëdha nuk paraqesin rrezik për sektorin.

Përfundimisht, nivelet përbaluese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë para se të shfaqen probleme me likuiditet rezultojnë të jenë mjaft të larta. Sektori bankar është në gjendje të përballoj një tërheqje në nivel afër 31.6 përqind të gjithë depozitave pa pasur probleme në mirëmbajtjen e mjeteve të nevojshme likuide. Në këtë rast, nën supozimin që vlera e kredive nuk do të rritet, raporti kredi/depozita për sektorin bankar do të arrijë në 107.2 përqind.

6.5. Infrastruktura Financiare në Kosovë

Zhvillimi dhe konsolidimi i infrastrukturës financiare është esenciale për nxitjen dhe mirëmbajtjen e stabilitetit financiar. Përderisa sistemet e pagesave paraqesin shtyllën kryesore në infrastrukturën financiare të një vendi, këto sisteme duhen të kenë një bazë të qëndrueshme legale që siguron ekzekutimin e sigurt të transaksioneve të pagesave, si dhe mekanizma që kontrollojnë rreziqet financiare dhe operationale të cilët mund të pengojnë mbarëvajtjen e sistemit.

Infrastruktura financiare në Kosovë vazhdoi të forcohet edhe gjatë vitit 2013, duke siguruar kështu funksionimin efektiv të institucioneve financiare dhe rritjen e sigurisë dhe efikasitetit të transaksioneve financiare.

Gjatë vitit 2013, infrastruktura bankare u karakterizua me zvogëlim të numrit të degëve dhe të punësuarëve. Në dhjetor 2013, numri i degëve dhe nëndegëve të sektorit bankar ishte 299 (310 në dhjetor 2012). Ndërsa numri i punëtorëve në dhjetor 2013 ishte 3,549, gjegjësisht 178 punëtor më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Kjo tendencë e zvogëlimit të infrastrukturës bankare dhe numrit të punëtorëve është rezultat i politikave bankare për reduktimin e shpenzimeve.

6.5.1. Sistemi i Pagesave

Sistemi i Pagesave është i definuar me Ligjin nr. 04/L-155 për Sistemin e Pagesave, i cili nënkupton sistemin ku dy ose më tepër pjesëmarrës bashkëpunojnë në mundësimin e kryerjes së pagesave apo lehtësimin e qarkullimit të parasë, dhe përfshin çdo marrëveshje dhe/apo procedurë për procesimin, shkëmbimin, kliringut, strukturimin dhe/apo shlyerjen e transaksioneve të pagesave.

Në Kosovë operon sistemi i vetëm ndërbankar i pagesave – Sistemi Elektronik i Kliringut Ndërbankar (SEKN), i cili paraqet një sistem hibrid të pagesave dhe mundëson kliringun dhe shlyerjen në mënyrë automatike sipas sesioneve, si dhe shlyerjen në baza bruto në kohë reale, për të gjitha transaksionet ndërbankare. SEKN-ja gjatë viteve të funksionimit të tij ka dëshmuar se është një sistem efikas dhe i sigurt për kliring dhe shlyerje të pagesave ndërbankare dhe letrave me vlerë, me një infrastrukturë shumë stabile.

Gjatë vitit 2013, sistemi i pagesave është karakterizuar me qëndrueshmëri, siguri dhe efikasitet të lartë operues, duke realizuar kliringun dhe shlyerjet me kohë dhe në pajtim me standardet dhe procedurat përkatëse.

Me qëllim të arritjes së objektivave të sigurisë dhe efikasitetit, BQK ka vazhduar plotësimin e mëtejshëm të bazës ligjore. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti është miratuar Ligji për Sistemin e Pagesave, si dhe këto rregullore a) Rregullore për Kliringun dhe Funksionimin e Llogarive për

Shlyerje, b) Rregullore për Skemën e Debitimit Direkt të Sistemit Elektronik të Kliringut Ndërbankar si dhe Udhëzimi Operacional për Regjistrin e Poseduesve të Llogarive Bankare, duke përfunduar kompetencat mbikëqyrëse të sistemit të pagesave.

Gjatë vitit 2013, ka vazhduar avansimi i funksionit të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave me qëllim identifikimin dhe monitorimin e rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohet sistemi i pagesave dhe të cilat mund të ndikojnë në sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave. Rreziqet me të cilat ballafaqohet sistemi i pagesave janë: rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit, rreziku i përgjithshëm i biznesit, rreziku operacional etj. BQK në vazhdimësi ka arritur të menaxhojë dhe ti mbaj nën kontroll këto rreziqe, duke iu përmbajtur standardeve ndërkombëtare lidhur me operimin dhe mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave.

Po ashtu, ka vazhduar mbledhja, përpunimi dhe analizimi i të dhënave statistikore mbi instrumentet e pagesave letër, cash dhe ato elektronike, me qëllim krijimin e një pasqyre më të qartë mbi zhvillimet aktuale në kuadër të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave. Gjithashtu është plotësuar dhe avancuar edhe më tutje metodologjia për raportimin e instrumenteve të pagesave, me qëllim rritjen e cilësisë së të dhënave statistikore.

Në këtë fushë, gjatë vitit 2013, BQK ka përpiluar këto analiza dhe raporte:

- Analizë mbi përdorimin e instrumenteve të pagesave;
- Analizë mbi mënyrat e dërgimit të remitancave në Kosovë;
- Analizë mbi përdorimin e Kos Giro në Kosovë;
- Analizë mbi skemën e Debitimit Direkt;
- Analiza për procesimin e transaksioneve me kartela, etj.

Numri dhe vlera e transaksioneve që përpunon SEKN vazhdon të rritet. Deri në dhjetor 2013, numri i transaksioneve të përpunuara nga SEKN arriti në 6.8 milion (4.3 milion në 2012), duke shënuar rritje vjetore prej 57 përqind. Kurse vlera totale e transaksioneve deri në dhjetor 2013, arriti në 6.4 miliard euro (5.7 miliard në 2012), që paraqet një rritje vjetore prej 13.3 përqind. Mesatarja ditore e transaksioneve përmes SEKN arriti në 27 mijë të tilla, ndërsa vlera e tyre në 25.9 milion euro.

Në raport me numrin e transaksioneve pagesat e rregullta masive vazhdojnë ta kenë pjesëmarrjen më të lartë kuadër të instrumenteve të pagesave (48.5 përqind të numrit të gjithsej pagesave). Këto pagesa janë kryesisht të realizuara nga ose për institucionet qeveritare siç janë pagesat e pagave. Më pas vijnë pagesat prioritare masive me një pjesëmarrje prej 26.5 përqind dhe pagesat e rregullta me një pjesëmarrje prej 14.3 përqind (Tabela 10). Pagesat prioritare masive janë pagesat të cilat kanë shënuar rritjen më të shpejtë në numër (1,797,330 në dhjetor 2013 nga 3,873 në dhjetor 2012) kryesisht si rezultat i fillimit të procesimit të pagave të administratës dhe pensioneve të MPMS përmes SEKN-së që nga prilli 2013.

Tabela 10. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SEKN-së

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Të rregullta	19.2%	14.3%	55.7%	51.6%
Prioritare	0.5%	0.4%	15.7%	11.9%
Të rregullta - masive	67.4%	48.5%	8.3%	8.3%
Prioritare - masive	0.1%	26.5%	0.0%	5.8%
Pagesat xhiro	12.5%	10.2%	15.7%	14.0%
Letra me vlerë	0.0%	0.0%	4.4%	8.3%
Debitim Direkt	0.2%	0.2%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2014)

Në raport me vlerën e transaksioneve, pagesat e rregullta gjithashtu vazhdojnë të kryesojnë strukturën e pagesave (51.6 përqind në gjithsej vlerën e transaksioneve). Pagesat kos-xhiro edhe pse shënuan rënie të pjesëmarrjes në vlerën e gjithsej pagesave (14 përqind në dhjetor 2013 krahasuar me 15.7 përqind në 2012) vazhdojnë të qëndrojnë në vendin e dytë. Pagesat prioritare masive dhe letrat me vlerë janë instrumentet të cilat u karakterizuan me rritjet me të theksuara vjetore në vlerë, gjë që u reflektua edhe në rritjen e dukshme të pjesëmarrjes së tyre në strukturë të pagesave. Pagesat prioritare masive të procesuara përmes SEKN rritën pjesëmarrjen në 5.8 përqind në 2013 nga rreth 0 përqind sa ishin në vitin paraprak, kryesisht si rezultat i rritjes së theksuar së tyre në vlerë (374.5 milion në dhjetor 2013, nga 2.4 milion në dhjetor 2012) (Tabela 10). Siç edhe ceket më lartë procesimi i pagave të administratës dhe pensione të MPMS përmes SEKN-së, nga prilli 2013, është faktori kryesor i rritjes së lartë të këtij instrumenti. Pagesa e letrave me vlerë përmes SEKN gjithashtu shënoi rritje të theksuar (534 milion euro në 2013 nga 252.7 milion euro në vitin 2012) që rezultoi në rritjen e pjesëmarrjes së tyre në strukturë në 8.3 përqind në vitin 2013 (4.4 përqind në vitin 2012)

Numri i gjithsej llogarive të vlefshme bankare arriti në 1.86 milion llogari në dhjetor 2013, që nënkupton që mesatarisht pothuaj çdo qytetar në Kosovë është i pajisur me llogari bankare.²³ Nëse e krahasojmë numrin e llogarive bankare në vend në dhjetor 2013 me periudhën e njëjtë të viti të kaluar kemi një rritje të gjithsej llogarive bankare për 4.85 përqind.²⁴

Llogaritë bankare E-banking përmes të cilave shfrytëzuesit i qasen shërbimeve bankare 'online' nga interneti kanë vazhduar të rriten. Deri në dhjetor 2013 numri i gjithsej llogarive E-banking arriti në 131,365, një rritje vjetore prej 35.3 përqind. Rrjedhimisht, edhe numri dhe vëllimi i transaksioneve përmes shërbimit E-banking është rritur. Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 1,056,655 në dhjetor 2013 (625,762 në dhjetor 2012). Vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking deri në dhjetor 2013 arriti në 2.7 miliard euro (1.5 miliard në dhjetor 2012)

Struktura e llogarive E-bankare vazhdon të dominohet nga llogaritë rezidente me një pjesëmarrje prej 97.1 përqind në dhjetor 2013. Në kuadër të llogarive të rezidentëve, llogaritë individuale bankare përbëjnë rreth 80.1 përqind të gjithsej llogarive të rezidentëve dhe pjesa e mbetur nga 19.9 përqind nga llogaritë afariste. Ngjashëm, struktura e llogarive të jo-rezidentëve dominohet nga llogaritë individuale (92.5 përqind në dhjetor 2013), përderisa llogaria afariste ka një pjesëmarrje prej 7.5 përqind. Rritja e vazhdueshme e përdoruesve të shërbimit E-banking është rezultat i përpjekjeve të institucioneve financiare për përdorimin e këtij shërbimi.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme shënoi rritje prej 8.5 përqind. Numri i kartelave me funksion debiti në dhjetor 2013, arriti në 645,048, kurse me funksion krediti në 109,332. Përkundër shkallës më të ulët të përdorimit, numri i kartelave të kreditit u karakterizua me rritje më të shpejtë (14 përqind) krahasuar me kartelat e debitit (7.6 përqind). Pjesëmarrjen më të lartë si në kartelat e kreditit dhe debitit deri në dhjetor 2013 e kishin kartelat Visa (88.7 përqind përkatësisht 75.1 përqind), pasuar nga kartelat Master Card (11.3 përqind përkatësisht 24.8 përqind)

Infrastruktura bankare vazhdon të karakterizohet me trend rritës sa i përket rrjetit të bankomatëve (angl. Automatied Teller Machine: ATM) dhe pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale). Numri i pajisjeve ATM dhe POS (që mundësojnë pagesat në pika të shitjes) shënuan rritje vjetore prej 2.7 dhe 5.6 përqind deri në dhjetor 2013. Gjithsej numri i ATM-ve të instaluar nga bankat

²³ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në dhjetor 2013 popullsia e përgjithshme rezidente ishte 1,815,606.

²⁴ Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë, numrin e llogarive E-Banking, numrin e llogarive që përdorin urdhëresën periodike ('standing order') dhe numrin e llogarive që përdorin Debitimin Direkt ('Direct Debit') – DD.

komerciale arrit në 496 përderisa numri i POS arriti në 9071 deri në dhjetor 2013 (Tabela 11). Deri në dhjetor 2013, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve arriti në 9.3 milion, me një qarkullim total prej 936.2 milion euro (873.1 milion deri në dhjetor 2012). Numri pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминаlet POS deri në dhjetor 2013 arrit në 3.7 milion me vlerë prej 192 milion euro. Përdorimi i parasë së gatshme vazhdon të mbetet në nivel të lartë në vend. Vlera e tërheqjes së parave përmes ATM-ve ndaj totalit të transaksioneve me kartela arriti në 81.2 përqind deri në dhjetor 2013. Ndërsa, vlera e tërheqjes së parave përmes POS ndaj totalit të transaksioneve me kartela arrit në 16.6 përqind deri në dhjetor 2013.

Tabela 11. Rrjeti i Sektorit Bankar

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Numri i ATM-ve	415	460	483	496
Numri i POS-ve	6,194	7,534	8,592	9,071
Numri i llogarive 'e-banking'	55,292	68,990	97,089	131,365

Burimi: BQK (2014)

7. Sektori Pensional

Sektori pensional i Kosovës vazhdon të përbëhet nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Pjesa më e madhe e kursimeve pensionale në Kosovë administrohen nga FKPK, i cili menaxhon me 99.4 përqind të gjithë asetëve të sektorit të pensioneve, ndërsa FSKP administron një pjesë më të vogël të kursimeve pensionale të cilat janë pensione vullnetare (Tabela 12).

Tabela 12. Struktura e sektorit pensional

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Kosovë	99.0%	99.2%	99.3%	99.4%
Slloveni-Kosovë	1.0%	0.8%	0.7%	0.6%

Burimi: BQK (2014)


7.1. Aktiviteti i Sektorit Pensional

Në kuadër të sistemit financiar në vend, gjatë vitit 2013, sektori pensional u karakterizua me normën më të lartë të rritjes së asetëve. Vlera e asetëve të sektorit pensional, deri në dhjetor 2013, arriti në 918.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 23.3 përqind. Vlera e asetëve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) u karakterizua me rritje vjetore prej 23.4 përqind, ndërsa asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSKP) shënuan rritje vjetore prej 13.3 përqind.

Sa i përket FKPK-së, struktura e asetëve edhe gjatë vitit 2013 u dominua nga investimet në tregun e jashtëm me një pjesëmarrje prej 71.2 përqind (Figura 85). Pjesa e mbetur përbëhet nga investimet në bonot e thesarit të Qeverisë së Kosovës (5.8 përqind) dhe nga paraja në BQK (23 përqind). Vlen të theksohet që gjatë viteve të fundit vërehet një tendencë rënëse e investimeve jashtë vendit dhe rritje e investimeve të FKPK-së në Kosovë.


Investimet jashtë vendit dominojnë edhe strukturën e asetëve të FSKP-së. Gjatë vitit 2013, jashtë vendit janë investuar gjithsej 76.4 përqind të asetëve të FSKP-së, ndërsa pjesa e mbetur prej 23.6 përqind paraqet investimet në Kosovë, nga të cilat 23.4 përqind të asetëve janë në bono të thesarit të Qeverisë së Kosovës. Një tendencë e lehtë rënëse e investimeve jashtë vendit vërehet edhe në asetet e FSKP-së.

Figura 85. Struktura e investimeve të Fondeve Pensionale, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 86. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Kosovar të Pensioneve, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)


Në kuadër të investimeve të FKPK-së në tregun e jashtëm, investimet në aksione kryesojnë me 48.2 përqind, të pasuara nga investimet në bono të qeverive të huaja (14.8 përqind), në bonot e ndërlidhura me inflacionin (8.8 përqind), tregun e kredive (3.6 përqind) dhe investimet në fondet investuese (24.6 përqind). Në aspektin gjeografik, investimet e FKPK-së janë të shpërndara në 31 vende të botës, mirëpo pjesa më e madhe është e alokuar në SHBA (34.7 përqind), Britani të Madhe (14.3 përqind) dhe Gjermani (6.5 përqind). Sa i përket FSKP-së, pjesa më e madhe e investimeve jashtë vendit janë në letra me vlerë (74.3 përqind) dhe para të gatshme (2 përqind). Shpërndarja e tyre gjeografike gjithashtu është e fokusuar në SHBA dhe BE.

7.2. Performanca e Sektorit Pensional

Sektori pensional gjatë vitit 2013 u karakterizua me performancë pozitive financiare. Të dy fondet shënuan ngritje të çmimit të aksionit dhe rritje të kthimit nga investimet (Figura 86 dhe 87). Vlera e çmimit të aksionit²⁵ të FKPK-së, në dhjetor 2013, arriti në 1.21 euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8 përqind. Megjithatë, përkundër rikuperimit, çmimi i aksionit të FKPK-së akoma nuk është kthyer në nivelin e para krizës globale financiare (1.22 euro). Vlera e çmimit të aksionit të FSKP-së ka vazhduar me trendin rritës edhe gjatë vitit 2013, duke arritur në 138.6 euro, që përkthehet në rritje vjetore prej 6.7 përqind.

Përmirësimi i performancës së investimeve reflekton përmirësimin e kushteve në tregjet ndërkombëtare të aksioneve, ku edhe janë investuar pjesa më e madhe e mjeteve të fondeve pensionale të Kosovës. Në rritjen e besueshmërisë në tregjet globale financiare dhe, rrjedhimisht, në rritjen e performancës së tyre, veçanërisht ka ndikuar përkushtimi i vendeve të BE-së dhe institucioneve ndërkombëtare financiare për tejkalimin e problemeve të borxhit publik në disa nga vendet e zhvilluara.

Figura 87. Mjetet nën menaxhimin e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve, në milion euro



Burimi: BQK (2014)

²⁵ Vlera bazë e çmimit të aksionit për FKPK-në është 1, ndërsa për FSKP-në është 100.

8. Sektori i Sigurimeve

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga sigurimi jo-jetë i cili përfaqëson 90 përqind të gjithëj sektorit, ndërsa pjesa e mbetur prej 10 përqind përfshinë sigurimin jetë. Nga 13 kompani të sigurimeve që operuan në Kosovë gjatë vitit 2013, 10 kompani ofruan produkte të sigurimit jo-jetë, ndërsa 3 kompani ofruan produkte të sigurimit të jetës. Sektori i sigurimeve në Kosovë vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, të cilat menaxhojnë 64.9 përqind të gjithëj aseteve të sektorit. Sidoqoftë,

krahasuar me vitin paraprak, vërehet një rënie e pjesëmarrjes së pronësisë së huaj në krahasim me vitin 2012 kur kompanitë e huaja menaxhonin 67.4 përqind të gjithëj aseteve të kompanive të sigurimit. Pjesa më e madhe e kapitalit në sektorin e sigurimeve zotërohet nga kompanitë me prejardhje nga Austria dhe Shqipëria, gjithëj numri i të cilave është pesë kompani dhe përbëjnë 36.8 përqind të gjithëj kapitalit të kësaj industrie. Kapitali vendor përfaqësohet me tri kompani dhe zotëron 33.3 përqind të gjithëj sektorit (Figura 88). Vlen të theksohet se të gjitha kompanitë të cilat ofrojnë produkte të sigurimit jetë janë kompani me pronësi të huaj.

Shkalla e koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve është dukshëm më e ulët se ajo në sektorin bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman i kalkuluar për asetet e kompanive të sigurimeve tregon 910.1 pikë në vitin 2013, që mund të konsiderohet si shkallë jo e lartë e koncentrimit. Trendi i shkallës së koncentrimit të tregut në sektorin e sigurimeve gjatë viteve të fundit është karakterizuar me rënie të vazhdueshme. Vlen të theksohet se shkalla e koncentrimit në asete është më e lartë në krahasim me primet, ku në fund të vitit 2013 Indeksi Herfindahl-Hirschman për primet ishte 1083 pikë. Diferencë e ngjashme vërehet edhe nëse krahasohet pjesëmarrja e tri kompanive më të mëdha në gjithëj asetet e sektorit, ku në fund të vitit 2013 për asetet ishte 35.4 përqind, ndërsa për primet ishte 40.9 përqind.

Figura 88. Struktura e kapitalit të kompanive të sigurimit, në përqindje




Tabela 13. Depërtimi dhe densiteti i sektorit të sigurimeve

Përshkrimi	Primet/Numri i Popullsisë		Primet/PBB	
	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Gjithëj Sektori	39.0 euro	43.6 euro	1.4%	1.5%
Sigurimi 'jo jetë'	38.2 euro	42.4 euro	1.4%	1.4%
Sigurimi 'jetë'	0.8 euro	1.1 euro	0.03%	0.04%

Burimi: BQK (2014)

Përkundër rritjes së vazhdueshme, sektori i sigurimeve mund të konsiderohet të jetë ende në një fazë të hershme të zhvillimit duke marrë parasysh peshën e vogël që ka në kuadër të gjithëj sistemit financiar, si dhe depërtimin dhe dendësinë e ulët në treg. Depërtimi i sigurimeve, i cili llogaritet si raport i përqindjes së bruto primeve të pranuar ndaj PBB-së dhe matë zhvillimin e tregut të sigurimeve, tregon përfaqësim të ulët prej 1.5 përqind, me gjithë se vërehet një përmirësim i lehtë në krahasim me vitin paraprak. Densiteti i sigurimeve, i cili llogaritet si raport i bruto primeve të pranuar ndaj popullsisë së përgjithshme, edhe pse ende i ulët, ka

shënuar një përmirësim më të theksuar duke arritur në 43.6 euro për kokë banori (39.0 euro në fund të vitit 2012) (Tabela 13).

8.1. Aktiviteti i Sektorit të Sigurimeve

Gjatë vitit 2013, vlera e aseteve të sektorit të sigurimeve arriti në 132 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 1.4 përqind, rritje kjo që është dukshëm më e ngadalshme se sa rritja vjetore prej 16.3 përqind në vitin paraprak. Në ngadalësimin e normës vjetore të rritjes së sektorit, gjatë vitit 2013, kontribuoi rënia e theksuar e parapagimeve, aseteve teknike dhe aseteve të risigurimit. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit vazhdoi të dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 58 përqind të gjithsej aseteve (Figura 89). Pjesa tjetër përfaqësohet nga asetet fikse, asetet teknike, paraja e gatshme, etj.

Në kuadër të detyrimeve, rezervat teknike kryesojnë me 52.5 përqind, ndërsa në pjesën e mbetur hyjnë detyrimet tjera dhe kreditë (Figura 90). Kapitali vetanak gjatë vitit 2013 u rrit për 2.1 përqind, duke arritur vlerën prej 46.3 milion euro. Rritja ishte rezultat i rritjes së kapitalit aksionar dhe rritjes së rezervave të përgjithshme dhe speciale.

Në anën tjetër, kapitali i kompanive të sigurimit u ndikua negativisht nga humbjet me të cilat u karakterizua ky sektor gjatë viteve të fundit.


Tabela 14. Bruto Primet gjatë viteve

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Prime bruto 'jo jetë'	61.8	67.6	69.3	77.1
Prime bruto 'jetë'	0.7	1.0	1.5	2.1

Burimi: BQK (2014)


Vlera e bruto primeve të shkruara, e cila paraqet madhësinë e tregut të sigurimeve, në vitin 2013 arriti në 79.1 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.8 përqind. Në kuadër të tyre, vlera e bruto primeve të shkruara të sigurimit jo-jetë arriti në 77.1 milion euro dhe shënoi rritje vjetore prej 11.2 përqind (Tabela 14). Kontribut kryesor në këtë rritje shënuan sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit si dhe sigurimet motorike. Ndërsa, vlera e primeve të shkruara në kuadër të sigurimit jetë shënoi një rritje vjetore prej 38.9 përqind, duke arritur vlerën prej 2 milion euro. Rritja e primeve të sigurimit jetë është bazuar në sigurimin e përzier të jetës dhe në sigurimin në rast vdekje apo maturim të kontratës.

Figura 89. Struktura e aseteve të kompanive të sigurimit, dhjetor 2013, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 90. Detyrimet dhe ekuiteti i kompanive të sigurimit, dhjetor 2013, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Tabela 15. Dëmet e paguara gjatë viteve, në milion euro

Përshkrimi	Dhjetor 2010	Dhjetor 2011	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Dëmet 'jo jetë'	23.3	22.8	26.1	33.2
Dëmet 'jetë'	0.04	0.03	0.1	0.2
Dëmet BKS	4.5	4.3	4.8	5.2

Burimi: BQK (2014)


Vlera e dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) deri në dhjetor 2013 arriti në 38.6 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 24.4 përqind. Rritja e dëmeve të paguara nga sigurimi jo-jetë ishte kryesisht rezultat i dëmeve të paguara për sigurimet nga zjarri dhe dëmtime të tjera në pronë, si dhe për sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit. Dëmet e paguara nga sigurimet jetë deri në dhjetor të vitit 2013 arritën në 0.2 milion euro, kurse dëmet e paguara nga BKS-ja në vitin 2013 shënuan vlerën 5.2 milion euro që paraqet një rritje prej 7.5 përqind krahasuar me vitin 2012 (Tabela 15).

8.2. Performanca e Sektorit të Sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë vitit 2013 ka shënuar progres në përmirësimin e indikatorëve kyç të performancës dhe stabilitetit. Deri në dhjetor të vitit 2013, sektori i sigurimeve regjistroi humbje neto prej 337 mijë euro, që është dukshëm më e ulët në krahasim me humbjen prej 3.1 milion euro që ishte shënuar në vitin 2012. Humbjet e sigurimit jo-jetë u zvogëluan për 82 përqind, ndërsa ato të sigurimit jetë u zvogëluan për 7 përqind. Ngushtimi i humbjes u mundësua kryesisht nga menaxhimi më i mirë i shpenzimeve dhe u reflektua në indikatorët kryesor të performancës. Kthimi Mesatar në Asete (*angl. Return of Average Assets: ROAA*) në vitin 2013 ishte -0.3 përqind krahasuar me -2.6 përqind sa ishte në vitin 2012. Ndërsa, Kthimi Mesatar në Kapital (*angl. Return on Average Equity: ROAE*) u përmirësua në -0.7 përqind nga -6.8 përqind në vitin 2012. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara, që matë shkallën e mbulimit të dëmeve të paguara nga primet e pranuar, tregon përmirësim të performancës së sektorit krahasuar me vitin paraprak (Figura 91).

Sektori i sigurimeve mbetet mirë i kapitalizuar, me normë të kapitalizimit prej 35 përqind, që do të thotë se tregu është në gjendje të mirë për t'u ballafaquar me tronditje të mundshme. Kapaciteti i sektorit për përballimin e humbjeve të mundshme matet edhe përmes raportit të kapitalit vetanak ndaj rezervave teknike, i cili deri në vitin dhjetor 2013 arriti në 66.7 përqind nga 64.4 përqind sa ishte në vitin 2012. Me gjendje të kënaqshme gjatë vitit 2013 u karakterizua edhe pozicioni i likuiditetit të kompanive të sigurimit. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në raport me rezervat teknike qëndruan në 124.1 përqind në 2013 krahasuar me 114.7 përqind në 2012, ndërsa paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj në raport me gjithsej detyrimet qëndruan në 100 përqind (95.2 përqind në 2012).

Figure 91. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara, në milionë euro



Burimi: BQK (2014)

9. Sektori i Institucioneve Mikrofinanciare dhe Ndhmësve Financiar

Struktura e sektorit të institucioneve mikrofinanciare vazhdon të dominohet nga kompanitë me pronësi të huaj, asetet e të cilave përbëjnë 91.6 përqind të gjithëj aseteve të sektorit.

Shkalla e koncentrimit të tregut, me gjithë se është rritur gjatë vitit 2013, mbetet më e ulët se ajo e sektorit bankar. Indeksi Herfindahl-Hirschman (IHH) për asetet e institucioneve mikrofinanciare ka arritur në 1171 pikë nga 1153 pikë sa ishte në dhjetor 2012 (Figura 92). Asetet e tri IMF-ve më të mëdha në dhjetor 2013 rriten pjesëmarrjen e tyre në gjithëj asetet e sektorit në 46 përqind nga 45 përqind në vitin paraprak. Vlen të theksohet se shkalla e koncentrimit në raport me kreditë tregon rritje më të theksuar në krahasim me koncentrimin në raport me që kryesisht reflekton rënien më të theksuar të kreditimit të sektorit.


9.1. Aktiviteti i Sektorit Mikrofinanciar

Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar ka vazhduar të zvogëlohet edhe gjatë vitit 2013. Vlera e aseteve të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2013 ishte 112.9 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 2.5 përqind.

Kreditë, si kategoria kryesore në kuadër të gjithëj aseteve të IMF-ve, u karakterizuan me rënie vjetore prej 6.7 përqind. Në kuadër të gjithëj kredive, kreditë e destinuar për biznese shënuan rënie vjetore më të theksuar prej 17.4 përqind, ndërsa kreditë për ekonominë familjare, të cilat dominojnë strukturën e kredive të IMF-ve, u karakterizuan me rënie vjetore prej 0.6 përqind. Andaj, zvogëlimi i kredidhënies për bizneset paraqet kontribuuesin kryesor në zvogëlimin e gjithëj kredive të lëshuara nga institucionet mikrofinanciare (Figura 93).


Struktura e kredive sipas sektorëve ekonomik mbetet e ngjajshme me vitin paraprak. Kreditë për shërbime kryesojnë strukturën me pjesëmarrje prej 46.3 përqind. Për dallim nga sektori bankar, ku bujqësia paraqet sektorin me qasjen më të ulët në kreditim, sektori i institucioneve financiare vërehet të ketë bujqësinë njërin ndër sektorët më të favorizuar për kreditim. Në dhjetor 2013,

Figura 92. HHI për asetet dhe kreditë e IMF-ve




Burimi: BQK (2014)

Figura 93. Kontributi në rritjen e kredive sipas sektorëve gjatë vitit 2013, në pikë përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 94. Struktura e kredive të IMF-ve sipas sektorëve ekonomik, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

kreditë e lëshuara për sektorin e bujqësisë kishin pjesëmarrje prej 27 përqind në gjithsej kreditë e lëshuara nga ky sektor. Pjesa tjetër e kredive është destinuar për ndërtimtari dhe industri e energjetikë (Figura 94).


Sipas maturitetit, struktura e kredive kryesisht dominohet nga kreditë afatmesme "prej 1 deri 5 vite" të cilat përfaqësojnë 83.2 përqind të gjithsej kredive. Kreditë afatshkurta "deri në 1 vit" përbëjnë 16 përqind të kredive, dhe pjesa e mbetur përfaqësohet nga kredite afatgjata (Figura 95).

Cilësia e kredive të IMF-ve vazhdon të mbetet e mirë duke marrë parasysh pjesëmarrjen relativisht të ulët të kredive joperformuese në gjithsej kreditë. Në dhjetor 2013, raporti i Kredive Joperformuese (angl. Non-Performing Loans: NPL) ndaj gjithsej kredive ishte 5.3 përqind (5.4 përqind në 2012). Për më tepër, kreditë joperformuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizione për humbje nga kreditë me një normë të mbulueshmërisë prej 107 përqind në vitin 2013, mirëpo e cila është dukshëm më e ulët se sa norma e mbulueshmërisë e shënuar në vitin 2012 që ishte 128.8 përqind. Faktorët të cilët mund të kenë ndikuar në këtë rënie të mbulueshmërisë janë pritjet për përmirësim të portofolit kreditor si rezultati i rënies së kredive jo performuese që është shënuar në vitin e fundit. Gjithashtu, rënia e aktivitetit kreditor, që ka shkaktuar rënie të të hyrave, mund të ketë zvogëluar potencialin e institucioneve mikrofinanciare për të ndarë provizione për humbje nga kreditë.

Lizingu përfaqëson kategorinë e dytë më të rëndësishme të asetëve të IMF-ve me pjesëmarrje prej 19.5 përqind në gjithsej asetet. Gjatë vitit 2013, lizingu arriti vlerën 22.1 milion euro, duke shënuar rritje vjetore prej 6 përqind.


Vlen të ceket që ky aktivitet ushtrohet vetëm nga dy institucione të cilat janë licencuar në fund të vitit 2008; rrjedhimisht, pjesëmarrja e lartë në gjithsej asetet e sektorit tregon për zhvillimin e shpejtë të shërbimeve të lizingut nga këto dy institucione. Struktura e lizingut kryesohet nga lizingu i destinuar për ndërmarrje i cili përbën 72.6 përqind të gjithsej aktivitetit (Figura 96). Që

Figura 95. Struktura e kredive sipas afatit të maturimit, dhjetor 2013, në përqindje




Burimi: BQK (2014)

Figura 96. Struktura e lizingut të IMF-ve sipas sektorëve, në përqindje



Burimi: BQK (2014)

Figura 97. Normat e interesit në kreditë e IMF-ve për vitin 2013



Burimi: BQK (2014)

nga viti paraprak, vërehet rritje e peshës së lizingut të destinuar për ekonomitë familjare, i cili në vitin 2013 shënoi rritje vjetore prej 30 përqind.

Pjesa kryesore e detyrimeve të institucioneve mikrofinanciare përbëhet nga linjat kreditore të jashtme përmes së cilave këto institucione e financojnë aktivitetin kreditues, meqenëse nuk kanë të drejtë ligjore të financohen nga depozitat e klientëve.

Normat mesatare të interesit për kreditë e IMF-ve vazhdojnë të jenë më të larta krahasuar me normat e aplikuara nga sektori bankar. Norma mesatare e interesit në kreditë e IMF-ve, gjatë vitit 2013, ishte 22.6 përqind (22.5 përqind në vitin 2012) (Figura 97). Ndër arsyet kryesore për nivelin më të lartë të normave të interesit që aplikohen nga institucionet mikrofinanciare është edhe struktura e financimit të këtyre institucioneve, që bazohet në linja të jashtme kreditore, të cilat bartin norma më të larta të interesit.

9.2. Performanca e Sektorit Mikrofinanciar

Sektori i institucioneve mikrofinanciare e mbylli vitin 2013 me humbje prej 0.3 milion euro, humbje kjo që është më e ulët se sa ajo prej 4.5 milion euro e shënuar në vitin paraprak. Ngushtimi i humbjes ishte kryesisht rezultat i rënies më të theksuar të shpenzimeve krahas rënies së të hyrave.

Të hyrat e sektorit, deri në dhjetor të vitit 2013, zbritën në 19.2 milionë euro, që paraqet rënie vjetore prej 7.5 përqind. Struktura e të hyrave dominohet nga të hyrat e interesit me pjesëmarrje prej 81 përqind, dhe të cilat shënuan rënie vjetore prej 9.6 përqind. Rrjedhimisht edhe rënia e gjithsej të hyrave ishte kryesisht rezultat i zvogëlimit të aktivitetit kreditor të sektorit. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rënie prej 22.6 përqind, në kuadër të të cilave rënien më të madhe e regjistruan shpenzimet e jo interesit (23.6 përqind) dhe shpenzimet për provizione (59.3 përqind). Me gjithë se rënia e shpenzimeve kryesisht reflekton rënien e aktivitetit kreditor, ajo ka ndikuar në zvogëlimin e kostos së financimit gjë që është reflektuar edhe në përmirësimin e efikasitetit. Treguesi i efikasitetit, i cili shprehet përmes raportit të shpenzimeve ndaj të hyrave, është përmirësuar në 101.7 përqind nga 121.6 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Zvogëlimi i humbjes në krahasim me vitin paraprak është reflektuar edhe në përmirësimin e indikatorëve të profitabilitetit. Në vitin 2013, kthimi mesatar në asete (ang. Return on Average Assets: ROAA) arriti në -0.3 përqind nga -3 përqind në vitin paraprak. Gjithashtu, kthimi mesatar në kapital (ang. Return on Average Equity: ROAE) arriti në -1.1 përqind nga -14 përqind në vitin 2012.

Tabela 16. Tregues shtesë të efikasitetit të sektorit

Përshkrimi	Dhjetor 2012	Dhjetor 2013
Asetet/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	128.08	147.93
Profiti/nr i punëtorve (në mijëra euro)	-4.961	-0.424
Numri i kredive/nr. i punëtorve	44	48
Shpenzimet e personelit/nr. i punëtorve (në mijëra euro)	13.78	14.81

Burimi: BQK (2014)

Treguesit shtesë të kapacitetit të sektorit, të paraqitur në Tabelën 16, sugjerojnë përdorim më efikas të burimeve gjatë vitit 2013. Raporti i aseteve ndaj numrit të punëtorëve paraqet rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraprak. Përkundër zvogëlimit të aseteve, zvogëlimi i numrit të punëtorëve gjatë vitit 2013 ka ndikuar në trendin rritës të vlerës së aseteve të menaxhuara nga një punëtor. Raporti i profitit të gjeneruar për punëtor, edhe pse ende negativ, dukshëm u përmirësua krahasuar me vitin e kaluar, kryesisht si rrjedhojë e zvogëlimit të

theksuar të humbjes dhe zvogëlimit të numrit të punëtorëve. Poashtu, përmirësim është shënuar edhe në raportin e numrit të kredive të gjeneruara për punëtor. Në anën tjetër, zvogëlimi i numrit të punëtorëve shkaktoi rritje të raportit të shpenzimeve të personelit ndaj numrit të punëtorëve, duke bërë që të rritet kostoja mesatare për punëtor.

9.3 Ndhmësit Financiar

